

"RILINDASI"

250 vjetori, Napoleon Bonaparti dhe shqiptarët

Nga marrëdhënia me Ali Pashën tek
ideja e provincës Ilire. Historia e relikeve
të Napoleonit në familjen Libohova

NGA BAJRAM PEÇI



ARBËNI DHE SHQYPNI, SHQIPTARI I REFUZUAR SI SHQIPTAR

NGA TONIN ÇOBANI

DEDE GJETABI, MJESHTRI SHPIRTPOET I PËRKTHIMIT

"E ruaj një fjalë në
shpirt..." cikël me poezi

NGA XHAHID BUSHATI

► FAQE 13-22

ANALIZA

Kanabisi, matematika e Bashës: 1 hektar x 5 = 950 hektarë

Që kur shpalli se 7 X 7 bëjnë 42, të gjithë e kuptuan se Lulzim Basha nuk është i fortë në matematikë. Por këtë herë Basha ia ka kaluar edhe vetvetes, duke llogaritur se 1 X 5 bëjnë 950. Llogaritja surreale e liderit të opozitës u paraqit dy ditë më parë në një konferencë shtypi, ku asnjë nga gazetarët e pranishëm nuk ia vuri në dukje. Duke komentuar me entuziazëm përmbajtjen e reportazhit "Narcotica" të transmetuar nga Rai Tre, Basha rrëshkiti edhe një herë në grackën e numrave, në të cilën, me thënë të drejtën, kishte rrëshkitur para tij edhe gazetari italian, autori i investigimit. Ja se çfarë deklaroi Luli para gazetarëve: "Jemi të tronditur nga dëshmitë nga Italia të Rai 3 për drogën. Dëshmitë e Antimafias Italiane janë se: Këtë vit kanabis po kultivohet në një të tretën e territorit të Shqipërisë. Sasia e kanabisit këtë vit është 5 herë më e lartë se vitin e kaluar".

vijon në faqen 5

[SHQIPTARJA.COM]

ÇMIMI 30 LEKË

VITI IX - NR. 190(2712)

E DIEL, 11-08-2019

www.shqiptarja.com

NDRYSHIMET NE LIGJ

JA RREGULLAT E REJA PER BIZNESET NGA 1 JANARI 2020

Pas aksionit kundër informalitetit, shtrëngohen rregullat për raportimin në kohë reale të transaksioneve për të gjithë subjektet, që do të mbajnë më pak para' në arkë. Ja kush përjashtohet

NGA GENC KONDI

► FAQE 6

EKSKLUZIVE/PRIVILEGJET

Deputetët e PD-LSI që përfituan dieta pasi dorëzuan mandatet

Ja sa shpenzuan nga Buxheti i Shtetit parlamentarët e opozitës për dieta, karburant e telefon në mars 2019; më 20 shkurt firmosën dorëzimin e mandateve

NGA ADRIATIK DOÇI

► FAQE 2-3

OPINION

Përtej kujtesës së Teatrit Kombëtar zgjedh ëndrrën për teatrin e ri


NGA MIHO GJINI

► FAQE 10

ATENTATI

Laç, plagoset me armë kushëriri i Ervis Martin

► FAQE 9



AKUZAT E PD

Valdrin Pjetri publikon certifikatat e pastërtisë së figurës në Itali

► FAQE 3

AKSIONI

Qytetarëve u kthehen edhe 10.500 m2 plazhe në Shëngjin e Velipojë

► FAQE 4

TRAFIKU

Me karta italiane drejt Anglisë, arrestohet në Rinas 'koka' e grupit

► FAQE 9

REDAKSIA E SHQIPTARJA.COM
URON BESIMTARËT MYSLIMANË

GËZUAR

*Kurban
Bajramin!*

Ekskluzive

ADRIATIK DOÇI
TIRANE

Opozita shqiptare nuk ka hequr dorë nga privilegjet parlamentare edhe pas dorëzimit të mandatit të përfundimit në Kuvend. Deputetë të Partisë Demokratike, por sidomos të Lëvizjes Socialiste për Integrim kanë pranuar dhe përfunduar dieta, para për shpenzime për karburant dhe telefon edhe pasi braktisën Kuvendin dhe firmosën dorëzimin e mandatit të deputetit, në kuadër të aksionit politik për të rrëzimin e qeverisë 'Rama 2', krijimin e një qeverie teknike dhe zhvillimin e zgjedhjeve të parakohshme. Në 20 shkurt të këtij viti, deputetët e PD-LSI, me përjashtim të Rudina Hajdarit, Myslim Murrizit dhe Lefter Kokës, firmosën nga një deklaratë për 'djegien' e mandateve, ndërkohe që kishin nisur bojkotin e Kuvendit. Në datën 4 mars, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nisi zëvendësimin e deputetëve të PD-LSI me kandidatët për deputetë në listën shumëpartiake për zgjedhjet parlamentare të 2019. megjithatë, sipas një dokumenti të Kuvendit për përfundimet e deputetëve, i siguruar nga Shqiptarja.com, gjatë muajt mars të këtij viti, 19 ish-deputetë të opozitës kanë përfunduar dieta nga buxheti i Kuvendit. Kryetarja e LSI, Monika Kryemadhi ka përfunduar 37,625 lekë dieta në muajt mars 2019.

Deputetët e PD-LSI që përfituan dieta pasi dorëzuan mandatet

Deputetët e opozitës deri në 700 USD dieta, shpenzime për karburant dhe telefon në muajin mars 2019, në 20 shkurt firmosën dorëzimin e mandateve



Ndërkaq, nënkryetari i LSI, Petrit Vasili, 43,266 lekë ose rreth 400 USD dieta. Kryetari i Partisë Demokratike Nard Ndoka, i zgjedhur deputet në listat e Partisë Demokratike, rezultoi se ka përfunduar 4,000 lekë për shpenzime për karburant si dhe 1,700 lekë për shpenzime për telefon në muajin mars 2019. Ndërkaq, ish-deputetët e LSI, Agron Çela dhe Vangjel Tavo, në muajin mars të këtij viti,

rezultojnë se kanë përfunduar nga 75,250 lekë dieta. Deputetët Myslim Murriz, Lefter Koka dhe Rudina Hajdari, të cilët nuk iu bindën partive të tyre për 'djegien' e mandateve, kanë përfunduar të njëjtat privilegje mujore si deputetët e Partisë Socialiste.

PËRFITIMET E ÇUDITSHME GJATË BOJKOTIT

Përpos dietave, mbulimit

të shpenzimeve për karburant dhe telefon, çuditërisht, disa deputetë të Partisë Demokratike, gjatë periudhës së bojkotit të Kuvendit, kanë përfunduar edhe pagesa për qira si dhe për fjetje në hotel. Gjatë muajit shkurt të këtij viti, periudhë gjatë të cilës Partia Demokratike kishte braktisur jetën parlamentare për llogaritë e saj politike, duke nisur aksionin politik,

Përfitimet

Deputetë të Partisë Demokratike, por sidomos të Lëvizjes Socialiste për Integrim kanë pranuar dhe përfunduar dieta, para për shpenzime për karburant dhe telefon edhe pasi braktisën Kuvendin dhe firmosën dorëzimin e mandatit të deputetit.



Tritan Shehu

Gjatë muajt shkurt të këtij viti, periudhë gjatë të cilës Partia Demokratike kishte braktisur jetën parlamentare për llogaritë e saj politike, Tritan Shehu ka përfunduar 3 mijë lekë në formë rimbursimi për fjetje në hotel.



Noka ka përfunduar nga buxheti i Kuvendit 35 000 lekë pagesë për qiranë e banesës.

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

ISH-DEPUTETËT QË PËRFITUAN DIETA NË MUAJIN MARS 2019

Emri	Partia	Shpenzime
Monika Kryemadhi,	LSI,	37,625 lekë dieta në muajin mars 2019.
Petrit Vasili,	LSI,	43,266 lekë dieta në muajin mars 2019.
Agron Çela,	LSI,	75,250 lekë dieta në muajin mars 2019.
Kejdi Mehmetaj,	LSI,	37,625 lekë dieta në muajin mars 2019.
Luan Rama,	LSI,	37,625 lekë dieta në muajin mars 2019.
Nard Ndoka,	PD,	4,000 lekë shpenzime për karburant, 1,700 lekë për telefon në muajin mars 2019.
Dhurata Çupi,	PD,	37,625 lekë dieta në muajin mars 2019.
Vangjel Tavo,	LSI,	75,250 lekë dieta në muajin mars 2019.
Përparim Spahiu,	LSI,	37,625 lekë dieta në muajin mars 2019.
Edmond Haxhinasto,	LSI,	37,625 lekë dieta në muajin mars 2019.
Endrit Brahimllari,	LSI,	37,625 lekë dieta në muajin mars 2019.
Florida Kërpaçi,	LSI,	37,625 lekë dieta në muajin mars 2019.
Nasip Naço,	LSI,	37,625 lekë dieta në muajin mars 2019.
Nora Malaj,	LSI,	37,625 lekë dieta në muajin mars 2019.
Sezar Rrokaj,	LSI,	37,625 lekë dieta në muajin mars 2019.
Viktor Tushaj,	LSI,	37,625 lekë dieta në muajin mars 2019.

Klajda Gjoshaj,	LSI,	37,625 lekë dieta në muajin mars 2019.
Edmond Panariti,	LSI,	37,625 lekë dieta në muajin mars 2019.
Silva Caka,	LSI,	37,625 lekë dieta në muajin mars 2019.

PËRFITUESIT NË MUAJIN SHKURT

Tritan Shehu,	PD,	3 mijë lekë për fjetje në hotel, muaj shkurt 2019, periudhë bojkoti.
Nora Malaj,	LSI,	7 500 lekë për pasaportë diplomatike, muaj shkurt 2019, periudhë bojkoti.
Nard Noka,	PDK,	35 000 lekë pagesë për qiranë e banesës, muaj shkurt 2019, periudhë bojkoti.
Nadire Meçorapaj,	PD,	35 000 lekë pagesë për qiranë e banesës, muaj shkurt 2019, periudhë bojkoti.
Valentina Duka,	PD,	37,625 lekë dieta, muaj shkurt 2019, periudhë bojkoti.
Romeo Gurakuqi,	PD,	75,250 lekë dieta, muaj shkurt 2019, periudhë bojkoti.
Lorenc Luka,	PD,	75,250 lekë dieta, muaj shkurt 2019, periudhë bojkoti.
Luan Baçi,	PD,	75,250 lekë dieta, muaj shkurt 2019, periudhë bojkoti.
Grida Shqima,	PD,	37,625 lekë dieta, muaj shkurt 2019, periudhë bojkoti.
Fatbardha Kadiu,	PD,	75,250 lekë dieta, muaj shkurt 2019, periudhë bojkoti.
Ervin Salianji,	PD,	37,625 lekë dieta, muaj shkurt 2019, periudhë bojkoti.
Vangjel Dule,	PBDNJ,	75,250 lekë dieta, muaj shkurt 2019, periudhë bojkoti.

DISA PËRFITIME TË DEPUTETËVE

-Paga e bazë 150 000 lekë në muaj.

-Shpërbim me 2 000 lekë çdo për pjesëmarrje në mbledhje të komisionit të.

-Deputeti përfiton çdo muaj 35 000 lekë për karburant.

-Deputeti merr çdo muaj 17 000 lekë për shpenzime telefoni.

-Deputetët që banojnë në rrethin e Tiranës përfitojnë dieta ditore deri në 6 ditë në muaj. -Deputetët që banojnë jashtë rrethit të Tiranës përfitojnë dieta ditore deri në 12 ditë në muaj. Ata përfitojnë deri në 150 000 lekë dieta në muaj, gati sa paga e tyre.

-Deputeti përfiton për çdo shërbim 3 000 lekë për çdo natë, për rimbursim të faturës së hotelit, ose 36 000 lekë në muaj për 12 ditë.

-Deputetët që banojnë në rrethe, përfitojnë pagesa për qira mujore me vlerën e tregut.

-Për sëmundjet gjatë ushtrimit të detyrës, deputeti dërgohet për kurim jashtë shtetit.

-Deputetit i njihet e drejta e lejes vjetore të zakonshme jo me pak së 30 ditë.

-Deputetit dhe bashkëshortes së tij/saj u njihet e drejta e pajisjes me pasaportë diplomatike gjatë kohës së kryerjes së mandatit, si dhe 3 vjet pas mbarimit të tij.

-Gjatë mandatit 4-vjeçar mund të fusin vetëm një herë sende apo mallra në doganë, pa paguar detyrimet doganore.

-Deputetit i sigurohet mbrojtje e veçantë nga organet e Ministrisë së Rendit Publik, i ruhet banesa dhe i sigurohet shoqërimi në territorin e Republikës së Shqipërisë, kur ai i kërkon këto.

-Deputeti nuk i nënshtrohet kontrollit doganor.

-Deputeti përfiton me përparësi të drejtën e strehimit ose i jepet kredi afatgjatë nga organet shtetërore përkatëse.

NR	Emri Mbiemri	Karburant	Rimbursime per shpenzime telefon	Dieta	Honorare per mbledhje te komisionit	Ta...
1	Agron Çela	0	17,000	75,250	12,000	0
2	Alejandra Rista	40,000	0	0	0	0
3	Albana Vokshi	0	0	0	0	8,000
4	Aldo Burci	33,702	17,000	37,625	0	22,000
5	Anastas Angjeli	40,000	17,000	75,250	0	18,000
6	Andrea Marto	40,000	17,000	75,250	0	16,000
7	Antoneta Dhima	40,000	17,000	37,625	0	18,000
8	Andruel Xhindi	40,000	17,000	37,625	0	12,000
9	Bashkim Baraj	30,016	17,000	37,625	0	8,000
10	Besnik Gjylmeti	30,016	17,000	37,625	0	6,000
11	Blerina Çela	40,000	17,000	0	0	0
12	Blendi	0	0	0	0	0
13	Dashamir Shehi	0	0	0	0	0
14	Edi Paloka	0	0	75,250	0	14,000
15	Edmond Spaho	30,016	17,000	75,250	0	8,000
16	Ervin Bushati	33,702	17,000	75,250	0	0
17	Evis Klusha	0	0	0	0	2,000
18	Fatmir Mediu	31,214	17,000	37,625	0	0
19	Fidel Vili	0	0	0	0	0
20	Hamur Noka	0	0	0	0	0
21	Florion Mima	0	0	0	0	0
22	Genc Pollo	0	0	0	0	12,500
23	Gent Strazimiri	0	0	0	0	12,500
24	Gramoz Ruzi	40,000	17,000	75,250	0	0
25	Ilir Xhakollari	40,000	17,000	75,250	0	0
26	Ilirjan Pencavri	0	0	0	0	6,000
27	Jordani Tabaku	0	0	0	0	0
28	Klodiana Spahiu	31,214	17,000	37,625	0	0
29	Kejdi Mehmetaj	0	0	0	0	37,625
30	Kejdi Rama	0	0	0	0	75,250
31	Luan Rama	33,702	17,000	75,250	0	0
32	Luan Dusha	0	0	0	0	37,625
33	Luciano Boci	0	0	0	0	37,625
34	Monika Kryemadhi	33,702	17,000	37,625	0	0
35	Musa Ulqini	4,000	17,000	75,250	0	10,000
36	Nard Ndoka	30,016	17,000	0	0	0
37	Nard Ndoka	33,702	17,000	37,625	0	12,000
38	Nora Malaj	0	0	0	0	8,000
39	Edlira Bode	33,702	17,000	75,250	0	0
40	Edmond Haxhinasto	40,000	17,000	75,250	0	24,000
41	Elena Xhina	0	0	0	0	10,000
42	Elona Hoxha	0	0	0	0	37,625
43	Endrit Haxha	30,016	17,000	37,625	0	18,000
44	Endrit Brahimllari	0	0	0	0	0
45	Enkelejd Alibeaj	0	0	0	0	37,625
46	Ervin Salianji	0	0	0	0	0
47	Fadil Nasufi	40,000	0	0	0	0
48	Fatbardha Kadiu	0	17,000	75,250	0	8,000
49	Fatmir Velaj	40,000	0	0	0	0
50	Fatmir Velaj	40,000	17,000	75,250	0	4,000

Tipi shprehës	honorare Neto	Rimbursim për qera banesore	Tatimi	Rimbursim për qera banesore (neto)	Hotel	Pasaportë Diplomatike	Totale përfundime (neto)
0	0	0	0	0	0	0	75,250
1,800	10,200	0	0	0	0	0	142,450
0	0	0	0	0	0	0	95,127
0	0	0	0	0	0	0	150,950
1,200	6,800	0	0	0	0	0	147,550
3,300	18,700	0	0	0	0	0	145,550
2,700	15,300	0	0	0	0	0	109,925
2,400	13,600	0	0	0	0	0	94,841
2,700	15,300	0	0	0	0	0	91,441
1,800	10,200	0	0	0	0	0	99,725
1,200	6,800	0	0	0	0	0	0
900	5,100	0	0	0	0	0	0
0	0	0	0	0	0	0	134,160
0	0	0	0	0	0	0	132,752
2,100	11,900	0	0	0	0	0	87,539
1,200	6,800	0	0	0	0	0	0
300	1,700	0	0	0	0	0	37,625
0	0	0	0	0	0	0	138,185
0	0	0	0	0	0	0	94,841
0	0	0	0	0	0	0	65,519
0	0	0	0	0	0	0	104,825
0	0	0	0	0	0	0	142,450
0	0	0	0	0	0	0	168,800
0	0	0	0	0	0	0	0
1,875	10,625	0	0	0	0	0	100,368
0	0	0	0	0	0	0	58,700
1,200	6,800	35,000	5,250	29,750	0	0	128,564
0	0	0	0	0	0	0	37,625
0	0	0	0	0	0	0	37,625
900	5,100	0	0	0	0	0	109,741
0	0	0	0	0	0	0	137,852
0	0	0	0	0	0	0	75,250
0	0	0	0	0	0	0	20,400
1,000	2,100	11,900	0	0	0	0	100,217
0	0	0	0	0	0	0	93,341
0	0	0	0	0	0	0	2,400
1,000	2,100	11,900	0	0	0	0	37,625
4,000	2,100	11,900	0	0	0	0	170,500
0	0	0	0	0	0	0	43,266
0	3,000	17,000	0	0	0	0	115,025
0	1,500	8,500	0	0	0	0	111,625
0	0	0	0	0	0	0	140,750
0	1,800	10,200	0	0	0	0	0
0	1,200	6,800	0	0	0	0	94,841
0	3,600	20,400	0	0	0	0	132,752
0	1,500	8,500	35,000	5,250	29,750	0	0
0	0	0	0	0	0	0	146,352
0	2,700	15,300	0	0	0	0	170,500
0	0	0	0	0	0	0	37,625
0	0	0	0	0	0	0	99,941
0	0	0	0	0	0	0	37,625
1,200	6,800	35,000	5,250	29,750	0	0	168,800
600	3,400	0	0	0	0	0	168,800
600	3,400	35,000	5,250	29,750	0	0	455,400



Basha mesazh ish-kryebashkiakëve: Do kandidoni në zgjedhjet e tjera

Kreu i PD heq dorë nga rezistenca dhe tenton të zbusë kryebashkiakët duke u premtuar se do t'i rikandidojë në 2023

Kryetari i PD-së Lulzim Basha, pas rënies së bastioneve të PD-së në Kavajë, Kamzës dhe disa bashki të tjerë duket se ka hequr dorë nga rezistenca dhe deklaratat se nuk do i lirojnë zyrtarët duke u vetëdijësuar për verdiktin e 30 Qershorit, edhe pse zgjedhjet i cilëson ilegjitime duke mos i njohur. Por, në të njëjtën kohë Basha po synon të zbusë ish-kryebashkiakët e PD, të cilët janë të zemëruar dhe të zhgënjyer për dorëzimin nga Basha të të gjitha bashkive. Basha u dha dje një mesazh ish-kryebashkiakëve se do t'i kandidojë në zgjedhjet e ardhshme lokale, të cilat do të mbahen në 2023. Gjatë një takimi në Mallakastër ku i pranishëm ishte edhe kryetari në detyrë Agron Kapllanaj, Basha tha se Agron Kapllanaj tashmë do të jetë kandidat për kryebashkiak në zgjedhjet e ardhshme. “Agron Kapllanaj do të jetë kandidat për kryetar bashkie në zgjedhjet kushtetuese për pushtetin vendor dhe pa asnjë dyshim, edhe kryetari i ardhshëm i Bashkisë Mallakastër. Pseudokandidatura e Rilindjes që u refuzua bindshëm edhe nga vetë socialistët nuk mund të jetë kurrë kryetar i bashkisë Mallakastër. Koha për të vendosur me votë kryetarin e vërtetë të bashkisë, sipas Kushtetutës shqiptare, sipas Kodit Zgjedhor nuk do të vonojë. Beteja jonë ka nisur me një qëllim, t’u rikthejë shqiptarëve të drejtën e dhunuar të votës së lirë. Kjo betejë ka për të përfunduar me një rezultat, largimin e Edi Ramës, zgjedhje të parakohshme parlamentare dhe zgjedhje vendore në të njëjtën ditë”, tha Basha.

kriminaliteti janë ngritur në fron. Atje, popullit sovran, nëse nuk i hapet rrugë zgjidhjes politike, zgjidhjes që çdo vend tjetër i rajonit e ka patur në kushte akoma më të lehta sesa kriza e sotme shqiptare, një qeverie tranzitore dhe zgjedhjeve të parakohshme, atëherë popullit sovran i lind e drejta ta marrë dorën e vet zgjidhjen, me të gjitha format, mjetet dhe mënyrat që i gjykon të përshtatshme për të rivendosur demokracinë dhe drejtësinë”, u shpreh Basha. Në fund të fjalës së tij ai kishte edhe një paralajmërim kur PD-ja të vijë në pushtet. “Një nga gjërat e para që do të bëjë qeveria e re, e dalë me votë të lirë është që gjithsecili që ka shkelur ligjin dhe është kthyer në vegël të verbër të Edi Ramës, do të mbajë përgjegjësi ligjore. Asnjëri prej tyre nuk do të harrohet, që nga ky i Mallakastrës, deri tek Edi


Rama” përfundoi Basha.

31 VJETORI I VDEKJES SË POETIT HAVZI NELA

Dje ishte 31 vjetori i vdekjes së poetit Havzi Nela, i varur në qytetin e Kukësit nga regjimi diktatorial. Kreu i Partisë Demokratike, Lulzim Basha solli në vëmendje rastin e poetit, teksa ka bërë një analogji me ngjarjet se së tashmes, duke qenë se herë pas herë në fokus të akuzave të tij ka qenë se Rama po e shndërron vendin në një sistem diktatorial. Në një reagim të gjatë për mediat, kryedemokrati shkruan se heshtja e popullit, përpara atij vendimi të partisë që e shiti vendimin si të drejtë me anë të propagandës, ishte një akt i turpshëm që sipas duhet të shërbejë si mësim për ngjarjet sot. Ai shkruan se përballë kësaj qeverie, për të cilën akuzat janë të panumërta, nuk duhet heshtur, por duhet një reagim qytetar për t’i sjellë fundin e saj. “Përsëritja do e zhyste shoqërinë tonë në fatalitet, do na rreshtonte përfundimisht në ato bashkësi të destinuara të mos mësojnë nga historia e tyre e rrjedhimisht të gllabërohen nga spiralja e ndëshkimit dhe e zhbërjes. Kam bindjen se një shoqëri vitale si e jona nuk ka për t’u ndalur vetëm në evokimin e turpit të 10 gushtit të 1988-s. Poeti Havzi Nela është therori që do na ndihmojë ta kapërcejmë pengesën që po hasim në tejkalimin e tranzicionit drejt një shoqërie demokratike evropiane. Flijimi barbar i poetit që i këndonte lirive të Perëndimit, na kujton se metastazat e klikës së avaveze dhe metodave të despotizmit gjakatar oriental që na sundonte në 1988-n, janë mes nesh e janë përhapur, duke shfrytëzuar brishtësinë e tranzicionit. Beteja deri në fitoren e idealit të një shoqërie të lirisë dhe dinjitetit individual është beteja për të drejtën, është edhe pendesa dhe reflektimi i amanetit të Havzi Nelës. Librat e shenjta na rrëfejnë se duhet të ndjekim të drejtën, pa rreshtur, pa mëdysheje, pa u lodhur. Në këtë vigjilje të së Kremtes së Sakrificës, s’ka akt më kuptimplotë sesa të nderojmë kujtimin dhe sakrificën sublime të Havzi Nelës, këtij apostulli të demokracisë shqiptare, dhe të zotohemi se sakrificë e tij nuk do të shkojë dëm!”, tha Basha.

PD e akuzon, Valdrin Pjetri publikon certifikatat e pastërtisë së figurës në Itali

Kreu i ri i bashkisë së Shkodrës, Valdrin Pjetri u është përgjigjur edhe një herë akuzave të Partisë Demokratike për sa i përket pastërtisë së tij me drejtësinë. PD ka ngritur pretendime ndaj Pjetrit se ai ka probleme me shtetin italian madje ka bërë edhe një kërkesë në prokurori për të verifikuar nëse ai ka fshehur te kaluarën në formularin e dekriminalizimit. Edhe pse Pjetri i ka mohuar akuzat edhe më parë duke thënë se është hapur për çdo lloj verifikimi, PD nuk është ndalur me akuzat ndaj. I gjendur në këtë situatë Pjetri ka publikuar dy certifikata ku në to deklarohet nga organet në Itali se ai nuk ka probleme dhe se nuk është marrë kurrë si i pandehur. PD e akuzonte Pjetrin se shteti italian e ka përzënë në vitin 2002 dhe deri në 2010 nuk ka hyrë më në shtetin fqinj, Pjetri por në dokumentet e publikuara nga kryebashkiaku i ri i Shkodrës këto akuzat bien. Pjetri i ka quajtur akuzat asgjë më shumë sesa dështime që thjeshtë kërkojnë t’i njollosin emrin. Në dy certifikatat e publikuara nga Pjetri, Ministria e Drejtësisë në Itali e shpall ‘Nul’ pjesën e denimeve për Pjetrin që do të thotë se ai nuk ka probleme me drejtësinë italiane. Ndërsa në prokurorinë e Republikës, Firenze thuhet se Pjetri nuk është marrë asnjëherë si i pandehur. “Nuk dua të hyj në baltën e PD-së, e cila ka javë që kërkon të njollosë figurën time. Ja ku janë certifikatat e pastërtisë së figurës time në shtetin Italian. Të tjerat ia kam lënë atyre që duan të mbulojnë dështimet e tyre disa vjeçare duke njollosur emrin tim. Ditë më të mira po vijmë për Shkodrën dhe banorët e saj”, shkruan ai. Ndërsa në certifikatat e publikuara nga Pjetri thuhet: “Deklarohet se në arkivin e vendimeve gjyqësore, nuk ka asnjë rast që të jetë proceduar qytetari shqiptar, Valdrin Pjetri. Nuk rezultoi të jetë ndaj tij asnjë procedurë ku ai të jetë marrë në cilësinë e të pandehurit. Kjo certifikatë ka të bëjë me regjistrat informatik të Prokurorisë së Republikës së Firences. Ka të bëjë me kërkesën e personit të sipër përmendur i cili nuk është rezident në Itali”. Ndërkaq, më herët



30 qershorit, Valdrin Pjetri. Ndonëse ky i fundit i mohoi akuzat e ardhura nga selia blu, dje PD-ja me anë të Sekretarit të Përgjithshëm Gazmet Bardhi, ka “përdorur” Pjetrin për të sulmuar kryeministrin Edi Rama. Në daljen përpara mediave, Bardhi tha se Rama me ardhjen e tij në pushtet ka promovuar në politikë figura me të shkuar kriminale dhe se me anë të tyre po përpiqet që të mbajë karrigen e pushtetit. “Edi Rama është sot promovuesi më i madh i kriminit në Shqipëri. Që prej ardhjes së tij në pushtet, ai ka promovuar në politikë mbi 300 zyrtarë nga niveli më i ulët deri tek deputetë dhe kryetarë bashkie. Pushteti i tij i ka themelet tek krimi dhe kjo është arsyeja pse ai nuk heq dorë nga promovimi i trafikantëve të drogës në majat e pushtetit të tij. Valdrin Pjetri është njëri prej tyre”.

↓

Detajet

STRATEGJIA

Basha po synon të zbusë ish-kryebashkiakët e PD, të cilët janë të zemëruar dhe të zhgënjyer për dorëzimin nga Basha të të gjitha bashkive. Ai u dha dje një mesazh ish-kryebashkiakëve se do t'i kandidojë në zgjedhjet e ardhshme lokale, të cilat do të mbahen në 2023.

PREMTIMI

“Agron Kapllanaj do të jetë kandidat për kryetar bashkie në zgjedhjet kushtetuese për pushtetin vendor dhe pa asnjë dyshim, edhe kryetar i ardhshëm i Bashkisë Mallakastër”.

Partia Demokratike ka vijuar akuzat për kryebashkiakun e dalë nga zgjedhjet e

Qytetarëve u kthehen edhe 10.500 m² plazhe në Shëngjin e Velipojë

Kryeministri Edi Rama: "Nga bashkitë e djathta aty janë krijuar xhungla të kahershme"

Aksioni anti-informalitet është shtrirë në bregdetin e Shëngjinit dhe Velipojës ku janë liruar 10.500 m² plazh të zaptuar në mënyrë të paligjshme, janë vënë nën hetim 9 persona mes tyre edhe drejtorë pranë bashkisë së Lezhës.

Lidhur me këtë aksion ka reaguar edhe kryeministri Edi Rama i cili i quan plazhet e Shëngjinit dhe Velipojës si dy nga xhunglat më të mëdha të krijuara nga rrumpalla e kahershme e dokumenteve të pronësisë dhe paafësia kronike e bashkive të djathta.

"Plazhet e Shëngjin-Velipojës, janë mbase dy xhunglat më të mëdha, që ka krijuar rrumpalla e kahershme e dokumenteve të pronës dhe paafësia e zulumhania kronike e bashkive të djathta. Çlirimi i tyre nga zaptuesit vazhdon përditë, por fundi pa kthim i lukunisë së zaptuesve, do të vijë me Ligjin e Ri për Vijën Bregdetare dhe dorën e hekurt që falë këtij ligji, shteti do të mund të vendosë nga viti që vjen, për t'ia kthyer përfundimisht plazhin Popullit", shkruan Rama teksa ka postuar foto nga aksioni i policisë.

Në kuadër të aksionit anti-informalitet u liruan 8.000 m² plazh në Shëngjin si dhe u sekuestruan 500 çadra e shezlongë. Nën hetim u vunë Arben Ndoj drejtor i Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Sokol Toma drejtori i Drejtorisë së Planifikimit të Territorit pranë Bashkisë Lezhë ndaj të cilëve rëndom akuzat për 'shpërdorim detyrë'. Policia pezulloi 5 subjekte që ushtronin aktivitet të paligjshëm duke mos paguar shfrytëzimin e hapësirave publike. Nën hetim u vunë pronarët e këtyre subjekteve N.K., Sh.L., E.L.,

L.K., dhe M.T., për veprat penale "Fshehja e të ardhurave" dhe "Mospagim i taksave".

Ndërkohë, në Velipojë ku u liruan 2.500 m² plazh dhe u sekuestruan 235 komplete pushuesish (shezlongë + çadra + karrige). Policia e Shkodrës nisi hetimet për dy nga pronarët e subjekteve, L.M. dhe SH.N., që kishin zaptuar këtë pjesë të bregdetit.

Një tjetër plazh është liruar në kuadër të aksionit anti-informalitet. Gjiri i Krorëzës mbi të cilin kishte rënë 'flama' e zaptimit i është kthyer sot në normalitet. Lajmi është bërë



i ditur nga kryeministri Edi Rama i cili shprehet se nga sot simotra e mrekullueshme e Gjipesë i kthehet pushuesve. "Krorëza është një simotër e mrekullueshme e Gjipesë, ku njësoj si në Gjipe, kishte rënë flama e zaptimit zhvirgjerues

të plazhit mahnitës e të natyrës magjike, që të kujton filmin e Uliksit. Por nga sot, edhe Gjiri i Krorëzës u çlirua dhe paqja mijëra vjeçare u kthye në atë plazh, që i përket perlave të Kurorës Mesdhetare", shkruan Rama.

Braçe: "Havana" dhe "Tajvani" kërcënuan inspektorët, kanë punë me ligjin

"Mos u bini kot celularëve të ministrave, paguani detyrimet në shtet"

Zv. kryeministri Erion Braçe paralajmëroi bizneset që nuk paguajnë taksat se do të përballen me përgjegjësi ligjore. Ai u shpreh se administratorët e Havanës dhe Taivanit kanë kërcënuar inspektorët tatimorë duke i kujtuar dënimet për këto raste. "Apel të gjithë administratorëve dhe pronarëve që kanë qenë në vëzhgim. Kërcënime ndaj nëpunës të shtetit do të ndëshkohen pa mëshirë. I kërkoj administratorëve të Tajvanit dhe Havanës se çdo kërcënim i paraqitur ndaj inspektorëve që do të përballen me ligjin. Çdo gërmë kërcënuese do trajtohet si krim. Pavarësisht se presidenti nuk na e dha mundësinë për të vënë në zbatim kodin penal, ne do bëjmë aq sa na lejon ligji", tha Braçe.

Braçela të nënkutohej se edhe ai është kërcënuar nga administratorët e bizneseve të cilët janë ndëshkuar në kuadër të aksionit anti-informalitet. "Organet e policisë së shtetit kanë vijuar detyrën menjëherë pas kësaj. Pas fat të keq dhe për fat të mirë unë nuk dëgjoj nga ky vesh. Mos t'i bien celularit fare, dhe as mos të

shkruajnë në rrjetet sociale. Kush shan merr mbapsht mënyrën si adresohet dhe drejtohet", tha ai.

Duke ironizuar akuzat e kryedemokratit Lulzim Basha, zv.kryeministri tha se ai duhet t'i drejtohet se Prokurorisë për të bërë një denoncim pasi nuk do arrestohet për pastrim parash. "Lulzim Bashës dhe çdo qytetari që ka dyshime mbi veprimet e çdo organi t'i drejtohen prokurorisë me një akuzë konkrete. Lulzim Basha të mos ketë frikë. Nëse shkon në prokurori për të denoncuar nuk të arrestojnë për pastrim parash. Zyrat e prokurorisë janë të hapura", tha Braçe.

Numri 2 i qeverisë u bëri apel gjyqtarëve që të respektojnë ligjin me përpikmëri për të mos favorizuar bizneset e mëdha. "U bëj një apel gjyqtarëve të gjykatësve administrative të bëjnë kujdes, të respektojnë ligjin. Me një vendim të paprecedentë në mes të Tiranë. Në rastin kur një njësi kapet pa kupon tatimor, llogaritet gjoba. Në rastin kur kapet për herë të dytë pa kupon tatimor është e detyrueshme mbyllja për 30 ditë e kësaj

njësie. Nuk ka gjykatës të mos bllokojë ligji. Për sa kohë ligji e detyron gjykatësin të vlerësojë dëmin e rëndë ai duhet të zbatojë ligjin", deklaroi Braçe.

"Nuk do të ketë asnjë lloj favorizimi. Gjatë këtyre 10 ditëve drejtorja e tatim-paguesve ka bllokuar llogarinë e 22 prej tyre. Disa kanë reaguar ndërsa disa të tjerë nuk kanë reaguar. Prej tyre kanë rënë telefonat e drejtorëve, deputetëve dhe disa ministrave. Po e përsëris. Mos u lodhni kot. Asnjë telefon nuk iu ndihmon dot. Beteja për të formalizuar çdo transaksion përfshirë edhe shërbimet në restorante dhe bare në vijën bregdetare është fokusuar tek njësitë e mëdha. Nuk kërkojmë prej tyre asgjë veç detyrimeve, kupon tatimor për çdo blerje dhe shitje. Janë mbyllur disa njësi. Nuk ju duhet as gjoba dhe as mbyllja e njësisë së tyre, Na duhet të punojnë ligjërish dhe të paguajnë detyrimet. Ata që kanë nisur këngën që po i mbyllni për një kupon, dua t'iu them se nuk bëhet fjalë për asgjë përveç zbatimit të ligjit. Secili prej tyre do kalojë në procesin e rivlerësimit", tha Braçe.

Duke shtuar se gjatë kontrolleve në bizneset e hidrokarbureve janë vënë në diferencë mes mallit të shitur dhe atij të deklaruar. Braçe tha se diferenca në litra do t'u nënshtrohet detyrimeve fiskale.

"Në tregun e karburanteve vazhdon të gëlojë paligjshmëria në aspektin fiskal. Ajo është bërë aq e gjerë deri në kufijtë e shkeljes së kodit penal. Përmes regjimit të kasës me regjim manual të ndaluar me ligj. Nga këto kanë dalë diferenca mes shifrave të shitura dhe atyre të deklaruar. Diferencat arrijnë në mijëra ton. Po bëhet verifikimi i të gjitha kasave. Diferenca në litra do i nënshtrohet detyrimeve fiskale deri në çindarkën e fundit. Të gjithë ata që kapen me shkelje duke nisur nga dy që kenë në pranga. Dua të mbështes veprimet e prokurorëve në Elbasan dhe Tiranë. Hetimet e tyre janë jetike. Administrata doganore ka shtrirë kontrolle në magazina e lira, kryesisht në produktin benzinë. Të dy administratat janë udhëzuar të llogarisin diferencat", u shpreh Braçe.



Braçe

"Gjatë këtyre 10 ditëve drejtorja e tatim-paguesve ka bllokuar llogarinë e 22 prej tyre. Disa kanë reaguar ndërsa disa të tjerë nuk kanë reaguar. Prej tyre kanë rënë telefonat e drejtorëve, deputetëve dhe disa ministrave. Mos u lodhni kot. Asnjë telefon nuk iu ndihmon dot. Beteja për të formalizuar çdo transaksion përfshirë edhe shërbimet në restorante dhe bare në vijën bregdetare është fokusuar tek njësitë e mëdha, nuk kërkojmë prej tyre asgjë veç detyrimeve, kupon tatimor për çdo blerje dhe shitje"

ENERGJETIKA

Maqedonia e Veriut hap tenderin për interkonjeksionin më Shqipërinë

Operatori i sistemit të transmetimit të energjisë elektrike i Maqedonisë së Veriut ka hapur tenderin për të ndërtuar një linjë transmetimi 400 kV dhe një nënstacion të ri 400/110 kV në afërsi të Ohrit për t'i siguruar Maqedonisë së Veriut një ndërlidhje të energjisë elektrike me Shqipërinë. Projekti i interkonjeksionit i energjisë elektrike nga Maqedonia e Veriut përfshin ndërtimin e infrastrukturës së transmetimit



të energjisë nga Manastiri në kufirin shqiptar, me nënstacion në Ohër, sipas informacionit nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, e cila ka aprovuar një kredi deri në 37 milion euro, për projektin 49 milionë euro. Ndërkohë, edhe BE po bashkëfinancon projektin me një grant 12 milionë euro. Duke siguruar interkonjeksionin e parë mes Maqedonisë Veriore me Shqipërinë, projekti do të sigurojë

lidhjen që mungon në iniciativën për të krijuar një korridor transmetimi të energjisë elektrike Lindje-Perëndim midis Bullgarisë, Maqedonisë së Veriut, Shqipërisë, Malit të Zi dhe Italisë. Sekcioni midis Bullgarisë dhe Maqedonisë Veriore ka përfunduar. Shqipëria dhe Mali i Zi janë të lidhura me një linjë 400kV dhe kabloja nëndetare midis Italisë dhe Malit të Zi planifikohet të vihet në përdorim tregtar deri në fund të vitit.

vijon nga faqja 1

Territori i Shqipërisë është 2 milionë e 874 mijë hektarë, kështu që një e treta e sipërfaqes, e cila, sipas Bashës, është e mbjellë sot me kanabis del 950 hektarë. Sa për të patur një ide të asaj që thotë, rekordi i mbjelljeve të matura nëpërmjet kontrolleve ajrore të Guardia di Finanza-s ka qenë në vitin 2013 (kur ishin pikërisht Berisha dhe Basha në pushtet), me 323 hektarë të mbuluar me kanabis (319 prej të cilëve vetëm në Lazarat). Në vitin 2016, hektarët e mbjellë me drogë ishin 213 dhe në vitin 2017 vetëm 2.

Por, sikurse e pamë, Basha shton edhe një të dhënë tjetër, gjithnjë të nxjerrë nga dokumentari: "Sasia e kanabisit këtë vit është 5 herë më e lartë se vitin e kaluar" tha. Në vitin 2018, Guardia di Finanza, nëpërmjet fluturimeve të avionëve të saj, fotografoi më pak se një hektar të mbjellë me kanabis në të gjithë Shqipërinë. Pra, nëse do të ishte e vërtetë ajo që thotë Basha, që sasia e kanabisit sot është pesë herë më e madhe se në vitin 2018, kjo do të thotë se hektarët me kanabis këtë vit janë 5, pasi 1 X 5 bëjnë

Kanabisi, matematika e Bashës: 1 hektar x 5 = 950 hektarë

FLUTURIMET E GUARDIA DI FINANZA MBI SHQIPËRI, KONTROLLI I SIPËRFAQES DHE GJETJA E TERRITORIT TË MBJELLË ME KANABIS NË VITE

VITI	2013	2014	2015	2016	2017	2018
PERIUDHA	QERSHOR-KORRIK	QERSHOR-SHTATOR	QERSHOR-SHTATOR	QERSHOR-SHTATOR	MAJ-SHTATOR	PRILL-TETOR
MISIONET E FLUTURIMIT	25	39	39	42	53	69
ORËT E FLUTURIMIT	59h 40'	79h 45'	89h 46'	105h 53'	129h 15'	187h 42'
ZONA E KONTROLLUAR	361.800 ha	431.300 ha	459.900 ha	506.628 ha	683.249 ha	733.650 ha
PARCELAT E SHKATËRRUARA	304 + Lazarat	815+ Lazarat	1.368	2086	88	27
HAPESIRA E KULTIVUAR	323.5ha, vetëm në Lazarat 319ha	16.20 ha + Lazarat	44.7 ha	213.469 ha	1.971 ha	0.8543 ha
BIMËT E SHKATËRRUARA	14.772 s'ka shifra për Lazarat	46.605 +Lazarat	249.945	753.468	4.844	675

5 dhe jo 950, siç pretendon lideri i PD-së.

Për fat të keq, opozita vazhdon të lëshojë akuzat e saj politike pa i dokumentuar ato dhe madje pa reflektuar për ato që thotë.

Në rast se me të vërtetë do të ishin 950 hektarë të mbjella me kanabis sot (domethënë trefishi i vitit 2013), kjo do të thoshte që në çdo pyll, në çdo fushë dhe pas çdo shtëpie duhej të kishte bimë

marijuane. Por vetë Guardia di Finanza, pikërisht në reportazhin "Narcotica" që citon Basha, tregon se tashmë droga e gjetur në Shqipëri përmes avionit spiun zbulohet vetëm e fshehur nëpër

pyje dhe shpesh në zona malore. Një situatë që më shumë duket se përshtatet me shifrën e 5 hektarëve që mund të jenë zbuluar ndoshta deri tani dhe jo me përmasat kolosale të një të tretës

së territorit kombëtar të mbuluar me drogë, siç pretendon njëkohsisht Basha. Pesë hektarë janë shumë, po t'i krahasojmë me një ose dy vjet më parë dhe janë pak po t'i krahasojmë me përmasat që kultivimi i drogës kishte marrë në vitet e mëparshme. Por janë krejt një hiç në krahasim me një të tretën e territorit kombëtar.

Duhet thënë që pohimi i pabesueshëm se sot kanabisi ze një të tretën e territorit të vendit është bërë gjatë dokumentarit nga prokurori i Catanzaro-s Nicola Gratteri, i cili për Shqipërinë e sotme (ndryshe nga ata që jetojnë këtu) di shumë pak. Është e çuditshme se as gazetari autor i investigimit nuk e ka vënë re kontradiktën. Përtej njohjes së fakteve, në fakt, duhet të përdoret logjika për ndryshimin shumë të madh që ekziston midis një sipërfaqeje prej 5 hektarësh dhe një tjetre prej 950. Basha nuk mund të pretendojë të jetë i besueshëm kur i tregon të dy shifrat sikur të ishin të dyja të vërteta. Është fakt që as ai e as shumë të tjerë nuk e kanë shtruar problemin nëse ajo që thuhet ishte e vërtetë apo logjike. Pasi e rëndësishme në propagandën e kësaj opozite në panik tashmë është vetëm gënjeshtria. (c.b.)

Dokumentari i 'Rai 3', Rama: S'ka pikë lidhje, janë llafe

Kryeministri Edi Rama e cilëson humbje kohe dhe gazetari pa lidhje dokumentarin e transmetuar në "Rai 3" për fuqizimin e grupeve shqiptare në trafikun e drogës dhe kanabizimin e 1/3 së territorit. Teksa shpërndanë postimin e ministrit të Brendshëm për këtë çështje që është kthyer në armë nga opozita kundër qeverisë, kreu i qeverisë thotë se ato që vlejné më shumë janë reformat, punët dhe veprat, pasi sipas tij, ato do të flasin llafet t'i ketë marrë era. "S'kemi ç'bëjmë! E kotë të harxhosh kohë me shumëçka sot serviret ende si gazetari ,po me gazetarinë s'ka pikë lidhje. Çka vërtetë vlen çdo minutë janë reformat, punët, veprat. Ato do të flasin, kur llafet t'i ketë marrë era dhe baltën ta ketë fshirë uji i kohës", shkruan Rama.

SANDËR LLESHAJ

Ministri i Brendshëm Sandër Lleshaj e ka cilësuar dokumentarin e Rai3, si një mishmash i denjë për të ilustruar epideminë e 'fake news'. Në një reagim për mediat, Lleshaj shkruan se lufta kundër kanabisit është një bast i fituar për mazhorancën dhe se për këtë ka dokumente dhe shifra zyrtare, të cilat theksojnë se nuk janë evidentuar në asnjë pjesë të shkruarit, duke shtrembëruar të vërtetën. Ministri është ndalur të komentojë edhe akuzat e menjëhershme të opozitës, pas publikimit të dokumentarit që mban titullin "Narcotica", duke thënë se konsideron absurde që akuzojnë Policinë e Shtetit për njollat që kanë lënë ata vetë, ndonëse ka vënë theksin

Lleshaj: Opozita nxitoi të akuzojë policinë për njollat që la vetë! Mishmash i denjë i 'Fake news'

se kanabisi është një kapitull i mbyllur për Shqipërinë. "Një emision i televizionit italian "Rai 3" i pak ditëve më parë i mjaftoi opozitës që, si përherë,

të nxitonte për të kërcyer tek konkluzione halucinante, të cilat meritojnë vërtet keqardhje. Disa histori nga e shkuara si Lazarati, kjo "markë" auten-

tike e PD, apo edhe episode të tjera të shkuara (përzier në një sallatë televizive sensacionale, pa asnjë vlerë dokumentare, po me synimin e vetëm audiencën



Rama

"S'kemi ç'bëjmë! E kotë të harxhosh kohë me shumëçka sot serviret ende si gazetari ,po me gazetarinë s'ka pikë lidhje. Çka vërtetë vlen çdo minutë janë reformat, punët, veprat. Ato do të flasin, kur llafet t'i ketë marrë era dhe baltën ta ketë fshirë uji i kohës".



kanalin publik italian. Falë edhe bashkëpunimit të ngushtë me partnerët italianë, lufta kundër kanabisit si fenomen, është një luftë e fituar e shtetit shqiptar! Rezultatet në këtë fushë, të konfirmuara nga monitorimi i specializuar i partnerëve italianë, janë kokëforta dhe të mirënjohura. Fenomeni "Kanabis" është tanimë një histori e të shkuarës dhe lufta kundër tij një "bast" i fituar i kësaj mazhorance. Të gjitha shifrat provojnë këtë fakt. Fatmirësisht, autoritetet italiane e njohin shumë mirë dhe nga shumë afër, të vërtetën e luftës kundër kanabisit dhe bashkëpunimin e shkëlqyer policor mes dy vendeve. Ato kanë folur në të gjitha nivelet për këtë dhe unë besoj se do të shprehen edhe pas këtij reportazhi të Rai 3 - një mishmash i denjë për të ilustruar epideminë e 'fake news', shkruan Lleshaj. Në dokumentarin e mediejeve italiane me titull "Narcotica" tregohet trafiku i drogës në trekëndëshin Meksike-Kolumbi -Shqipëri me destinacion Italinë dhe Evropën. Grupet kriminale shqiptare, sipas dokumentarit janë fuqizuar ndjeshëm në trafikun e lëndëve narkotike, aq sa po kërkoni të blinin një nëndetëse për të trafikuar kokainën e ardhur prej Amerikës së Jugut përmes Mesdheut.

NJOFTIM

BSA
Bailiff Services Albania

Shoqëria Përmbartimore "Bailiff Services Albania" sh.p.k., me adresë Blv "Gjergj Fishta" Pallatet "Gora Kulla 2, Kati 2, Apartamenti 9, Tiranë, në zbatim të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, njofton se do të kryej procedurat për shitjen në ankand-2, të pasurive të paluajtshme në pronësi të z.Illir Breshani, me pale kreditore znj.Alma Breshani.

-Në datë 27.08.2019 ora 16:00.
-"Njesi" Pasuri nr. 58/278-N1, Vol.23, Fq.112, ZK.8518, me sip.40 m² me adrese lagja "Plazh/13", Durrës, ne pronesi te z.Illir Breshani, me çmimin fillestar 2,128,656 leke.
-"Apartament" Pasuri nr. 58/278+1-2, Vol.23, Fq.114, ZK.8518, me sip.63 m² me adrese lagja "Plazh/13", Durrës, ne pronesi te z.Illir Breshani, me çmimin fillestar 2,062,610.2 leke.

Për informacione mund të kontaktoni nr Tel: 044500278 ose adresën e-mail: alsidkamberi@gmail.com entonmuhametaj@gmail.com

NJOFTIM

BSA
Bailiff Services Albania

Shoqëria Përmbartimore "Bailiff Services Albania" sh.p.k., me adresë Blv "Gjergj Fishta" Pallatet "Gora Kulla 2, Kati 2, Apartamenti 9, Tiranë, në zbatim të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, njofton se do të kryej procedurat për shitjen në ankand-2, të pasurive të paluajtshme në pronësi të znj. Teuta Bektash Bajraktari, lënë garanci për "Alpha Bank" sh.a

-Në datë 28.08.2019 ora 16:00.
-"Njesi+Truall" Pasuri nr. 3/165-N3, Vol.12, Fq.213, ZK.8502, me sip.170 m² me adrese lagja "Mangalem", Berat, ne pronesi te znj.TeutaBektash Bajraktari, me çmimin fillestar 76,160 Euro.

Për informacione mund të kontaktoni nr Tel: 044500278 ose adresën e-mail: alsidkamberi@gmail.com entonmuhametaj@gmail.com

Financat: Ja rregullat e reja për bizneset nga 1 janari 2020

Projektligji është prezantuar për konsultim me grupet e interesit

GENC KONDI
TIRANE

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, e cila ka paraqitur pak kohë më parë për diskutim varjantin e parë të projektligjit që ndryshon rregullat e raportimit të xhiros dhe fitimit (Fiskalizimi elektronik), kishite vendosur, ndër të tjera, edhe limite për bizneset lidhur me sasinë e parave "cash" që janë të autorizuara të mbajnë në arkë e tyre. Limiti sërish mbetet, por ndërkohë, në varjantin e dytë, që ka dalë këto ditët e fundit në portalin zyrtar të Tatimeve, ka ndryshuar metodologjia e klasifikimit të bizneseve.

PROJEKTLIGJI

Sipas draftit aktual, tatimpaguesi që lëshon faturë mund të mbajë para "cash" (kartëmonedha dhe monedha), në fund të ditës së punës, deri në shumën maksimale të arkës. Kriteret për përcaktimin e shumës së maksimumit të arkës së tatimpaguesit që lëshon faturë, janë madhësia e tatimpaguesit që lëshon faturë, në përputhje me legjislacionin tatimor.

Bazuar në këtë kriter, tatimpaguesi që lëshon faturë, mund të caktojë shumën maksimale të parave kesh në arkë, në mënyrën e mëposhtme: tatimpaguesit me qarkullim vjetor në vitin e kaluar deri në 2 milionë lekë, deri në 500.000 lekë; tatimpaguesit me qarkullim vjetor mbi 2 milionë lekë, deri në 14 milionë lekë, deri në 300.000 lekë dhe tatimpaguesit me qarkullim vjetor mbi 14 milionë lekë, deri në 800.000 lekë.

VARJANTI FILLESTAR

Sipas draftit të parë, klasifikimi bëhej sipas vlerësimit në biznese mikro, të vegjël, të mesëm e të mëdhenj. Kështu, për subjektet mikro dhe personat fizikë, maksimumi i arkës do të ishte 150.000 lekë. Këtë detyrim do ta kishin kanë njësitë ekonomike, që në datën e raportimit nuk tejkalojnë kufijtë e të paktën dy prej

SASIA E PARASË "CASH" QË LEJOHET TË MBAHET NGA BIZNESET	
Tatimpaguesit me qarkullim vjetor në vitin e kaluar deri në 2 mln lekë	deri në 50.000 LEKË
Tatimpaguesit me qarkullim vjetor mbi 2 milionë deri në 14 milionë lekë	deri në 300.000 LEKË
Tatimpaguesit me qarkullim vjetor mbi 14 milionë lekë	deri në 800.000 LEKË
SUBJETET DHE AKTIVITETET QË NUK KANË DETYRIM PËR FATURË ELEKTRONIKE	
Prodhuesit bujqësorë, që operojnë sipas skemës së kompensimit të fermerit në përputhje me ligjin për TVSH-në	
Shitja e biletave dhe kuponave nga shoferi i mjetit të transportit në linjat e transportit urban	
Furnizimi i mallrave dhe shërbimeve nga persona fizikë të regjistruar në administratën tatimore si "ambulantë".	
Individët në rastet kur japin me qira një ambient	

tri kritereve të mëposhtme: aktivi të jetë 15 milionë lekë; të ardhurat nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) të jenë 30 milionë lekë dhe numri mesatar i punonjësve gjatë periudhës raportuese, 10. Në fund të vitit 2018, në vend kishte rreth 120 mijë ndërmarrje me më pak se 10 punonjës, duke përfshirë subjektet bujqësore, ose rreth 94% të totalit të subjekteve jo bujqësore në vend.

Ndërkohë, për subjektet e vogla maksimumi i arkës ishte vendosur në nivelin 500.000 lekë. Njësi ekonomike të vogla janë njësitë ekonomike, të cilat në datën e raportimit nuk tejkalojnë kufijtë e të paktën dy prej tri kritereve të mëposhtme: aktivi, 150 milionë lekë; të ardhurat nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi), 300 milionë lekë; numri mesatar i punonjësve gjatë periudhës raportuese, 50.

Për subjektet e mesme drafti parashikonte që maksimumi i arkës të ishte 800.000 lekë. Njësi ekonomike të mesme janë njësitë ekonomike, të cilat në datën e raportimit nuk tejkalojnë kufijtë e të paktën dy prej tri kritereve

të mëposhtme: aktivi, 750 milionë lekë; të ardhurat nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi), 1,5 miliardë lekë; numri mesatar i punonjësve gjatë periudhës raportuese, 250. Ndërsa për subjektet e mëdha maksimumi i arkës mendohej të ishte 1.700.000 lekë. Njësi ekonomike të mëdha quhen ato njësi, që në datën e raportimit tejkalojnë kufijtë e të paktën dy prej tri kritereve të mëposhtme: a) aktivi, 750 milionë lekë; të ardhurat nga veprimtaria

Fatura

Fatura për pagesat me para në dorë, duhet të printohet në letër me të gjitha të dhënat e nevojshme të faturës dhe t'i nënshtrohet procedurës së fiskalizimit, sipas këtij ligji, dhe t'i dorëzohet blerësit në momentin e furnizimit të mallrave ose shërbimeve



ekonomike (qarkullimi), 1,5 miliardë lekë; numri mesatar i punonjësve gjatë periudhës raportuese, 250.

Ky klasifikim zëvendësohet tani me vlerësimin e ri, sipas të cilit asnjë prej bizneseve nuk i lejohej të mbajë në arkë më shumë se 800 mijë lekë të reja në fund të ditës së punës.

PIKAT E AKTIVITETIT

Por si do të veprojë kur një biznes ka më shumë se një pikë, në të cilën ushtron aktivitetin etj? Projektligji, në fakt, thekson se maksimumi i arkës përcaktohet për tatimpaguesin që lëshon faturë në tërësi, dhe brenda kësaj shume, tatimpaguesi që lëshon faturë, mund të përcaktojë maksimumin e parave në arkë, sipas njësite të organizimit.

Kështu, tatimpaguesi që lëshon faturë, mund të përcaktojë maksimumin e arkës për çdo vend të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit, por deri në maksimumin prej 250.000 lekësh.

Ndërkohë, vetëm për biznese që kryejnë transaksione këmbimi monedhe (exchange) lejohej që ata të përcaktojnë një maksimum arke deri në shumën prej 1.700.000 lekë.

SHKELËSIT

Tatimpaguesi që lëshon faturë, të cilit i janë bllokuar llogaritë e biznesit për mospagim të detyrimeve, nuk mund të paguajë me para në dorë ose të mbajë para në arkë, por duhet që këto para t'i depozitojë menjëherë në llogarinë bankare për veprimtarinë e rregullt të biznesit, dhe jo më vonë se ditën e ardhshme të punës.

KASAT

Për bizneset e reja nuk do të parashikohet më detyrimi ligjor që të pajisen me kasë fiskale. Sipas projektligjit, nga data e hyrjes në fuqi të këtij lig-

Subjektet e bllokuar

Tatimpaguesi që lëshon faturë, të cilit i janë bllokuar llogaritë e biznesit për mospagim të detyrimeve, nuk mund të paguajë me para në dorë ose të mbajë para në arkë, por duhet që këto para t'i depozitojë menjëherë në llogarinë bankare



ji, për të gjithë tatimpaguesit e rinj të regjistruar, të cilët më parë ishin të detyruar të instalonin një pajisje fiskale për lëshimin e kuponave tatimorë, ky detyrim shfuqizohet, dhe në vend të kuponave tatimorë lëshohen dëftesa tatimore.

Fatura për pagesat me para në dorë, duhet të printohet në letër me të gjitha të dhënat e nevojshme të faturës dhe t'i nënshtrohet procedurës së fiskalizimit, sipas këtij ligji, dhe t'i dorëzohet blerësit në momentin e furnizimit të mallrave ose shërbimeve.

Ndërkohë, nëse ofrohet një shërbim elektronik ose furnizimi i mallrave ose shërbimeve kontrahetohet dhe paguhet nëpërmjet një aplikacioni celular, ose dyqani në internet apo të ngjashme, fatura nuk ka nevojë të printohet në letër, por mund t'i dërgohet blerësit ose marrësit të faturës, nëpërmjet postës elektronike (e-mail) ose si faturë elektronike.

FATURAT

Tatimpaguesit që duhet të lëshojnë faturë, pavarësisht nga qarkullimi vjetor i realizuar në vitin paraardhës ose në atë aktual janë: personat juridikë dhe fizikë, të cilët janë tatimpagues të tatimit mbi fitimin, në përputhje me ligjin "Për tatimin mbi të ardhurat"; personat juridikë dhe fizikë të cilët janë tatimpagues të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël,

në përputhje me ligjin "Për sistemin e taksave vendore"; personat juridikë dhe fizikë të cilët, pavarësisht nga forma e organizimit, përfshirë organizatat jofitimprurëse, fondacionet, njësitë e zbatimit të projekteve, organet publike qendrore e vendore, organizatat politike dhe institucionet e tjera të ngjashme me to, kur ushtrorjnë veprimtari ekonomike sipas kuptimit në ligjin "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë"; çdo person juridik, fizik, rezident ose jorrezident, pavarësisht nga forma e organizimit, kur furnizon mallra ose kryen shërbime ndaj organeve publike.

TË PËRJASHTUARIT

Tatimpaguesit që përjashtohen nga detyrimi për të lëshuar faturë janë prodhuesit bujqësorë, që operojnë sipas skemës së kompensimit të fermerit në përputhje me ligjin për TVSH-në. Përjashtohet gjithashtu nga lëshimi i faturës elektronike shitja e biletave dhe kuponave nga shoferi i mjetit të transportit në linjat e transportit urban, në përputhje me vendimet e njësite të vetëqeverisjes vendore dhe furnizimi i mallrave dhe shërbimeve nga persona fizikë të regjistruar në administratën tatimore si "ambulantë".

Gjithashtu, nuk e kanë këtë detyrim edhe individët në rastet kur japin me qira një ambient.

“Meta si specialist i bllokimeve shqetësohet për zhbllokimet”

Skënder Gjinushi: Meta është bërë pjesë e segmenteve politike për të sabotuar reformën në akademi

Kryetari i zgjedhur i Akademisë së Shkencave Skënder Gjinushi ka reaguar në një lidhje telefonike për Report Tv lidhur me vendimin e presidentit Ilir Meta për të kthyer në Kuvend ligjin për Akademine e Shkencave me argumentet se i cenon kompetencat. Gjinushi tha se Meta është bërë pjesë e segmenteve politike për të sabotuar Reformën në Akademi e cila tashmë është përshëndetur edhe nga Akademitë Europiane. Kreu i Akademisë së Shkencave tha se akademia nuk mund të sjellë përplasje kompetencash, pasi duhet të jesh injorant në fushën e jurisprudencës që të kesh përplasje. Gjinushi ironizoi Metën, të cili e quajti specialist bllokimesh, që shqetësohet për zhbllokimet. “Tani mesa duket kanë viktimizuar Ilir Metën duke e bërë pjesë të këtyre segmenteve politike për të sabotuar reformën në akademi. Reforma është ajo që është përshëndetur edhe nga Bashkimi i Akademive Europiane. Argumentet që e sulmojnë nuk kanë lidhje fare. Akademia ka një mision për

kërkimin shkencor dhe përpqet ta ushtrojë këtë mision fisnik dhe nuk mund të sjellë përplasje kompetencash. Duhet të jesh injorant në fushën e jurisprudencës që të kesh përplasje. Meta nuk zgjodhi rrugën e bashkëpunimit, as në rastin e emërimit. Ai duhet t'i ketë cilësitë për ta ushtuar këtë nder. Si mundet që një president të shqetësohet se ligji parashikon zhbllokim? Të shqetësohesh për këtë do të thotë se Meta si specialist i bllokimeve është i shqetësuar për zhbllokimet”, tha ai. Gjinushi komentoi edhe vendimin e Metës për të kthyer në Kuvend emërimin tij në krye të Akademisë së Shkencave. Ai tha se në këtë rast presidentit i jepet nderi vetëm të dekretojë dhe jo të blloktojë për arsye klienteliste. “Dekreti i tij i para një muaji është antikushetues. Ka bërë një autogol. Kushtetutën në 98 e kemi bërë se bashku. Meqë do të dijë pse është shkruar kështu ky nen, le të lexojë. Nuk marr përsipër t'ia shpjegoj. Vetëm në kërkim shkencor nuk ka status më të lartë apo më të ulët. Kjo është një pengesë 2-3 javore dhe këto lloj argumentesh janë shteruar. Nuk

dua të bëj leksione jurisprudencë por qëllimi i institucioneve është i përbashkët. Në shkencë më lart dhe më poshtë të vënë rezultatet, sepse këtë e ka në dorë formimi jo ligji. E ardhmja është e qartë. Nuk lejohet asnjë lloj ndërhyrje nga politika në emërime të tilla. Atij i jepet nderi vetëm të dekretojë. Këtu është lapsusi i parë injorant. Ligji dhe vetëm ligji e shpjegon. Meqë klanet politike për arsye klienteliste shkon deri këtu ligji parashikon edhe një zhbllokim”, u shpreh Gjinushi.

KONFLIKTI

Kreu i shtetit ktheu pardje në Kuvend për rishqyrtim ligjin për Akademine e Shkencave. Katër janë arsyet që renditi Meta për kthimin e ligjit; bie ndesh me parashikimet e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, cenon autonominë e institucioneve të arsimit të lartë, cenon kompetencat e Presidentit të Republikës dhe nuk është në harmoni me kuadrin ligjor ekzistues në Republikën e Shqipërisë. Ligji i miratuar në Kuvend detyron Presidentin që brenda 10 ditëve



Gjinushi

“Si mundet që një president të shqetësohet se ligji parashikon zhbllokim? Të shqetësohesh për këtë do të thotë se Meta si specialist i bllokimeve është i shqetësuar për zhbllokimet”.

të kryejë emërimin e kryetarit të Akademisë së Shkencave që i është propozuar. Për Metën kjo është antikushetuese, pasi Kushtetuta nuk ka vendosur një afat të përcaktuar, brenda të cilit Presidenti i Republikës duhet të shprehet. Gjithsesi, Kuvendi pritet ta rrëzojë me shpejtësi dekretin e Metës në shtator për kthimin e ligjit për Akademine e Shkencave, duke bërë të mundur hyrjen e ligjit në fuqi. Madje shumica ka shkurtuar edhe afatet dhe procedurat për shqyrtimin e dekretit të kreu të shtetit për kthimin e ligjeve.

Dekreti
“Dekreti i tij i para një muaji është antikushetues. Ka bërë një autogol. Kushtetutën në 98 e kemi bërë se bashku. Meqë do të dijë pse është shkruar kështu ky nen, le të lexojë. Nuk marr përsipër t'ia shpjegoj”.



Meta uron mirëmëngjesi me veshje sportive, përçon një mesazh politik

Presidenti Ilir Meta vijon pushimet në Prevallë, ku ndodhet prej disa ditësh bashkë me familjen e tij. Ditën e djeshme kreu i shtetit ka postuar edhe një video nga Ujëvara e Prevallës ku shfaqet me veshje sportive, nga ku uron një fundjavë të mbarë por përpqet të përçojë edhe një mesazh politik me simbolin e shqiponjës. Presidenti Meta shpesh herë e ka përdorur këtë simbol për të treguar se po lufton për të mirën e Shqipërisë, duke justifikuar sulmet e vazhdueshme ndaj qeverisë. “Mirëmëngjesi të dashur miq! Nga kjo ujëvarë e Bjeshkëve

të Prevallës, në lartësinë 1850 m, ju uroj të kaloni një fundjavë të mbarë e të gëzueshme me familjet dhe miqtë tuaj!”, shkruan Meta. Dy ditë më parë Meta bëri një krahasim mes kryeministrit Edi Rama dhe ish-presidentin serb Slobodan Millosheviç, ndërsa shigjetoj edhe Lulzim Bashën për bojkotin e zgjedhjeve të 13 tetorit. “Zgjedhjet janë e vetmja zgjidhje. Vetëm duke qëndruar në anën e ligjshmërisë dhe pjesëmarrjes në institucione, opozita mund të ndihmojë vendin, demokracinë, drejtësinë, por edhe vetveten. Nëse opozita në

Serbi do të priste që Millosheviçi të dënonte Millosheviçin, apo të garantonte zgjedhje të lira e të ndershme, padyshim që edhe sot e kësaj dite ai mund të ishte në pushtet po të mos i pushonte zemra. Por opozita mori vendimin më të drejtë duke u bashkuar, duke u përballur me të dhe duke e mundur. Më pas i vuri prangat dhe e përçolli për në gjykatën e Hagës. Ndaj zgjedhjet janë e vetmja zgjidhje për demokraci dhe drejtësi. Çdo gjë tjetër është justifikim, alibi dhe bashkëfajësi! 18 tetori po afron!”, tha Meta.

Balla inspekon punimet në Elbasan: Zgjidhëm problemin me përmytjet

Kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla së bashku me Kryetarin e Bashkisë së Elbasanit Gledian Llatja inspektuan punimet që po kryhen në disa zona të Elbasanit, qytet e fshat. Ata u ndalën në investimin që po bëhet për disiplinimin e ujërave të rrëmbyer të përroit të Larit, në Mengël. Në fjalën e tij Balla tha se duke qenë se ky përrua kalon në mes të zonës së banuar, jo rrallë herë ai ka shkaktuar përmytje. “Gjithë pjesa poshtë aksit Elbasan-Labinot ka vuajtur nga përmytjet për shkak të ujërave që shkaktohen nga përrnjtë të cilët derdhen në Shkumbin. Kjo lagje e Menglit e ka vuajtur më së shumti këtë problem pasi 2-3 herë në vit përmytjet nga ky përrua që kalon në mes të


lagjes. Përmytjet kanë shkaktuar edhe problematika në mirëfunksionimin e ujësjellës të qytetit. Ky është një investim i menjëhershëm i bashkisë dhe jemi këtu së bashku me Gledin për të parë këtë punë intensive që Bashkia Elbasan ka filluar me kryetarin e ri. Ka qenë një prej shqetësimeve që e kemi ngritur gjithmonë, por që nën drejtimin e Gledit po merr një zgjidhje të menjëhershme”, deklaroi Balla. Ndërsa kryebashkiaku Llatja tha se investimi konsiston në krijimin e një kanali të betonuar përgjatë gjithë zonës së banuar deri në derdhjen e tij në Shkumbin, si dhe private mbrojtëse. “Punët me cilësi janë qëllimi jonë, fokusi ynë kryesor dhe prandaj po dalim t'i inspektojmë të gjitha personalisht, sigurisht me inxhinierët



dhe specialistët e bashkisë. Jemi të gjithë në terren për të monitoruar punët publike që po bëhen, për të monitoruar të gjithë investimet që po bëhen Bashkia e Elbasanit dhe që kanë ndikim të drejtpërdrejtë tek qytetarët. Me këtë investim zgjidhim edhe një problem shumëvjeçar me përmytjen në sistemin e pompave të ujësjellës të qytetit” u shpreh Llatja.

Hajdari e ftuar në mbledhjen e fondeve për fushatën e Trump

Kryetarja e grupit demokrat në Kuvendin e Shqipërisë, Rudina Hajdari ka postuar në rrjetet sociale, foto nga aktiviteti i mbledhjes së fondeve për fushatën e radhës së Presidentit Amerikan, Donald Trump, në Hamptons, ku thotë se ishte e ftuar. “Ndihej në nderuar që isha e ftuar në aktivitetin e mbledhjes së fondeve për fushatën e radhës së Presidentit Amerikan, Donald Trump, në Hamptons. Në këtë aktivitet morën pjesë personalitete të shquara amerikane, si Bill O'Reilly dhe Geraldo Rivera, Senatori Lindsey Graham, Kongresmeni Lee Zeldin dhe djali i Presidentit, Donald Trump Jr.”, shkruan ajo në rrjetet sociale.



Shpallet në kërkim pronari i "Gega Oil", akuza për evazion fiskal

Paulin Gega: Jam nisur për pushime, nuk kam shkelur asnjëherë ligjin

Administratori i 'Gega Oil', Paulin Gega është shpallur në kërkim pasi akuzohet për pastrim parash dhe evazion fiskal në shumta të konsiderueshme. Mësohet se pas kontrollit të bërë disa ditë më parë, në kuadër të aksionit kundër informalitetit, rezultoi se janë gjetur pompa në shkelje të ligjit, për këtë arsye është bllokuar tregtimi i karburantit nga kompania "Gen Klaudis Sha". Pas bllokimit, janë bërë hetimet nga ku ka rezultuar se Gega përmes "Gen Klaudis Sha" që njihet me emrin tregtar "Gega Oil", ka kryer evazion fiskal në përmasa të konsiderueshme, por nuk dihet saktësisht për çfarë shume bëhet fjalë.

Prokuroria nxorri një urdhër ndalimi për Gegën, por rezultoi se ky i fundit është larguar ditën e djeshme nga Shqipëria. Gazetari i Report Tv, Arsen Rusta bën të ditur se ka nisur edhe një hetim për dyshimet e dekonspirimit të operacionit për arrestimin e Paulin Gegës i cili rezultoi se është larguar nga vendi pak orë para urdhër-arrestit ndaj tij. Megjithatë, në një reagim për mediat, Gega ka mohuar që të ketë shkelur ligjin, teksa tha se nuk i është shmangur drejtësisë, por ka ikur me pushime të cilat i kishte planifikuar kohë më parë. Ai ka mohuar akuzat se kompania e drejtuar prej tij nuk ka kryer evazion fiskal apo fshehje të të ardhurave, teksa theksoi se "Gega Oil" vijon aktivitetin pa ndërprerje në të gjithë vendin.

4 vite më parë ai ishte proceduar nga Drejtoria e Policisë Shkodër, për veprën penale fshehje e të ardhurave. Aksioni anti-informalitetit



Fortuzi, Tiranë, ku dhe mund ta verifikoni fare lehtësisht.

Sot ndërkohë jemi njoftuar në mënyrë indirekte pas lajmeve që kishin shpërthyer nëpër portale e gazeta të ndryshme, ku pretendohet se administratori i kompanisë Genklaudis sha, ishte larguar qëllimisht për t'iu shmangur përballjeve ligjore. Ne mund t'ju konfirmojmë që në njërin nga magazinat tona fiskale të shitjes me shumicë, që ndodhet në Vrinë, Durrës, është ushtuar një kontroll para dy ditësh, ku ka pasur një ndërprerje të aktivitetit vetëm për disa orë, me pretendimin se kasat e shitjes ishin të vendosura në regjim manual, pavarësisht se ne posedojmë



është shtrirë në të gjithë vendit dhe në të gjitha sektorët, duke nisur që nga sektori i ndërtimit deri te hidrokarburet.

REAGIMI

Paulin Gega, administrator i "Gega Oil" është shprehur se nuk është larguar jashtë vendit me qëllim arratisjen, por se është me pushime. "Jemi nisur për pushime verore në Greqi, më datë 09.08.2019, pushime të cilat janë rezervuar rreth dy muaj më parë të një agjenci turistike në rrugën

certifikatën e kalibrimit të regjimit automatik, e lëshuar sipas ligjeve në fuqi nga firma certifikuese e fiskalizimeve A.E Distribution shpk në vitin 2012! Mbas verifikimeve nga organet kompetente, u bë zhbllokimi i këtij stacioni shitjeje dhe aktiviteti ka vazhduar normalisht.

Pra, kompania jonë nuk ka kryer asnjë shkelje apo kundrvajtje penale as në aspektin evaziv apo të ashtuquajturës 'Fshehje e të ardhurave apo të pasurisë'.



UNHCR

United Nations High Commissioner for Refugees
Haut Commissariat des Nations Unies pour les réfugiés

INTERNAL/EXTERNAL VACANCYNOTICE ALB/TIR/19/NPO/04

Office of the United Nations High Commissioner for Refugees (UNHCR) in Tirana, Albania is looking for qualified and highly motivated candidates interested to apply for the following position:

Title of Position: Assistant External Relations Officer – P1/NOA (Professional Category)
Position Number: NP202267
Duty Station: Tirana, Albania
Type of contract: Fixed-Term Appointment
Date of Entry on Duty: 1 January 2020
Duration: 6 months (probation period)
Application Deadline: August 30th, 5:30 p.m. CET

1. ORGANIZATIONAL CONTEXT

Define the role of the position within the team, describing its leadership role, if any, its external/internal work relationships or contacts, the contextual environment in which it operates and the scope of supervision received, and where applicable, exercised by the incumbent.

The incumbent is closely supervised on issues concerning external relations and public information by the External Relations Officer or the Representative who give regular guidance and advice to the incumbent. Advice and operational support may also be received from other senior staff and support units at the Country Office.

External contacts are generally with a broad range of officials from national and international institutions, media or general public on matters of importance to the Organization.

2. FUNCTIONAL STATEMENT

Describe the accountabilities, responsibilities and authorities associated with the position.

Accountability (key results that will be achieved)

- UNHCR's media relations and advocacy work in geographic and thematic area are supported.
- UNHCR's standing with its counterparts is maintained.

Responsibility (process and functions undertaken to achieve results)

- Assist Senior Management in dealing with the challenges posed by the political context, the UN and humanitarian reform, and institutional developments in the area of forced displacement and humanitarian operations.
- Assist in planning and organizing communications strategy that generates support for UNHCR's operations from external partners (e.g. the general public, governments, partners, the media, academia and persons of concern).
- Assist in the dialogue with donors and embassies and provide accurate information by organizing regular briefings, bilateral meetings and missions.
- Assist Senior Management in disseminating information on UNHCR's global funding situation and mobilize additional funds to implement special projects aimed at enhancing the quality of protection for persons of concern.
- Participate when requested in the inter-agency cooperation and communication strategies, initiatives and tools.
- Assist in the management of information flows within the country operations by identifying priority matters, securing, analysing and disseminating documentation and information to support country operations and corporate communication processes and priorities.
- Assist in the drafting of situation reports, briefing notes, background material, talking points, fact sheets, press releases and articles.
- Assist in planning and organizing advertisements, exhibitions, training seminars, conferences, meetings, social events and other activities to promote a better understanding of UNHCR's activities and accomplishments by the general public and/or organized groups.
- Support the management of media relations by, inter alia, drafting responses to direct queries, draft press releases and organizing regular briefings and visits to country operations.
- Organize press briefings for external parties as required.

Authority (decisions made in executing responsibilities and to achieve results)

- Organize the distribution of UNHCR publications and the provision of materials to various institutions and individuals.
- Produce reports for donor agencies as required.

3. REQUIRED COMPETENCIES

which illustrate behaviours that are essential to achieving deliverables described above, and that are critical to successful performance. All jobs require the staff to abide to the Values and Core competencies of UNHCR. Where applicable, select a maximum of six Managerial and three Cross-Functional Competencies. (Note that the Performance Appraisal and Management System (PAMS) allows for up to five Cross-Functional Competencies to be selected by the staff member and the supervisor.

- | Code | Managerial Competencies |
|---|-------------------------------|
| 1. <input checked="" type="checkbox"/> M001 | Empowering and Building Trust |
| 2. <input type="checkbox"/> M002 | Managing Performance |
| 3. <input type="checkbox"/> M003 | Judgement and Decision Making |
| 4. <input type="checkbox"/> M004 | Strategic Planning and Vision |
| 5. <input type="checkbox"/> M005 | Leadership |
| 6. <input type="checkbox"/> M006 | Managing Resources |

- | Code | Managerial Competencies |
|---|-------------------------------------|
| 1. <input checked="" type="checkbox"/> X001 | Analytical Thinking |
| 2. <input checked="" type="checkbox"/> X002 | Innovation and Creativity |
| 3. <input type="checkbox"/> X003 | Technological Awareness |
| 4. <input type="checkbox"/> X004 | Negotiation and Conflict Resolution |
| 5. <input type="checkbox"/> X005 | Planning and Organizing |
| 6. <input type="checkbox"/> X006 | Policy Development and Research |
| 7. <input checked="" type="checkbox"/> X007 | Political Awareness |
| 8. <input type="checkbox"/> X008 | Stakeholder Management |
| 9. <input type="checkbox"/> X009 | Change Capability and Adaptability |

4. ESSENTIAL MINIMUM QUALIFICATIONS AND PROFESSIONAL EXPERIENCE REQUIRED

Define the educational background, the relevant job experience and the language(s) that are essential to perform the work of the position.

- Undergraduate degree (equivalent of a BA/BS) in Political or Social Sciences, International Relations, Journalism, Communication or other related fields plus minimum 1 year of previous work experience relevant to the function. Graduate degree (equivalent of a Master's) or Doctorate degree (equivalent of a PhD) may also be accepted.
- Computer and IT skills (MS Office, website preparation etc.).
- Highly developed drafting ability in working language of duty station.
- Excellent knowledge of local institution, politics and culture.
- Very good knowledge of local language and local institutions is essential
- Very good knowledge of English and UN working language of the duty station if not English.

5. DESIRABLE QUALIFICATIONS & COMPETENCIES

Describe any experience or knowledge that would be an asset, such as: UNHCR Learning Programmes, other training, additional languages, Field/HQs experience, etc.

- Completion of UNHCR learning programmes or specific training relevant to functions of the position.
- Knowledge of additional UN languages.

IMPORTANT NOTE:

- Interested candidates should read the Terms of Reference carefully and apply if suitably qualified.
- Interested candidates are required to submit signed Motivation Letter and UNHCR P11 form;
- UNHCR P11 form and Supplement form are available: **UNHCR Personal History Form** (open Hyperlink). Please note that any previous version of the P11 will no longer be considered;
- Applications of father, mother, son, daughter, or siblings of a staff member of UNHCR cannot be considered;
- Applications will not be acknowledged. Only shortlisted candidates will be contacted and invited for the written test and the interview;
- Applicants with working experience in International Organizations, preferably United Nations, are highly encouraged to apply;
- For any query please contact: albt@unhcr.org.

Interested candidates should submit their applications (Completed UNHCR Personal History (P.11) form, P11 Supplement form and Motivation Letter) electronically by e-mail to: albt@unhcr.org or in the sealed envelope addressed to: **UNHCR Albania, Skenderbej Str., Gurten Building, 2nd floor, Tirana, Albania** referring to the Vacancy Notice reference UNHCR: ALB/TIR/19/NPO/04

Deadline for submitting applications is 30 August, 2019, 17:30 CET. Late or incomplete applications received without the above specified documents will not be considered;

ARSEN RUSTA
TIRANE

Me karta italiane drejt Anglisë, arrestohet "koka" e grupit

Në pranga organizatori i grupit të trafikantëve, I.B, 29 vjeç

Policia Kufitare e Rinasit dhe Seksioni për Hetimin e Trafikeve të Paligjshme, ka kapur organizatorin e një grupi që trafikonte në mënyrë të paligjshme persona drejt vendeve të BE dhe Britanisë së Madhe. Organizatori i arrestuar është I. B., 29 vjeç, lindur në Durrës dhe banues në Itali. Ashtu siç raportoi Report Tv pak orë më parë në pranga kanë rënë edhe 4 persona të tjerë, ku sipas policisë tre prej tyre akuzohen për penale "Ndhimja për kalim të paligjshëm" dhe "Falsifikimi i letërnjoftimeve i pasaportave ose i vizave".

Pa kaluar 24 orë nga ndalimi i katër turqve të cilët me skemën e dy pasaportave një origjinale tek policia kufitare dhe një të falsifikuar tek avioni, Policia e Rinasit dhe departamenti i trafikeve pranë kufirit kanë kapur 4 shqiptarë. Mësohet se të arrestuarit në të njëjtin orar kishin zgjedhur të udhëtonin Tiranë-Lubjanë e disa prej



tyre me tranzit nga Lubjana në Paris. Arrestimi i tyre ka ardhur pasi gjatë kontrollit në vijën e dytë të bagazheve dhe sendeve personale u janë

sekustruar karta identiteti italiane të falsifikuara. Kjo skemë trafikimi apo kalimi në mënyrë të paligjshme të kufirit në vendet e BES është zbuluar

nga agjentët e policisë kufitare në Rinas dhe prej disa javësh janë shtuar masat e sigurisë. Ky fluks sqaruan burimet vjen pasi trafikantët kërkojnë të përfitojnë nga numri i lartë i udhëtarëve për të humbur gjurmët teksa hipin në avionë. Por një numër i shtuar i efektivëve që merren me sektorin e trafikimit të qenieve njerëzore janë instaluar në Rinas dhe po kryejnë kontrollin të shtuar.

Të arrestuarit janë A.C., 19 vjeç, banues në Koplik, Shkodër, i dyshuar për kryerjen e veprave penale "Ndhimja për kalim të paligjshëm" dhe "Falsifikimi i letërnjoftimeve i pasaportave ose i vizave", (këtë shtetasi iu gjetën në çantë kartat e identitetit italiane dhe kartat e shëndetit

italiane të falsifikuara); F. L., 25 vjeç, banues në Durrës, i dyshuar për kryerjen e veprës penale "Falsifikimi i letërnjoftimeve i pasaportave ose i vizave dhe K. A., 30 vjeç, banues në Durrës, i dyshuar për kryerjen e veprës penale "Falsifikimi i letërnjoftimeve i pasaportave ose i vizave".

Po ashtu mësohet se në pranga ka rënë edhe dhe një vajzë me iniciale CH.B. Po ashtu policia ka sekustruar edhe 4 karta identiteti italiane dhe 5 karta shëndeti italiane të dyshuara si të falsifikuara, 4 aparate celulare, 3 pasaporta shqiptare, 1 pasaportë italiane, 1 leje drejtimi italiane, 4 Boarding Pass me destinacion Tiranë - Lubjanë, 4 Boarding Pass me destinacion Lubjanë

- Paris. Arrestimi i këtyre personave ka ardhur në kuadër të operacionit "DEPARTURE" për goditjen e veprimtarisë kriminale të dhënies ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit me dokumente të falsifikuara, kundrejt fitimit. Ndërkohë të arrestuarit do të përballen me akuzat për veprat penale "Ndhimja për kalim të paligjshëm" dhe "Falsifikimi i letërnjoftimeve i pasaportave ose i vizave".

Numri i të kapurve në Rinas deri më tani arrin në 14 shtetas pjesë më e madhe e tyre Turq dhe Shiptarë të cilët me pasaportën e tyre origjinale kalojnë kontrollin policor e më pas ndërrojnë avionët apo kur paraqiten në zonën e BE përdorin dokumentet e falsifikuara.

ITALI

Fshihnin drogën në rrënjët e ullinjve, arrestohen 4 shqiptarë

Katër shqiptarë janë arrestuar në mungesë të djeshëm në Genova të Italisë, pasi ishin pjesë e një bande që merrej me trafik lëndësh narkotike. Policia sekuestroi 2.5 kg kokainë të pastër, mbi 15 mijë euro cash dhe një pistoletë kalibri gjysmë-utomatik 9x21 me 125 fishekë, shkruajnë mediat italiane. Deri tani nga gjykata janë dhënë 11 masa sigurie "arrest me burg", si dhe 1 "arrest shtëpie". Personat punonin në mënyrë autonome dhe bashkëpunonin me njëri-tjetrin. Të arrestuarit tregtonin drogë në disa sheshe në lagjet e Sampierdarena, Sestri Ponente dhe Rivarolo. Ata janë marrë dhe me vjedhje nafte, që u duhej për të mbushur makinat për transportin e drogës. Vjedhja e naftës u bë nga tanke dhe kamionë në zonën e Serra Ricc. Në fillim u vodh naftë në një kompani që prodhon kontejnerë, më pas në tanket e automjeteve



të parkuar në zona të ndryshme të kompanive. Hetimi filloi në shkurt 2018 kur u identifikua një grup i vogël, të cilët u monitoruan në disa zona të qytetit. Droga vinte nga periferia e Milanos dhe më pas paketohej dhe shitej në Xhenova. Ata e paketonin kryesisht në kuti dhe e fshihnin brenda gropave të ullinjve ose hyrjeve nëntokësore në Bolzaneto.

PËRPLASJA

Plagoset në Laç me armë kushëriri i Ervis Martinit

Plagoset me armë zjarri djali i xhaxhait të Ervis Martinit. Edon Martini 19-vjeç nga Fushë Kuçja e Kurbinit u qëllua me armë pasditen e djeshme në hyrje të qytetit në rrugën kryesore në lagjen nr.1. Ai u transportua në spitalin rajonal ku iu dha ndihma e parë dhe më pas në Tiranë te Trauma për ndërhyrje të specializuar, pasi ka marrë disa plagë dhe ndodhet në gjendje të rëndë për jetën. Policia deklaroi se plagosja ka ndodhur në rrethana të paqarta, ndërsa ka nisur hetimet dhe janë ngritur pika kontrolli si dhe po bëhet krehja e zonës me qëllim kapjen e autorit. Por kush është Ervis Martini? Ai është pronar i disa bizneseve në Tiranë dhe i akuzuar si i dyshuar në përplasjen me armë zjarri në zonën e ish-bllokut në Tiranë në tetor të vitit të kaluar ku mbeti një i vdekur. Martini mbeti i plagosur nga ngjarja ndërsa pas 7 muajsh në burg u lirua në maj të këtij viti kundrejt garancisë pasurore në vlerën e 5 milionë lekësh të rinj. Ndaj Ervis Martinit prokuroria e Tiranës ka ngritur 7 akuzat.



Report Tv solli dje pamjet nga postbolloqet që ka ngritur policia në Mamurras pas plagosjes së 19-vjeçarit Edon Martini. Ndërkohë që po kontrollon edhe e gjithë zona për të shkuar në gjurmët e personave që qëlluan mbi Martinin, i cili është plagosur dhe ndodhet në gjendje të rëndë në Tiranë. Gazetari i Report Tv Julian Shota

thotë se Edon Martini u qëllua me armë, ndërsa u gjet i plagosur dhe gjakosur nga banorët në anë të rrugës nacionale. Të dhënat e para janë kontradiktore, por dyshohet se ka pasur një shkëmbim zjarri mes dy palëve. Banorët i kanë dhënë ndihmën e parë të plagosurit dhe më pas kanë njoftuar ambulancën dhe policinë.

KOSOVË

Ndalohej dy gardistë nga Shqipëria, kishin me vete armët e shërbimit

Dje në rrugën "Marie Shllaku" në Gjilan janë ndaluar dy pjesëtarë të gardës së Republikës së Shqipërisë dhe u janë konfiskuar dy pistoletat. Njoftimi është konfirmuar nga Policia e Kosovës në raportin 24-orësh. Mediat kosovare bëjnë me dije se dy gardianëve nga Shqipëria u janë konfiskuar edhe 17 copë fishekë, ndërsa me vete kishin edhe lejet e përdorimit të armëve për territorin e Shqipërisë. Të ndaluarit janë dërguar para prokurorit përgjegjës për rastin, ndërsa mediat shkruajnë se pas intervistimit ata janë liruar pasi rasti do të trajtohet në procedurë të rregullt gjyqësore.



Zyra Përmbartimore Private "BAILIFF OFFICERS" sh.p.k., me adresë: Rr "Kavajës" pranë qendrës "Globe" Nd 124, Hyrja 8, Kati 2, Tiranë, në zbatim të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, njofton se do të kryej procedurat për shitjen në ankand-1, të pasurisë të paluajtshme, lënë garanci për Bankën "Credins" si më poshtë,

- NË DATË 29.08.2019 ORA 16:30

- Pasuri nr. 2/411-N2, ZK 8564, lloji i pasurisë (njesi) me sip. 54 m2, me adresë Korçë, në pronësi të znj.Merita Hasankolli, me çmimi fillestar 4,320,000 lekë.
- Pasuri nr. 2/411-N4, ZK 8564, lloji i pasurisë (njesi) me sip. 18 m2, me adresë Korçë, në pronësi të znj.Merita Hasankolli, me çmimi fillestar 1,440,000 lekë.
- Pasuri nr. 3/511-G5, ZK 8561, lloji i pasurisë (garazh) me sip. 44 m2, me adresë Korçë, në pronësi të z.Agron Hasankolli, me çmimi fillestar 1,760,000 lekë.

Për informacione mund të kontaktoni në numrin e Cel: +355 692044540 ose adresën e-mail: ilirdervishi85@gmail.com



Zyra Përmbartimore Private "BAILIFF OFFICERS" sh.p.k., me adresë: Rr "Kavajës" pranë qendrës "Globe" Nd 124, Hyrja 8, Kati 2, Tiranë, në zbatim të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, njofton se do të kryej procedurat për shitjen në ankand-1, të pasurisë të paluajtshme, lënë garanci për Bankën "Credins" si më poshtë,

- NË DATË 26.08.2019 ORA 16:30

- Pasuri nr. 162/159, ZK 2066, lloji i pasurisë (truall+ndertesë) me sip totale 536.4 m2 (truall) dhe 163,6 m2 (ndertesë), me adresë Kamëz, Tiranë, në pronësi të z.Murat Cara, me çmimi fillestar 48,485,600 lekë.

Për informacione mund të kontaktoni në numrin e Cel: +355 692044540 ose adresën e-mail: ilirdervishi85@gmail.com

Përtej kujtesës së Teatrit Kombëtar zgjedh ëndrrën për teatrin e ri

MIHO GJINI
TIRANE

Me dhimbje kam ndjekur “mbylljen e portave” të Teatrit Kombëtar, si edhe debatin nëse duhet mbajtur apo shembur godina ekzistuese e “Dopolavoros” që ngritën përkohësisht italianet 80 vjet më parë, për dëfrimin e ushtarëve të tyre! Në këtë dilemë të madhe që më pas, doli nga suaza e aktorëve e u politizua deri në ekstremin e vet, kam anuar nga logjika e ftohtë që te kemi po aty TEATRIN E RI Kombëtar. Është mallëngjyese ta mbash atë si kujtesë, po, nga ana tjetër, më përtej, artistët tanë, që e themeluan atë si institucion artistik dhe interpretuan qindra e qindra role, i kanë mjeruar aty brenda sëmundjet e lagështira e tmerrshme, e cila ua ka “brrejtur” kockat dhe shkatërruar mushkëritë ngadalë-ngadalë. Unë e di, si gjithkush, se si ua ka shkurtuar jetën “kosa” e vdekjes, njërin pas tjetrit.

Pse e them këtë? Sepse kam jetuar midis këtyre veteranëve të teatrit tonë që nga viti 1959 e jam një nga dëshmitarët e kësaj “vdekjeje të pazhurmë e tinëzare” të Ajkës së Artit tonë Kombëtar, thujse në gjysmën e moshës së tyre, si therori dhe flijë e kushteve antinjerëzore, ku “gatuhej” arti i tyre i madh. Ishte vërtet e habitshme se si përbrenda një mizerabiliteti kushtesh me “një cipë lustre sipër, bojë pas boje”, para një publiku tmerrësisht të apasionuar që zinte radhën gjatë natës për t'i parë e ngazëllyer me magjinë e artit të tyre, ata u bënë ikonat e artit shqiptar. Të kundërtat afroheshin në një harmoni rrëqethëse, që do të mbaronte, për fatin e keq, me ikjen e tyre nga kjo botë, njeri pas tjetrit.

Mihal Popi, që një gazetar i njohur italian i viteve 30 e ka quajtur “Komiku i Kryeqytetit Shqiptar” vdiq i pari, në mjerimin më të madh, pasi luajti në skenë Fallstafin e Shekspirin, me sforçime fryme, duke i dhënë regjisorin Kujtim Spahivogli shtyssa inkurajimi e force! Shpejtova të shkruaja një libër për të, për të arritur që “të mos shuhej qiriri” para se ta mbyllja kapakun e jetës e të krijimtarisë së tij. Befas ai zuri krevatin para kohe, në kulmin e karrierës së tij; nuk delte më nga shtëpia, dhe unë do ta gjeja në një nga ato karakatinat e vjetra që mbaheshin si më te mirat në Pazarin e Vjetër, me një tufë femijësh që i vinin rrotull, të shtrirë në një krevat druri, me brazda rrudhash të parakohshme në fytyrën e tretur nga gjithfarë soj sëmundjesh...Pasi i lexoja faqet e këtij libri në dorëshkrim, dëgjova rënkimin e tij të thellë. Ai po qante! “Nga i ke m'sue tan k'to gjana, or Adashi em?! Due me e pas një k'tu, ke koka, kët'libër, para se me dekë!”, - tha Ai tek ngashëreu thellë shpirtit të vet... Po fati tragjik që kundra për të tre Mihalët... Per Mihal Gjini (ky që po e shkruan këtë shkrim,

Pse e them këtë? Sepse kam jetuar midis veteranëve të teatrit tonë që nga viti 1959 e jam një nga dëshmitarët e kësaj “vdekjeje të pazhurmë e tinëzare” të Ajkës së Artit tonë Kombëtar, thujse në gjysmën e moshës së tyre, si therori dhe flijë e kushteve antinjerëzore, kur “gatuhej” arti i tyre i madh



i njohur me emrin Miho Gjini) të cilin e eliminuan nga skena publike dhe ia hoqë të drejtën e botimit, fill pas shfaqjes “Njollat e Murrme” në Festivalin e parë Kombëtar të Teatrove Profesioniste, bashkë me Mihal Luarasin, po edhe për Mihal Popin që do ta merrte Perëndia, tok me varfërinë e tij të tejskajshme, dhe me të qeshurat e “hidhura” që u la spektatorëve që e donin deri në përgjërimit!

Naim Frashërin, Aktorin që erdhi

nga Lufta, e kisha komshi, mik dhe pedagogun tim. E doja shumë e po kaq edhe ai, tek më “hapte zemrën” edhe për gjëra që në atë kohë thuheshin me zë të ulët! Qe nga të parët që u shpall “HERO”, aktori partizan, me shtatin e bukur e te lartë, me atë zë të mëndafshhtë, me ata sy që ndrisnin prej emocioneve të thella që u ngjanin ujëvarave. Po ishte i pari edhe për regjisorin rus Sergei Jutkevic, kur do t'i thoshte gjatë xhirimeve të rolit të Palit në

filmin “Skënderbeu”, se “Ti Naim do të vdesësh herët, me tërë këto emocione të papërmbajtura!” Sepse Naimi nuk dinte të interpretonte ndryshe, pa dhënë të gjithë bagazhin e ndjenjave të veta, që tek “Hamleti” do të arrinin kulme të larta dhe, pas shfaqjeve, kur shkante në kabinën e tij të ftohtë, prej pupuliti, mbulohej nga djersët, që akullnoheshin po aty. Unë student i tij, që në shfaqje lozja figurantin që i shpinte kupën e helmit me urdhërin e mbretit Klaud, i magjepsur prej energjive të tij interpretuese, do të shihja e do të ndjeja edhe atë lodhje të jashtëzakonshme të këtij njeriu e artisti të madh, i cili do të shuhej pas pak vitesh, në kulmet e karrierës së tij. Librin për Naimin do ta mbaroja pas vdekjes së tij, në ditët e vitet e vështira të burgimit tim e do ta botoja, sa fitova lirinë time, kur Naimi nuk ishte më midis të gjallëve....

Ndërkohë kishin “ikur nga skena” njeri pas tjetrit Besim Levonja, Loro Kovaci, Pjetër Gjoka, Marie Lagoreci, Sandër Prosi, Violeta Manushi, Besa Imami, Ndreka Shkjezi, Ndreka Luca, Mihal Stefa e me radhë, të cilët mblidheshin në dimër që të ngroheshin pakëz përreth një mangalli, duke pritur që të ndërroheshin aktet e tablotë e të vinte radha e tyre për të hyrë nëpër role, në atë zgafellë skene që e përlante era nga të katër anët e sidomos nga mbrapa krahëve të tyre, nga Ateljeja e Dekoreve. Kur e “ngritën këtë bina” të bukur nga jashtë, italianët kishin parasysh që të jepeshin filma e keshtu edhe u quajt: “Kinema Nacional” e as që e memdonin “zgafellen mbrapa” ku do te ngujoheshin, të loznin shfaqje breza aktorësh në tetë dekada më mbrapa, nëpër sajesa të tjera! Po do të më mbetej në mëndje vetëm Mihal Stefa, Mjeshtri i Madh i roleve të vogëla, që e kaloi edhe jetën e vet, në një shtëpi prej qerpiçi, andej nga Varri i Bamit, fillikat i vetëm, si eskimezët, në tmerrin e skamjes e të varfërisë. Po edhe Besim Levonja që do të ngutej të hynte nën skenë, fill sa mbaronte tablonë apo rolin e

vet, tek shtrati i topit që rrotullonte skenën, për të shkruar komeditë e tij, me cigaret e njëpasnjëshme që ndizte e i shuheshin në buzë, në atë mjedis të nëndheshëm që gjatë dimrave të egër mbushej me ujë deri në gjysmën e vet, pikërisht deri aty ku arrinin këmbët e Kadri Roshit, -Suflerit të parë të teatrit, para se ta ftonte regjisorin Sokrat Mio të zëvendësonte një rol tek “Revizori” i Gogolit, për të mos zbritur më në “arkivolin” e suflerit, deri sa të mbaronte karrierën, deri në lavdine e vet, ndofta i vetmi në jetëgjatësinë që i dha Perëndia!.

I them këto se kam brenjë në shpirt. Afërmendsh, unë e di se fati a fatqegësia e njeriut nuk varet prej tij, ka një mori aktorësh. Edhe sëmundjet, vdekjet. Por nuk rri pa thënë se kushtet e skenës së Teatrit Kombëtar kanë qenë fare të papërshtatshme dhe është diskriminuese për jetë e “shenjtë” të aktorëve, krenarive tona kombëtare. Në këtë sens, mos vallë pati një fatbardhësi në shëndetin e karrierën e tyre, brezi i dytë i artistëve, që mbaruan Shkollën e Lartë të Aktrimit?! I pari u largua nga jeta një nga aktorët më të talentuar të teatrit e të kinematografisë tonë të re, Bexhet Nelku, i cili ishte nga të parët që u pranua në organikën e Teatrit Popullor dhe mbeti sa rrojti nëpër skutat e kësaj “binaje”, duke mësuar monologje të panumërta dhe që priste të mbaronte shfaqja e t'i interpretoonte në skenën e zbratur, deri sa u shtrua në spital dhe u shua si njeri tepër herët! Një femijë i vogël që vinte këtu pas së ëmes aktore, Margarita Xhepës, për ta parë nëpër prova e nëpër shfaqjet e saj të panumërta e mbresëlënëse, Ndrim Xhepa, vazhdoi shkollën e lartë të aktorëve po këtu e mbeti po këtu, një nga aktorët e rinj që zëvendësoi aktorët e parë të heronjve e të dashnorëve, në teatër e në kinematografi, me një notë mjeshhtërie të re, bashkëkohëse, u prek edhe ky artist i mrekullueshëm nga mushkeritë e u dërgua me urgjencë të kurohej jashtë shtetit. U mplakën në këtë skenë aktorët e plejades së dytë



Projekti i Teatrit të ri kombëtar



Teatrit Kombetar

Robert Ndrenika, Reshat Arbana, Luiza Xhuvani, Yllka Muja, Viktor Zhusti, Bujar Asqeriu, Timo Flloko e shume te tjerë, që interpretuan me sukses përkrah themeluesve të këtij teatri, po a e keni parë vallë se si u pasqyrohet lodhja prej super emocioneve, streseve e ngërçeve të kohës, të politikës (të re e të vjetër, që prekën dhe teatrin, me ligje e pa ligje?!), gjatë një tranzicioni tmerrsisht të gjatë... Dësh ZOTI,

edhe s'kishim një godinë teatri për të qenë. Ku janë aktorët e klasës sime, të parët që e hapën Shkollën e Larte ,po pranë këtij teatri?. Janë shuar para kohe: Pas Bexhetit, Serafin Fanko, Donika Barçi, Albert Verria, Viktor Bruçeti.....Kalo në pension pleqërie, e dërmuar nga jeta, gati e venitur Edi Luarasi, Aishe Stari, Mimika Luca, Mario Ashiku.. Jeta e teatrit e Jeta e Artistit do kushte të përshtatshme për ta, për shëndetin,

200 vjetësh nga Mbreti Kostandin, me të gjitha kushtet, mjediset e anekset përkatëse, qysh atëhere), unë vizitova pas shfaqjes së dramës të Artur Milerit "Pamje nga Ura" aktorin kryesor, mikun tim Jorgos Qimulis, i cili sa kishte dalë nga roli i Edi Karbones , 4 orë në skenë dhe i dërmuar nga lodhja e tij fizike dhe emocionale. I shtrirë në kanapën e tij , ai kishte një masazhere që i shkruftonte muskujt e këmbëve

ende me nostalgjinë e vet, po katastrofa e gjysmës tjetër, vend-qëndrimi e vend-krijimi i magjisë së artit te tyre, e cila nuk mund të riparohej dot më, vec të prishej e të ribëhej nga e para , dy-tri herë më e madhe e më e bollshme për artistët sa edhe salla e spektatorëve, që të zhdukeshin njëherë e mirë ato kthina e qymeze vdekjeprurëse! Po duhet edhe qetësi e bindje, duhet respekt i madh për ata që na ikën e nuk na vijnë më,

rehatshëm në krijimtarinë skenike, brezi i tretë i akteveve, qe tani është në një lulëzim të paparë e nuk duam të ketë të njëjtin fat. E rëndësishme për mua nuk është dhe aq ndërtimi i një ndërtese teatrore të bukur, funksionale e të madhërishme, sesa krijimi i një mendimi ndryshe për teatrin nga qeveria e parlamenti, me buxhete favorizuese e me ligje të forta, njëqind përqind në favorin e artistëve, që te mos duken më si gjynahqarë e



ti i Teatrit të ri Kombetar



Muret e Teatrit Kombëtar aktualisht

i kemi akoma ata, po ku është Agim Qirjaqi, ky elegant i paparë i artit, që u shua nga sëmundja e alzajmerit, me merakun e madh për një teatër të ri; ku është Roland Trebicka, profili i të cilit ishte e mbeti i pazëvendësueshm në teatrin tonë, njëlloj si edhe Bujar Lako i përkryer si aktor, që më thoshte se vinte nga dera e Frashërllinjve edhe ai, me po atë fat të mbrapsht si dhe ajo e Naimit, ndërkohë që edhe kishim,

klimën e krijimit artistik, konfortin dhe për gjithë arsenalin e gjërë qe i duhen rolit. E çdo aktor duhet të ketë kabinën e vet, me të gjithë garderobën e rolit , si edhe me një personel ndihmës që t'i rrijë sidomos aktorit që ka "barrën më të rëndë" në shfaqje, në këmbë, që ai, aktori, të merret vetëm me shpirtëzimin e pesonazhit e me qetësinë e vet krijuese. Ne Teatrin Kombëtar të Greqisë në Athinë (i ndërtuar para

dhe një tjetër që i fshinte djersët që i kullonin çurk e po i vishte një Rob de Shambër,që të mos ftohej. E sa më pa, më pyeti për Timo Fllokon, që e kishte parë, pëlqyer dhe bërë mik , me Edi Karbonen e lozur në Tiranë...

O ZOT I MADH! Aktorët tanë që gjithsesi mbeten të mëdhenj e të magjishëm me artin e tyre, nuk i "mori në qafë" salla e spektatorëve qe dukej e bukur e tashmë kujtohet

respekt edhe për ata pak njerëz e artistë të nderuar që mendojnë ndryshe e që duan ta mbajnë këtë karakterinë me njëfarë nostalgjie. Po le të "vrasim mëndjen" që TEATRIT I RI që parashihet të ndërtohet po në këtë vend, le të krijojë mundësi për ruajtjen e kësaj nostalgjie, me muzen e teatrit brenda, me pavionet e kostumeve të roleve më të ndritshme, me reliket e rekuiziten e tyre... Le ta ndjejë veten më mirë, më qetë, më

të shtrijne duart për lëmoshë, sa herë që kërkojnë të bëjnë një shfaqje, apo një rol të pavarur dhe , së fundi , të mos shuhen edhe këta si ata të plejadës së parë, që u shuan herët e të plejadës së dytë, e varfanjakëve mjeranë, një pjesë e të cilëve janë ngujuar tek kolltukët e sallës së spektatorëve, së toku me disa qytetarë që e duan teatrin me shpirt, pa u prishur i vjetri. Shfaqja një mendimin tim në këtë sherr të pazakontë, si më ngjan mua më mire, ashtu skundër ngjau dikur me një sherr akoma më të madh, kur po bëhej Rruga e Kombit e kur qindra njerëz, madje edhe specialistë, me e pa parti, ishin kundra si dhe mijëra të tjerë që ishin të behej. Dhe, më në

fund, kjo veper u krye. Ajo është sot një fitore për të gjithë shqiptarët. Besoj se kështu do të ngjasë edhe me Teatrin Kombëtar. Gjithë këtë sherrnajë do ta harrojmë kur të shohim Teatrin e Ri, që do na ofrojë kushte të shkëlqyera për të shijuar artin, teatrin e bukur. E di se edhe aktorët nesër, kur të luajnë në skenat e tij, mund të thonë: Teatër i bukur, modern, që na jep mundësinë të interpretojmë role të mëdha.

Përfundon një tjetër parkim nëntokësor në kryeqytet

Kryeqytetit i është shtuar edhe një tjetër parkim nëntokësor. Nga dita e hënë, të gjithë qytetarët që do t'u duhet të ndalojnë pranë Rrugës së "Elbasanit", mund ta lenë makinën e tyre në parkimin më të ri me 145 vende. Ky investim i Bashkisë së Tiranës i jep zgjidhje parkimit në një nga zonat më të ngarkuara të kryeqytetit. Kryeqytetit i është shtuar edhe një tjetër parkim nëntokësor. Nga dita e hënë, të gjithë qytetarët që do t'u duhet të ndalojnë pranë Rrugës së "Elbasanit", mund ta lenë makinën e tyre në parkimin më të ri me 145 vende. Ky investim i Bashkisë së Tiranës i jep zgjidhje parkimit në një nga zonat më të ngarkuara të kryeqytetit. Pasi inspektoi përfundimin e punimeve, kryebashkiaku i Tiranës, Erion Veliaj tha se ky është një tjetër premtim i mbajtur. "Duke filluar nga dita e hënë, të gjithë qytetarët që kanë punë në Rrugën e 'Elbasanit', qofshin ata që shkojnë në shkollat këtu afër, si shkolla "Kosova" apo Liceu, qofshin ata që kanë biznese, qofshin ata që shkojnë te Drejtoria e Tatimeve, pra në një nga

nyjet më të ngarkuara të Tiranës, gjejnë shpëtim përfundimtar për çështjen e parkimit, duke frekuentuar parkimin e 4-rt nëntokësor që hapim në 4 vjet në qytetin e Tiranës", tha Veliaj. Një lajm i mirë për banorët e kësaj zone janë edhe tarifat e reduktuara për automjetet e tyre. "Motoja e bashkisë është: Sa më pak makina. Megjithatë, e kuptoj se për disa njerëz për-

dorimi i makinës, pra për një mësues që vjen nga ata tjetër e qytetit, për një prind që vjen për të marrë fëmijët, për dikë që ka një problem me tatimet, për dikë që ka një takim në ambasadë, makina mund të jetë e nevojshme nëse distanca është mbi 2-3 km dhe nuk kanë një mundësi tjetër. Për të gjitha këto arsye, 145 vende parkimi në këtë hapësirë publike, e marrë

nga privati dhe e rimarrë për publikun, me parking poshtë dhe hapësirë për njerëzit, sidomos me një kënd lojërash për fëmijët, është ndoshta metafora më e bukur se çfarë vlerash besojmë ne si bashki. Zgjidhja që do të shohim në Tiranë është: makinat larg syrit të njeriut, nëntokë, kurse hapësirat e rikuperuara nga privati, që janë hapësira të bashkisë, siç ishte



Projekti i shumëpritur në kryeqytet, 145 vende parkimi tek "Rruga e Elbasanit". Veliaj do ndërtojë më të tjerë

këndi i "7 Xhuxhave", që sot është kthyer 100% në duart e shtetit dhe qytetit të Tiranës, do të vijojmë me të njëjtën filozofi edhe në hapësira të tjera që kemi identifikuar për parkingje nëntokësore. Shumë shpejt, Këshilli Bashkiak i Tiranës do të rimarrë një tokë dhe do të bëjë një shkëmbim me një tokë që është në hyrje të Parkut të Liqenit, midis Gardës dhe Universitetit, ku do të konceptojmë një tjetër parkim nëntokësor, që do t'i shërbejë të gjithë atyre që frekuentojnë Parkun e Liqenit. Po kështu, edhe në Qytetin Studenti dhe

në disa hapësira të tjera kemi identifikuar mundësinë për parkingje nëntokësore", deklaroi kryebashkiaku. Bashkia e Tiranës njofton se parkimi publik ka 2 kate nëntokë dhe ofron 145 vendparkime në total, plus 2 vende parkimi për PAK. Parkimi është i pajisur me sistemin e ndriçimit emergjent sipas standardeve ne fuqi. Në katin -1 (parkim) është pozicionuar edhe blloku i nyjeve higjienosantare, që do t'i shërbejnë parkut rekreativ në sipërfaqe. Parkimi publik përmban sistemin ventilimi dhe është i pajisur edhe me sistemin e mbrojtjes kundër zjarrit.

FESTA / SOT KURBAN BAJRAMI KREU I KMSH-SË, BUJAR SPAHIU URON BESIMTARËT

"Të shërojmë plagët me buzëqeshje, solidarizim me nevojtarët"

Sot është Kurban Bajrami. Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë Bujar Spahiu përmes një mesazhi ka uruar të gjithë besimtarët. Ai thotë se Kurban Bajrami është simbol i heroizmit, sakrificës, sinqeritetit, devotshmërisë dhe përkushtimit ndaj Zotit. Spahiu shprehet se Kurban Bajrami na kujton përgjegjësitë për të qenë të kujdesshëm ndaj të drejtës së gjithsecilit. "Bismil-lahi Rrahmani Rrahim! Me emrin e Allahut, të Gjithëmeshirshmit, Mëshirëplotit! Të nderuar besimtarë! Më lejoni që në këto çaste të gëzuara të festës së Kurban Bajramit t'ju

përcjell urimet më të përzemërta, paqe, lumturi dhe gëzim sjellë në familjet, miqtë dhe të afërmit tuaj. Kurban Bajrami është simbol i heroizmit, sakrificës, sinqeritetit, devotshmërisë dhe përkushtimit ndaj Zotit. Besimtarët myslimanë shprehin devotshmërinë e tyre duke bërë kurban dhe duke u solidarizuar me të afërmit, fqinjët dhe njerëzit në nevojë. Historia e Kurbanit me në qendër Profetin Ibrahim dhe Ismail a.s na tregon qartë bindjen dhe devotshmërinë e tyre ndaj Zotit të botëve si dhe raportin e duhur prind-fëmijë. Kurban Bajrami na kujton përgjegjësitë

për të qenë të kujdesshëm ndaj të drejtës së gjithsecilit. Profeti na mëson se Allahu ka të drejta mbi ne, po ashtu edhe familja, shoqëria, të afërmit. Të falurit dhe të falënderuarit është e drejta e Zotit, ndarja e kohës për familjen është e drejta e saj, haku ndaj punës është e drejta ndaj punëdhënësit dhe kolegëve. Festa e Kurban Bajramit është e lidhur ngushtë me kushtin e pestë të Islamit, Haxhin. Haxhinjtë nga Shqipëria u janë bashkuar miliona haxhinjëve të ardhur nga vende të ndryshme të botës, të veshur me të bardha, pa dallim kombësie,

shtresë shoqërore, të bashkuar vetëm për t'ju lutur Allahut të lartësuar për paqe dhe dashuri mes njerëzve, për të falur mëkatet, për t'u bërë prej njerëzve të sinqertë dhe të devotshëm. Le të shërbejë kjo festë për të kontrolluar ndjenjat tona jo të mira, si urrejtja, smira, thashethemi dhe të ripërtërijmë ndjenjat e bukura të dashurisë, respektit, vëllazërisë, faljes dhe përkujdesjes. Kurban Bajrami është dita kur ne shërojmë plagët që i kemi shkaktuar njëri-tjetrit me buzëqeshje, gëzim e paqe. T'i shohim të gjithë njerëzit me syrin e dashurisë, ashtu siç na



shih ne Zoti dhe le të bëhemi pjesë e gëzimit të tyre duke ndarë së bashku mirësitë e Kurban Bajramit. Të bëhemi falënderues për të gjitha mirësitë dhe begatitë që i kemi dhuratë nga krijuesi ynë, dhe të tregohemi bujarë duke u solidarizuar me

njerëzit në nevojë. I lutem Zotit të Madhëruar që kjo festë të sjellë në shtëpitë e shqiptarëve, më shumë mirësi, afërimitet dhe dashuri mes njëri-tjetrit, në të mirë të shoqërisë, kombit dhe gjithë njerëzimit", mbyllet mesazhi i Spahiut.

VLORË / MBLIDHET TASK FORCA MINISTRJA MANASTIRLIU PREZANTON SHIFRAT



"37 mijë pushues kanë marrë shërbim në qendrat shëndetësore verore"

Nga 1 Qershori, mbi 37 mijë pushues dhe turistë kanë marrë shërbim në 28 qendrat shëndetësore verore dhe rreth 600 raste janë referuar në spital. Këto janë shifrat zyrtare të sjella nga ministrja e Shëndetësisë, Ogerta Manastirliu. Ditën e djeshme është mbledhur Task Forcën e mbarëvajtjes së sezonit turistik në Vlorë, ku është vënë theksi te bashkëpunimi mes institucioneve. "Rëndësi ka bashkëpunimi ndërinstitucional për të garantuar sezon turistik

të sigurt dhe të shëndetshëm. Për të hedhur bazat që çdo vit të garantojmë sigurinë për turistët dhe pushuesit. Për të zbatuar angazhimin e qeverisë shqiptare për të zhvilluar turizmin në vendin tonë, si një sektor strategjik", u shpreh Manastirliu. Manastirliu theksoi se institucionet duhet të kenë kujdes të shtuar gjatë këtij sezoni turistik edhe sa i përket inspektimeve. "Rreth 3400 kontrolle janë kryer nga Inspektoriati Shëndetësor, nga të cilat, mbi 700 vetëm në qarkun Vlorë, ku


janë marrë masa administrative, paralajmërimet, apo mbyllje te subjekteve për përsëritje të shkeljeve. Nuk do të ketë tolerancë për subjektet që nuk respektojnë ligjin" - tha Manastirliu. Gjithashtu ajo u ka kërkuar drejtuesve të institucioneve shëndetësore të vijojnë gatishmërinë. "Mbi 9700 shërbime shëndetësore janë ofruar në Qarkun Vlorë në qendrat shëndetësore verore dhe rreth 200 raste referuar në spital. Shërbimi ndaj qytetarit duhet të jepet në kohë dhe me cilësi. Shërbimi

shëndetësor është shtuar këtë vit në sezon turistik, pikërisht nga besimi i rritur i qytetarëve ndaj sistemit shëndetësor. Është ulur numri i referimeve në spitale, sepse ofrohet shërbim cilësor në qendra shëndetësore", tha Manastirliu. Duke theksuar vijimin e angazhimit sa i përket inspektimeve higjieno-sanitare, Manastirliu tha se aksioni i nisur duhet të kthehet në një sistem të integruar mes institucioneve për të garantuar sezon turistik të sigurt.

250 vjetori Napoleon Bonaparti dhe shqiptarët



► Gjeneral Napoleon Bonaparte, 27 vjeç, triumfator në Itali



► Ali Tepelena, pasha i Janinës

NGA **BAJRAM PEÇI**

15 gushti i këtij viti shënon 250 vjetorin e lindjes të një prej figurave më të ndritshme të historisë botërore, Napoleon Bonapartit. Janë të pafund biografët që kanë shkruar për të, kronistë e bashkëkohës, që me kujtimet, opinionet, letërsinë, kanë përshkruar figurën, 52 betejat, ushtarakun, njeriun, dashnorin, diktatorin, shtetarin, reformatorin civil dhe administratorin, aventurierin dhe epokën. Për askënd tjetër nuk janë shkruar më shumë se për këtë gjeni.

Historiani Alistar Home rendit rreth 600 mijë tituj e autorë.

"Napoleon le Grand", emri që sundoi Europën e çerekut të parë të shekullit 19-të, ka disa pika takimi me kombin dhe historinë tonë. Le ta fillojmë me origjinën, ku prej kohësh vijnë rrotull pohime të vjetra personazhezhetësore për stërgjyshërit e tij.

I. RRËNJËT ARBËRESHE

Erdhi në jetë në vitin 1769 në qytetin Ajaçio të ishullit të Korsikës. Biografët shënojnë këto versione: se familja e Na-

poleonit kish emigruar në shekullin e 16 në Korsikë nga provinca e Toskanës; se familja ishte gjenoveze dhe kish emigruar në Korsikë në fund të shekullit 15-të; se familja Bonaparte ishte nga Trevizo. Napoleoni lindi si Buonaparte, por qe Franca që ia bëri Bonaparte. Ideja e rrënjës arbëreshe të Bonapartëve zë fill në mes të shek. 19-të. E dhëna më serioze për origjinën arbëreshe vjen përmes një historiani dhe personaliteti politik, Adolf Thieres...

faqe 14-15



► Shqiponja dykrenore mbi 500-vjeçare në Kebin e Rodonit

Arbëni dhe Shqypni, shqiptari i refuzuar si shqiptar

NGA **DR. TONIN ÇOBANI**

faqe 16-19



Dedë Gajtani, mjeshtri shpirtpoet i përkthimit...

E kam takuar shpesh rrugëve të qytetit tim. Vonë ia mësova emrin. Shumë mbeti "I panjohur". "I panjohur" mbeti, sepse nuk e përhëndeta dhe nuk e takova asnjëherë. E kam peng. Po kështu ndodhi, për të mos e njohur, edhe pse "jetuam në një qytet". Pothuajse shëtiste vetëm. Me një vështrim paksa të çuditshëm. Ai vështrim, në at'fytirë paksa të brengosur, i ngjante një hëne që nuk donte të perëndonte në qiellin e qytetit të tij, ku banonte. Sikur donte ta jetonte vetëm at' shkëlqim vetmitar....

NGA **XHAHID BUSHATI**

faqe 20-21

■ **Marrëdhënia me Ali Pashën/** Historia e relikeve të Napoleonit në familjen Libohova

■ **Napoleon Bonaparti/** Ideja e provincës Ilire dhe përpjekjet për të thyer sundimin Osman

"E ruaj një fjalë në shpirt... ", cikël me poezi

NGA **XHAHID BUSHATI**

faqe 22

HISTORI | PËRVJETORI

250 vjetori Napoleon Bonaparti dhe shqiptarët

NGA **BAJRAM PEÇI**

15 gushti i këtij viti shënon 250 vjetorin e lindjes të një prej figurave më të ndritshme të historisë botërore, Napoleon Bonapartit. Janë të pafund biografët që kanë shkruar për të, kronistë e bashkëkohës, që me kujtimet, opinionet, letërsinë, kanë përshkruar figurën, 52 betejat, ushtarakun, njeriun, dashnorin, diktatorin, shtetarin, reformatorin civil dhe administratorin, aventurierin dhe epokën. Për askënd tjetër nuk janë shkruar më shumë se për këtë gjeni. Historiani Alistar Horne rendit rreth 600 mijë tituj e autorë. "Napoleon le Grand", emri që sundoi Europën e çerekut të parë të shekullit 19-të, ka disa pika takimi me kombin dhe historinë tonë. Le ta fillojmë me origjinën, ku prej kohësh vijne rrotull pohime të vjetra personazhezh jetësorë për stërgjyshërit e tij.

I. RRËNJËT ARBËRESHE

Erdhi në jetë në vitin 1769 në qytetin Ajaçio të ishullit të Korsikës. Biografët shënojnë këto versione: se familja e Napoleonit kish emigruar në shekullin e 16 në Korsikë nga provinca e Toskanës; se familja ishte gjenoveze dhe kish emigruar në Korsikë në fund të shekullit 15-të; se familja Bonaparte ishte nga Trevizo.

Napoleoni lindi si Buonaparte, por qe Franca që ia bëri Bonaparte. Ideja e rrënjës arbëreshe të Bonapartëve zë fill në mes të shek. 19-të. E dhëna më serioze për origjinën arbëreshe vjen përmes një historiani dhe personaliteti politik, Adolf Thieres. Është autori i shumëvëllimshit, "Historia e revolucionit Francez" dhe President i Francës në vitet 1871-1873. Do ishte një emër i njohur i kombit shqiptar, Myfit Libohova, i arsimuar në Francë, avokat, doktor i shkencave juridike, diplomat dhe funksionar i lartë në Perandorinë Otomane, që në vitin 1903 do botonte në Kajro një studim për "dajon" e tij, "Ali Pashë Tepelena", ku mes të tjerash shkruan mbi origjinën arbëreshe të Napoleonit të Madh. Të shtjellon që Myfit Libohova sjell nga gjurmimi i veprës së Adolf Thieres i nxjerr nga errësira studiuesi dhe



► Gjeneral Napoleon Bonaparte, 27 vjeç, triumfator në Itali

"Napoleon le Grand", ka disa pika takimi me kombin dhe historinë tone, që nga origjina e tij arbëreshe e deri në një varg pikëtakimesh me histori e personazhe të botës shqiptare...

shkrimtari Mexhit Kokalari. Vite më pas i sjell në vëmendje A.Tare dhe shtypi shqiptar.

Adolf Thieres ka shkruar se, "Kur Josef Bonaparti, vëllai i madh i Napoleon Bonapartit u kurorëzua në vitin 1806 Mbret i Napolit, arbëreshëve që kanë shkruar për ta mirëpritur e uruar, ai u ka thënë: "Edhe familja Bonaparti është me origjinë arbëreshe". Më tej, M.Libohova shpjegon rrënjët e mbiemrit. Sipas tij mbiemri Kallomeri (greqisht-Anë e mirë) është italianizuar në Buonaparte.

ka asnjë kuptim, është greqizuar shtrembër-shton ai.

Siç është e njohur, se në shek. 14-15, Peloponezi ishte tejmbushur me popullsi shqiptare, ashtu është e njohur edhe se pas pushtimit turk, shumë prej tyre u shtrënguan të emigrojnë në Itali. Mes tyre thuhet se ishin dhe të parët e Napoleon Bonapartit. M.Libohova shkruan se kanë shkruar në Korsikë që në atë kohë dhe patën qenë të identifikuar në një bashkësi fshati. Biografët e Napoleonit thonë se në Korsikë këta "italianë" kanë shkruar nga Gjenova.


Që ish Perandori i Francës të mund të ketë rrënjë Arbëreshe, nuk është mendim i përhapur dhe nuk gjen përkrahje. Franca nuk lejoi madje as Italinë t'i afrohej Napoleonit. Si i lindur në një territor francez e quante përveç se francez (ishulli i Korsikës ishte territor gjenovez dhe i kish kaluar Francës një vit para lindjes të Napoleonit). Argumentet nuk i kapërcejnë, siç u pa më lart, caqet e pak rrëfimeve. Natyrshëm, ka pak gjasa që të zënë vend e të besohen shpjegimet shqiptare, për shkak se jeta dhe vepra e tij i përkasin Francës. Aq më tepër kur nuk i vlerësojnë burimet të besueshme, thënë apo shkruar qoftë dhe nga historianët të kalibrit të ish presidentit të Francës, me tekstet historike të të cilit mësohet ende në shkollat franceze. Asnjë nga këto shpjegime nuk është ngritur në nivelin pretendues të përpjekjes për ta mbrojtur dhe ska patur gjasa të ia dilte mbarë në kushtet e një Shqipërie të vobëgtë ekonomiksht e kulturorisht. As që bëhet fjalë t'i cënosh Francës madhështinë megallomane e pompozitetin e vet. Sidoqoftë, nga ç'kanë shkruar për rrënjët arbëreshe, edhe nëse nuk zënë vend, kjo, ne shqiptarëve, nuk na pengon në nanurisjet tona t'i kujtojmë.

II. MASAKRA E XHAFAS

Bëhet fjalë për një ngjarje ku Napoleoni ndodhet përballë me një masë shqiptarësh në shërbim

të Perandorisë Otomane. Rrëfimi i vëllait të madh të Napoleonit, thënë arbëreshve të Italisë në kohën e kurorëzimit, për origjinën arvanitase, nuk dimë të jetë përmendur nga pjestarët e tjerë të familjes. E ka ditur apo nuk e ka ditur Napoleoni këtë, ska asnjë dëshmi!? Librat biografikë mbi Napoleon Bonapartin e japin ngjarjen pothuaj në shumicën e tyre, të shpjeguar herë në pak faqe dhe herë në përshkrime më të gjata.

Masakra lidhet me ngjarjen në kështjellën e Xhafas (Jaffa), shumë afër Jeruzalemit. Ishte periudha e fushatës në Egjipt, kohë kur, ngadhënjyese, ushtria prej 35 mijë luftëtarësh e Bonapartit, doli nga Kajro e Aleksandria dhe mori rrugën për pushtimin e "Tokave të shenjta". Kapërxeu lehtësisht e theu rezistencat e dobta që hasi rrugës në Gaza, deri sa ngeci para murit të një kështjelle, Xhafas, që as thyhej dhe as dorëzohej. Dëshmitë e drejtëpërdrejta të kohës tregojnë se ishin nizamë shqiptarë ata që e mbronin. Napoleoni u premtoi jetën nëse dorëzoheshin, por ata pas katër ditë luftimesh të përgjakshme në rrethim, kërkuan të dorëzoheshin në "besë", me kushtin që të merrnin e mbanin edhe armët. Kështu u ra në "mirëkuptim", por, siç thonë



► Ali Tepelena, pasha i Janinës

Bonaparti urdhëroi pushkatimin e të dorëzuarve, pothuaj të gjithë me origjinë shqiptare.

Sipas autorit të biografisë "Napoleoni", të shkrimtarit rus, Evgeny Viktoroviç Tarle, të therur e vrarë mizorisht më 6 dhe 7 mars të vitit 1799 ishin 10 mijë. Burime të tjera, si Falk Avner, "Napoleon Against Himself: A Psychobiography", përmend 7 mijë; "Memoira of Napoleon", Louis Antonie Fauvelet de Bourrienne thotë se janë 4100 ushtarë; Emil Ludvig përmend te vepra e tij, "Napoleoni", shifrën 3000. Me pak, 2440 ushtarë, jep Simon S. Montefiore te vepra "Jeruzalemi". Vetëm "Enciklopedia e Historisë Botërore" e Ëilliam L. Langar jep shifrën më të ulët, 1200 ushtarë shqiptarë të vrarë.

Vite më vonë, gjatë internimit në ishullin Shën Helenë, Napo-



► Napoleoni në Xhafa, vaj në kanavac, piktur Baroni Antonie-Jean Gros, Muzeu i Luovrit-Paris

historianët, pas tre ditë mëdyshtesh dhe pas një nate të tërë pa vënë gjumë në sy, Napoleon

leoni shkroi: "Për të mbajtur në ruajtje një numër të konsiderueshëm të burgosurish, do të ishte

e nevojshme që të shkëputeshin roje të mjaftueshme për ta, të cilat do të zvogëlonin rëndë reshtat e ushtrisë së tij dhe në qoftë se ai do i kishte lejuar ata që të largohen si njerëz të lirë, ishte e arsyeshme që të besonte e të kish frikë se ata mund të misin radhët e trupave të Ahmed al Jazzar.

III. NAPOLEONI DHE ALI PASHË TEPELENA

Marrëdhënjet mes Napoleon Bonapartit dhe Ali Pashë Tepelenës, zot i pashallëkut të Shqipërisë së Jugut, janë të dëndura dhe janë përshkruar në kujtime, studime historike e diplomatike. Për karakterin publicistik të shkrimit, po i jap në formë të shkurtëra e skematike.

Me shëmbjen e Republikës së Venedikut, shkëlqimit verbues të saj dhe pasurisë spektakolare të përvetësuar nga gjeneral Bonaparti, trupat franceze mbërritën në kufijtë e pashallëkut të Ali Pashë Tepelenës. Pasi traktati i Kampo-Formios, përmes së cilës zotërimet venedikase të bregut dalmat e jonian viheshin nën juridiksionin e Francës. Ushtarët francezë u vendosën në ishujt e Jonit. Gjithashtu dhe në bregun kontinental, në Butrint, Pargë, Prevezë e Vonicë, që populloheshin nga shqiptarët e që koha, për të cilën shkruajmë, e quante "Bregdeti shqiptar". Lind në Korfuz "Le regiment des Albanais". 3200 luftëtarë shqiptarë, u rreshtuan nën armët franceze të Napoleonit. Rradhët e tyre kryesisht përbëheshin nga burra të krahinës shqiptare të Sulit, detyruar të emigrojnë në Korfuz për shkak të dhunës e masakrave të pashait të Janinës mbi popullatën e malsisë rebele.

Me planin për ndërhyrjen ushtarake në Egjipt, Franca filloi të përkrahte fuqizimin e dy pashallarëve shqiptarë, në dëm të pushtetit qëndror të Perandorisë Otomane. Nga Napoleonit, komandantit francez të Korfuzit i erdhi urdhëri që ta përkrahte Ali Pashë Tepelenën, në përpjekjet për forcimin e pushtetit të tij. Fillon një komunikim mes Aliut dhe Bonapartit, për të arritur një marrëveshje për furnizimin e Korfuzit, Bonaparti lejon që otomani Ali të fusë trupat në bregun e Himarës, por nuk ja dha Butrintin, siç e kishin marrëveshjen paraprake. Historia shënon masakra të përgjakshme prej trupave të Aliut në bregun himarjot. Është koha kur pashai ndërton kalanë e Porto Palermos.

Ndërsa nisej për pushtimin e Egjiptit, Bonaparti dërgon adjutantit Lavallett, me një letër për Aliun, i cili e nisi nga Korfuzi për Janinë me gjeneralin Rose. Fatkeq u kap rrugës dhe e nisën si rob për Stamboll, ku dhe vdiq. Aliu sulmoi Butrintin, i theu francezët të cilët e dorëzuan kështjellën pasi e dogjën atë dhe Butrintin. Pason sulmi ndaj Prevezës, ku trupat e Aliut i thyen trupat franceze. 8 oficerë dhe 120 ushtarë francezë të zënë robër, u dërguan në burgjet e Stambollit.

Pasi ra edhe Korfuzi nën peshën e flotës Ruso-Turke, pashait i mbërrinjë urime nga admiralit anglez, Nelson, i cili ndodhej në Egje në

gjurmim të Bonapartit në Egjipt. Në zotërim të ishujve jonianë u vu Rusia. Në vitin 1807, traktati i Tilsitit ndërmjet Napoleonit dhe car Aleksandrit I, u nje francezëve vendosjen përsëri në Korfuz dhe ishujt jonianë. Aliu i kërkon Francës qytetin shqiptar të Pargës. Napoleoni nuk pranor, marrëdhënjet përkeqësohen dhe Aliu afrohet me anglezët. Napoleoni dërgon konsull në Janinë Pukëvil. Që në vitin 1801 Napoleoni kish dashur që në Janinë, në kryeqytetin e Shqipërisë, siç e quante atë kohë Europa, të ngrinte një post vëzhgimi për të siguruar mbrojtjen e ishujve të Jonit. Pukëvili i kërkon Napoleonit që të ndërhynte te Porta e Lartë për t'i dorëzuar Aliut Pargën, Prevezën e Vonicën. Pason në vitin 1807 një korespondencë mes perandorit dhe Pashait. Dështon një orvatje tjetër e Aliut për pushtimin e Pargës, që mbrohej me 32 topa dhe 300 trupa franceze. Parga ra në dorë të tij vetëm pasi ua bleu anglezve për 150 mijë lira stërlina, gjë që ndodhi pas traktatit të Parisit, në 5 nëntor 1815.

Në Libohovë, në shtëpinë e Myfit Bej Libohovës, ka qenë një servis çaji dhe kafeje, me ngjyrë blu, me germën "N" të Napoleon Bonapartit si dhe dy piktura vaji të Ali Pashës, punë të piktorit francez Dypre. Thuhet se ish-in dhorata të Napoleon Bonapartit për pashanë e Janinës, të cilat e motra e tij, Shanishaja, kur u martua në Libohovë, i kish marrë me vete. Pas vdekjes së të shoqit, Sulejman Pashës, reliket mbetën te Myfit Bej Libohova, nip i Shanishasë.

Gjithsecili, në madhësitë e tyre të dredhive, mashtrimit, dhunës e pushtetit, shkonin përbri si burra që i dhanë epokës së tyre tiparet e sundimit të egër. "Ali Pasha ri përballë Bonapartit, si tigri me luanin, ata ngajjnë me njëri-tjetrin si dy pika uji, sepse të dy e filluan karrierën nga asgjëja dhe u ngjitën deri në majat e perandorive" -do shkruante V.Hygo. Këto marrëdhënje ndikuan e i dhanë udhë lulëzimit në letërsinë franceze të një sërë veprash letrare, ku shquhen krijimet e shkrimtarit të madh, Aleksandër Duma, "Konti i Monte Kristos", ku autori përdor artistikisht figura historike të ngjarjeve mes Napoleonit dhe Aliut, si dhe vepra biografike, "Ali pasha-Krime fatkeqe".

IV. FRANCEZËT NË BREGUN DALMATO-SHQIPTAR

Bregdeti i Adriatikut lindor do të jetë për një çerek shekulli (1789 - 1814) në qendër të ngjarjeve europiane. I pranishëm me trupat franceze dhe luftërat ndaj mbretërve italo-lombardë, Perandorive Austriake dhe Ruse, Napoleoni e pa Dalmacinë si pozicion të rëndësishëm strategjik në planet e tij për Ballkanin dhe ndërmarrjen e një lufte të mundshme kundër Perandorisë Otomane. Që në krye, Napoleoni as që e përdori emrin Ballkan, por e quajti territorin Ilir. Përdorimi i emrit të lashtë të gadishullit kish vazhduar deri nga shekulli i 17-të dhe më tej është hartuar. Termi i ri turk, Ballkan, e zëvendësoi përfundimisht.


Ilirin e risjell në vëmendje Napoleonit i Madh, fill pas nënshkrimit në vitin 1805, të paqes së Pressburgut. Në këtë marrëveshje palësh, gadishulli i Istrias, Dalmacia dhe Gjiri i Kotorit, i cili deri në atë moment e për disa shekuj resht ishte quajtur "Albania veneta", "Cataro d'Albania", ju dorëzuan nën administrim Francës. Dalmatia dhe Shqipëria venedikase

ishin qeverisur nga Republika e Shën Markut, nga Istria deri në tokat ku banonin shqiptarët. Gjiri i Kotorit i ndante nga turqit. Napoleoni angazhohet të revolucionarizojnë themelet shekullore të këtij territori, me një politikë krejt të re sociale dhe ekonomike. Ai shpalli hapur idetë liberale të Revolucionit Francez.

Në 1805 Napoleoni krijoi Mbretërinë e tij të Italisë rreth detit Adriatik, duke i bashkangjitur ish Dalmacinë venedikase e pjesë të Shqipërisë venedikase, nga Istria në Kotor. Në Mbretërinë Napoleonike të Italisë, në vitin 1808 u shtua dhe Republika e Raguzës, e cila u aneksua, duke zhdukur kështu nga historia adriatikase Republikën e Shën Vlashit, një nga republikat më të vjetra në botë, ku jetonin e punonin një numër i madh banorësh me kombësi shqiptare.

Napoleoni e shkëputi Dalmacinë dhe Albania venetën nga mbretëria e Italisë dhe krijoi provincat ilire. Si guvernatori i Ilirisë, i përbërë nga toka shqiptare dhe dalmate të bregdetit të Adriatikut, u emërua në vitin 1806 një nga marshallët besnikë të Napoleonit, Auguste de Marmont. Ai e mbajti këtë post për tre vjet. Marmont në Iliri themeloi shkolla dhe ndërtoi qindra kilometra rrugë. Ai lejoi që Kroatët dhe Sllovenët të rilindnin. Provinca franceze napoleoniane e Ilirisë zgjoi shpresat e kombësisë shqiptare për çlirimin nga zgjedha turke e tokave të tjera të popullit të tyre, që ndodhej në robëri.

Në veri të provincës Iliri, është koha kur te dalmatët lind ndërgjegjja se edhe ata i përkasin popullit slloven e kroat, ndërgjegjësim të cilin fuqia ushtarake dhe administrative e Venedikut nuk e kish lejuar. Në jug të provincës Ilire fillonte Perandoria Otomane, me pashallëkun e Bushatllinjve të Shkodrës. Napoleoni filloi menjëherë krijimin e lidhjeve.



► Provinca franceze e Ilirisë

Për qëllimet e tij mbi shëmbjen e otomanve në Ballkan, besonte se do mbështetej te dy pashallëqet shqiptare. Për këtë qëllim dërgoi si konsull në Shkodër, Mark Bryger, si dhe disa oficerë. Kur katër nga oficerët ju vranë nga tivarasit në një incident, Marmont i kërkoi Napoleonit ndërhyrjen e tij. Perandori u kërkoi Bushatllinjve ndëshkimin, por askush nuk u dënua sepse oficerët e vrarë e kishin kërkuar vetë sherrin, me arrogancën e tyre.

Ideja e provincës Ilire jetoi po aq sa jetoi edhe pushteti i Napoleon Bonapartit. Me rrëzimin e tij u shemb

edhe provinca Ilire. Këto territore ju bashkangjiten Perandorisë Austro-Hungareze, deri në fund të Luftës së I Botërore.

V. OBELISKU EGJYPTIAN I LUKSORIT NË PARIS

Nuk ka lidhje të drejtëpërdrejta



► Mehmet Ali Pasha, vizatim i piktorit Dominique Vivant Denon, shoqëruar i Bonapartit në fushatën e Egjiptit

me Napoleon Bonapartin, por lidhet dhe merr jetë prej fushatës së tij ushtarake në Egjipt dhe dëshirës për t'i dhënë Parisit një monument të lashtësisë egjiptiane. Napoleoni u bashkangjiti 2 mijë topave të fushatës ushtarake 175 studiuës gjithçfarësh, ekonomistë dhe inxhinierë, që mblodhën, klasifikuan e shqyrton një masë të madhe artefaktesh e njohurish. Me të gjithë materialin e mbledhur në fushë të historinë, gjeografisë, gjuhësisë dhe kulturës së vendit, u formua baza e njohurive moderne të Egjiptit, që u botua më pas në dhjetra vëllime.

Egjipti shpejt u përmyt nga studiuës e mes tyre ishte dhe filologu francez, Champollion. Ishte ai që u bë deshifruer i hieroglifëve, i ndihmuar për këtë nga gjetja e çelësit të tyre, Gurit të Rozetës, dhe studimi i obeliskëve të Luksorit. Monumentet dhe sheshet e famshëm në Paris janë të panumurt, njëri më i bukur se tjetri, të mrekullueshme me arkitekturë dhe impresionuese. Ideja për t'i dhënë Parisit një obelisk egjiptian ka qenë e Napoleon Bonapartit.

Në skemat e mëdha ndërtime të Napoleonit për Parisin përfshihej dhe një obelisk egjiptian në boshtin përmes Konkordit të Madalenës dhe pallatit të Burbonëve. Ai, gjatë fushatës së Egjiptit, i kishte parë këto monumente të jashtëzakonshme të krijuara nga dora njerëzore, si simbol të pushtetit, të perandorive. Ndërsa merret me luftëra, ideja ngeli ide dhe s'pati mundësi të organizonte sipërmarrjen e këtij aksioni, kur dhe zotërimi i Detit Mesdhe nga ana e anglezëve ishte një tjetër pengesë serioze.

Sundimtar i Egjiptit nga viti 1805 ishte një shqiptar, Mehmet Ali Pasha. Sipas gojëdhënave, Mehmet Aliu ishte me origjinë nga fshati Zëmblak i Korçës dhe kish mbërritur në Egjipt në krye të një formacioni ushtarak me shqiptarë, për të luftuar kundër Napoleonit. Në vitin 1799, kur Napoleoni iku në

Francë, ushtria pushtuese franceze u dëbua nga trupat britanike dhe ato otomane. Në vitin 1801 ju dha fund pranisë franceze në Egjipt. Në vitin 1805 Mehmet Aliu, me regjimentin e tij shqiptar, merr kontrollin dhe bind sultanin për ta bërë atë guvernator të Egjiptit. Vendos kontroll të plotë, pasi mposhti një ushtri britanike, në vitin 1807 dhe masakron në vitin 1811 kundërshtarët Mamlukas. Dinastia shqiptare e sundimit të Egjiptit do zgjaste rreth 150 vjet.

Francezët e mbetur në Egjipt, nën sundimin e Mehmet Aliut, nga pushtues u shndërruan, me përkrahjen e Guvernatorit shqiptar, në bashkëpunues e bashkëpunëtor. Qindra prej tyre u dyndën në Luginën e Nilit si arkeologë, këshilltarë, inxhinierë, artillierë e armatorë. Nga Aleksandria në Luksor, pranë ushtrisë pushtuese shqiptare, ndodheshin këshilltarët ushtarakë francezë. Champollion, i tërhequr në Egjipt në deshifrimin e hieroglifëve, i kish vizatuar dhe deshifruar të "shkruarat" e obeliskëve të portave hyrëse të Luksorit. I goditur nga bukuria e monumenteve, u kish kërkuar autoriteteve vendase të merrte ndonjë prej tyre.

Me kërkesën e tij u muarr vetë Mehmet Aliu, i cili ja dhuroi të dy obeliskët monumental të Luksorit, që ndodheshin në hyrje të tempullit e që i kushtoheshin faraonit Ramsesi II. Me Restaurimin, Champollion, përmes një letre i kujton qeverisë se ish harruar dhurata e dy obeliskëve të Luksorit, që Mehmet Aliu i kish premtuar atij në shenjë mirënjohje për francezin, njeriun e parë që arriti pas 3000 vjetësh të deshifronte përbajtjen e hieroglifëve. Ai përshkruan në letër bukurinë e tyre të madhe dhe këshillon bërjen e përpjekjeve për të siguruar marrjen me çdo sakrificë. Letra e risolli në vendje çështjen, këshilla dhe kërkesa e tij u pranua menjëherë.

Me urdhër të Luigjit XVIII, Konsulli i Përgjithshëm në Aleksandri filloi bisedimet me Mehmet Aliun për marrjen e obeliskëve. Filloi puna për të marrë një prej tyre. Obelisku i Luksorit ishte mbi 22 metra i gjatë dhe peshonte rreth 250 ton. Ndërtimi i këtij monumenti daton në dinastinë e nëntëmbëdhjetë, shekulli i XIII pes. Më parë romakët e kishin transportuar një obelisk nga Aleksandria në Romë. Një tjetër obelisk egjiptian ishte transportuar nga bizanti dhe vendosur në Kostandinopojë.

Sjellja e tij në Paris është një aventurë më vete. Mënyra e transportit që u zgjedh ishte e ngjashme me atë që ishte përdorur nga romakët e lashtë: me një trap të gjatë sa obelisku dhe të gjerë mjaftueshëm për të përballuar udhëtimin në det. Për transportin në lum ekipi francez u ndihmuar, deri në derdhje të Nilit, nga ushtria shqiptare. U ndërtua erkas dhe u dërgua për të transportuar monumentet një anije e quajtur "Luxor". Obelisku, i lidhur me hallka të hekurta, mbërriti në Havre, prej ku u dërgua në Paris përmes Senës në 23 dhjetor 1833. Obelisku i Luksorit, si një monument parizian i veçantë, u vendos në Place de la Concorde, i montuar në një bazament 9 metros, duke e bërë atë monumentin më të vjetër në Paris.

Dhurata e një shqiptari për Francën u përfundua me një ceremoni të madhe me pjesëmarrjen e familjes mbretërore dhe gjithë shoqërisë së lartë pariziene. Vite më pas Viktor Hygo, në "Les orientales" shkroi, "Nëse ka një kolos që mund të krahasohet me Bonapartin, quj njeri gjeneral është Mehmet Ali Pasha; ai qëndron përballë luanit, si skifteri përballë shqiponjës".

STUDIMI | TEZAT

Arbëni dhe Shqypni, shqiptari i refuzuar si shqiptar

NGA DR. TONIN ÇOBANI

Ae dinë shqiptarët përse quhen shqiptarë? Ka dy qëndrime për lidhjet e simbolit të shqiponjës me shqiptarët. Një palë, kryesisht gjuhëtarë, nuk gjejnë asnjë lidhje të shqiptarëve me shqiponjën e tyre të flamurit. Sipas kësaj pale, fjalët shqiptar dhe Shqipëri vijnë nga ndajfolja shqip (kuptimisht) dhe kjo prej latinishtes excipit-excipere, që do të thotë me folë kuptueshëm, qartë. Një palë tjetër, kryesisht historianë (ose individë që u referohen më tepër argumenteve historike) qysh nga periudha e Rilindjes e, ndoshta, më herët, argumentojnë se shqiptarët e marrin emrin e tyre nga shqypja/shqipja, shpend i shënuar i faunës së trojeve shqiptare dhe simbol i traditave iliro-arbërore.

Ndërsa akademikët e sotëm, që nuk janë një, por shumë palë, heshtin për shpjegimin e parë, duke e pranuar kështu se Shqipëria dhe shqiptarët kanë mbirë nga ndajfolja shqip.

Dhe, kur këta akademikë e hapin gojën, gjë që e bëjnë vetëm për argumentin e dytë, shqiptojnë togfjalëshin argumentim folklorik, duke këmbëngulur se shqipja (shqiponja) s'ka fare lidhje me Shqipërinë e shqiptarët. Lidhja me shqiponjën/shkabën e grupit të fjalëve Shqipëri, shqiptar dhe shqipe (gjuhë shqipe) është veçse produkt i ndjenjave patriotike atdhetare të shqiptarëve të sotëm. U thotë mendja atyre se patriotizmi dhe atdashedashuria nuk çenkan ndjeshmëri, por formulim akademik.

2. "KËNGA E SHQIPES", E PAKËNDUAR QË 100 VJET

Deri një shekull më parë, kur nuk kishte institucione akademike, shqiptarët këndonin një këngë për Shqipën (shqiponjën), shpendin që simbolizon Shqipërinë, shqiptarët, dhe gjuhën e tyre shqipe. Por ajo këngë, si duket, nuk u këndua më dhe nuk u mblodh prej akademikëve të munguar dhe humbi. Humbi apo na e bënë të humbur, nuk mund të themi gjë të sigurt.

E sigurt është se "Kënga e Shqipes" është kënduar deri në vitin 1914 kur e gjejmë të botuar në një antologji për Shqipërinë në gjuhën frënge, si një këngë popullore të mbledhur në Shqipërinë e Veriut. "Kënga e Shqipes", mjerisht,

Shqiptarët e kanë deklaruar identitetin e tyre në çdo rast, por akademikët shqiptarë nuk kanë qenë të aftë ta bëjnë të njohur botërisht këtë identitet, duke i bërë të pakënduara, së paku prej 100 vjetësh, këngët shqiptare për shqipen/shqypen e tyre

na vjen në prozë për shkak se francezët në prozë i përkthejnë poezitë përgjithësisht, prandaj mund të përmbledhim vetëm përmbajtjen e saj të rikthyer në shqip prej studiuesit Fotaq Andrea: Shqipja e fortë, mbret i zogjve të qiellit si luani ndër kafshët e tokës, lëshohet shigjetë mbi prenë

Është vendi të theksojmë se i pari, që vërtetoi se shqiptarët duhet të kenë si simbol të flamurit të tyre shqiponjën e zezë dykrenore në një fushë të kuqe, është Faik Konica, i cili u mbështet kryesisht në dokumente historike dhe zbuloi se stema e Skënderbeut ka qenë shqiponja dykrenore. Por fakti se shqiponjën njëdykrenore e kanë edhe popuj të tjerë si simbol të flamurjeve të tyre kombëtare apo të emblemave zyrtare, shpesh herë ka ngjallur dyshime: mos vallë shqiptarët e kanë huazuar këtë simbol prej të tjerëve me ose pa vetëdije, prandaj mund edhe të mos ishte shqiponja si simbol në flamurin e tyre?!

3. "SHQYPNIA DHE SHQIPTARËT", SIPAS PLUTARKUT

Deri vonë, lidhja e vetme në mes të shqiptarëve dhe të shqiponjës së flamurit të tyre

e vet.

Shqipet e ngrënë folenë majave të larta, përmbi shkëmbinj dhe hone: quhen edhe petrita e gjeraqina. Sepse janë trima si shqipet, edhe shqiptarët kanë marrë emrin prej shqipes dhe flasin gjuhën e atij zogu.

Ndoshta, edhe për këto vargje të munguara në origjinal, shpjegimi i natyrshëm, që e justifikon të vetëquajturit shqiptar me simbolin e shqypes/shqipes (shqiponjës-shkabës), është konsideruar prej disa gjuhëtarëve shpjegim jo shkencor, por folklorik.

Por edhe shpjegimi "shkencor" i atyre albanologëve, shqiptarë e të huaj, që e arsyetojnë vargun e fjalëve shqiptar, gjuhë shqipe dhe Shqipëri me prejardhje prej ndajfoljes shqip (kuptimisht), është ironizuar me të drejtë qysh herët prej Faik Konicës, i cili ka shtuar se Shqipëria barazohet me Kuptonjësia.

ka qenë epoka e Skënderbeut. Me pas u zbulua se ajo shqiponjë e Skënderbeut trashëgohej nga stema e shtetit të Arbërit, por, edhe me herët, nga Pirrua i Epirit. Pashko Vasa tek eseja e tij "E vërteta mbi Shqypninë dhe shqiptarët" (1879) pohon se populli shqiptar e nje vetën me emrin shqyptar qysh kur Pirua i Epirit, sipas Plutarkut (46-120 e.r.), u quajt shqiponjë dhe luftëtarët e tij iliro-epirotas, krahët e shqipes. Plutarku të "Jetë paralele" shkruan:

"Pas betejës që bëri me maqedonasit Pirroja u kthye në Epir krenar e plot famë. Epirotët e pritën duke e përshëndetur me emrin "Shqiponjë". "Jam shqiponjë, me ndihmën tuaj; si të mos jem shqiponjë, unë që ngrihem lart me armët tuaja që janë pors pëndë të shpejta"

Të gjithë studiuesit e institucioneve shkencore shqiptare kanë parapëlqyer ta paraqesin atë dësh-

mi të Plutarkut si jo shkencore. Sipas tyre, shkencat historike kanë bërë përpara me fakte e teza, që argumentuakan edhe sot e kësaj dite se Epiri nuk mund të jetë shqiptar (iliro-shqiptar), sepse, sipas tyre, është "djepi i helenizmit", madje, jo vetëm Epiri i Vjetër, por edhe Epiri i Ri, që vinte deri mbi Shkumbin, duke i lënë shqiptarët, kështu, pa truell, si shkruante Jani Vretua: "pa histori, pa letërsi, pa asnjë përparim dhe pa vetëqenie kombëtare".

4. SHQIPONJA E DODONËS

Siç është bërë e ditur shkencërisht, ndër pellazgë shqiponja është simbol i Zeusit të Dodonës dhe i heronjve pellazgo-ilirë; është homonim i Pirros së Epirit, embleme e Shtetit të Arbërit dhe, si vazhdimësi e tyre, në formën dykrenore del te flamuri i Skënderbeut. Rilindësit, shpjegojnë historianët, e zgjedhën shqiponjën dykrenore simbol të flamurit kombëtar, pikërisht për këto vlera historike, si "flamur shkabë... për Vegjëlinë" (Noli).

Asnjë gjuhëtar a historian, akademik qoftë apo amator, nuk mund të shkruajë një histori tjetër nga ajo që njohin shqiptarët për veten e tyre. Dhe, në qoftë se nuk mund të bëjë ndryshe, si ka bërë deri tani, ai duhet ta respektojë (duke e deklaruar) atë që populli mendon për veten e vet, atë që ai popull ka përcjellë brez pas brezi, rapsod pas rapsodi deri në ditë e sotme.

5. SHQIPONJA, MËKATI DHE VIRTYTI

Do të doja të shtoja se simboli i shqypes/shqipes është universal, sado që ndër popuj dhe kultura të ndryshme atij simboli i janë veshur edhe petka të ideologjizuara.

Në thelb simboli i shqypes përftohet me flatra të hapura (dielli) lartësive të pafund (qielli) prej nga lëshohet si shigjetë mbi prenë e vet (vetëtimja e bubullima): shqiponja, zog i lartësive të mëdha simbolizon që prej së pari dritën.

"Në mes të 7 mëkateve kapitale, shqiponja simbolizon kryelartësinë; në mes të katër virtyteve kryesore, drejtësinë. C.G.Jung sheh të shqiponja një simbol atëror."

Shqiptarët, me sa duket, edhe për këtë simbolikë universale identifikohen me shpendin e lartësive. Por ky realitet, që identifikon



► Shqiponja dykrenore mbi 500-vjeçare në Kebin e Rodonit



► Tonin Çobani

shqiptarët me shqypen, nuk përmendet në asnjë fjalor universal të simboleve.

Dhe gjëra të tilla ndodhin, jo se shqiptarët nuk e kanë deklaruar identitetin e tyre në çdo rast, por se akademikët shqiptarë nuk kanë qenë të aftë ta bëjnë të njohur botërisht këtë identitet, duke i bërë të pakënduara, së paku prej 100 vjetësh, këngët shqiptare për shqipen/shqypen e tyre.

PJESA III SHQYPE DHE SHQIPE

Diferenca nga shqype/ shqiponjë dhe shqipe /shqiponjë vjen për shkaqe dialektore. Ky fakt gjuhësor e ka pështjellësuar arsyetimin,

Veçanërisht kur fjalët "shqype dhe shqipe shpjegohen si dy fjalë të ndryshme. "Në të vërtetë, shkruan Çabej, tek autorët e vjetër shqiptarë, shqip, shkruar me këtë trajtë, dallohet dukshëm nga emri i shpendit, që shkruhet tek ata rregullisht shqype, gjë që tregon se kemi të bëjmë me dy fjalë të ndryshme."

"Shqiptar", si fjalë e shkruar, del për herë të parë në fillim të shek. XVII në "gjuhen e Schiypptareve" ("Kuvendi i Arbënit": 1706); ndërsa fjala Shqipëri del në gjysmën e dytë të shek.XIX, në formën "Sc-cypniis" ("Koncili i Dheut Shqypniis":1872).

Ndajfolja shqip (me thanë shqip/shqyp – sliip) dokumentohet e shkruar më herët, së pari te "Meshari" i Gjon Buzukut, në mesin e shek.XVI (Çabej, II, f.77 dhe Ashta: 1996, XXV, II). Prej kënde, siç e kemi thënë edhe më lart, gjuhëtarët kanë arritur në përfundim se shqiptar dhe Shqipëri/Shqipni kanë si rrënjë fjalën shqip, e cila vjen prej latinishtes excipit-excipere.



A. Gjergj Fishta

► Fjala e shkruar Shqype nga Gjergj Fishta

SHQYPNIJA.

E dhe hâna do t' a dije,
Edhe dielli do t' ketë pá,
Se per çark ksajë rrokullije,
Si Shqypnija 'i vend nuk ká!
Fusha t' gjâna e kodra t' blera,
Zijes s' mnershme larg kû â droja,
Me gaz t' vet ktû i veshë Prendvera,
Parrizit t' larmet shtroja.

► Fjala e shkruar Shqypnija nga Gjergj Fishta

GJUHA SHQYPE

Porsi kanga e zogut t' veres,
Qi vallzon n' blerim të Prillit;
Porsi i amli filladi i eres,
Qi lmon gjit e drandofillit:
Porsi vala e bregut t' detit,
Porsi gjâna e rrfës shqjetare,
Porsi ushtima e nji termetit,
Njashtâ â gjuha e jonë shqyptare.

dhe I-ja shprehet me i, y dhe j (Çabej II, f.47). Pra, ndryshimi midis grafive shqype dhe shqipe, si dhe shqip dhe shqyp, nuk është kaq i qartë, ashtu si nuk është i dallueshëm shndërrimi fonetik i Y-I dhe anasjelltas në të folme të ndryshme apo edhe brenda një të folmeje.

Dhe këtu nuk është fjala vetëm për një dukuri gjuhësore të lokalizuar, si, p.sh., e folmja e Çamërisë, e folmja e Gjirokastrës, e folmja e Lurës apo e arbëreshëve të Sicilisë (Matrënga), ku mungon thuajse fare Y-ja. Gjuhëtarët kanë arritur në përfundim se ngatërimi i Y-së dhe I-së është fenomen i mbarë shqipes së folur, që, sipas mendimit tonë, është reflektuar edhe në gjuhën e shkruar, sidomos në variantin e saj të drejtshkrimit të pakonsoliduar. Kështu vetëm në titujt e librave të 1800-s për shqip dalin këto variante: Shqipetarze (1927), Shqip (1944 - Veqilharxhi), Scqyp (1856), Sskipe (1862), Schiyp (1862 - Radoja), Scciyptarvet (1864), Shqip (1866 - Kristoforidhi), shkjepe (1864 - D'Istria), Scgyp (1870), Scciyptnis (1872). Ndërsa në një pasqyrë të Alfabetëve

(1908) nuk e gjejmë fare grafisë e zanores i. I-ja del vetëm te alfabeti i De Radës si fonemë (i) pa grafi, ndërsa ka grafisë e ù-së tek alfabeti i albanologëve dhe të y-së te Alfabetet e tjerë (Alfabeti i Stambollit, Bashkimit, Agimit dhe i Manastirit). Kështu Y-ja është I, dhe Y-ja në këtë tabelë krahasuese nuk del fare, gjë që mbështet dyshimin e Kolë Ashtës se kinse kemi të bëjmë me dy fjalë të ndryshme (shqype dhe shqipe), kur mund të ishte një e vetme (shqype): Y-ja në gjuhën e shkruar është shndërruar në I dhe na ka dhënë fjalën shqip.

Sot në gjuhën e shkruar fjalët shqype (shqyp, shqyptar dhe Shqypni) kanë mbetur si arkaizma apo dialektalizma historike. Ndërsa janë unifikuar format e tyre: shqipe (shqip, shqiptar dhe Shqipëri), të sanksionura me drejtshkrimin e 1972-shit. Ndoshta kështu është krijuar më tepër konfuzion në shpjegimin e marrëdhënieve në mes të shqypes/shqipes dhe të shqyptarëve/shqiptarëve.

2. ARBËNI DHE SHQYPNI

Deri në gjysmën e dytë të shek. XIX në vend të fjalëve shqiptar/shqyptar dhe Shqipëri (Shqypni) përdorshin fjalët arbën (ose arbër) dhe Arbëni/Arbëri, si ka mbetur deri në ditët e sotme te kolonitë e shqiptarëve (arbëreshë) të Italisë. Edhe më herët, në vend të (apo së bashku me) shqyptar-arbën dhe Shqypni-Arbëni në gjuhën librore ndeshen dendur edhe fjalët epirotas dhe Epir.

Te "Meshari" i Buzukut na vjen për herë të parë në gjuhën e shkruar fjala Arbania. Çabej shpjegon se rrënja "arb" vjen nga "alb" paraindoevropiane (Çabej: 1976,68) dhe na çon te fisi ilir i albanëve me kryeqendër Albanopolis që përmend Ptolemeu (shek.I-II). Por asnjë gjuhëtar nuk është marrë me fjalët "epirotas" dhe "Epir", sikur këto dy fjalë të mos kishin të bënin fare me iliro-shqiptarët dhe trojet e tyre iliro-shqiptare.

Nga ana e tij, Frang Bardhi fjalorin e vet e titullon "Dictionarium latino-epiroticum" (1635). Dhe Skënderbeun e cilëson "dragoi i Epirit" e gjuhën arbërishte për të huajt e quan "epirotice". Kjo do të thotë se deri kur ai ishte student në kolegjin e Loretos dhe doktorant i Propogandës FIDE (Romë), këto fjalë (epiroticum, Epir, epirotice) që te Bardhi kanë ekuivalente (arbërisht, Arbëri dhe gjuhë arbërishte), ishin aktive në latinishten mbarevropiane për të shënjuar atë popullsi ballkanike që deri atëherë dhe në vazhdim do të njihet si Albanians (Arbënes/arbëresh dhe shqyptar/shqiptar); për të emërtua atë vend në Ballkan që deri atëherë e në vazhdim do të njihet si Albania (Arbania/Arbënia/arbëria dhe Shqypnia/Shqipëria); për të dalluar atë gjuhë që, së paku, qysh te "Meshari" e Gjon Buzukut (1555) dhe në vazhdim, te fjalori i Frang Bardhit (1635), del me ndajfoljen arbërisht (me vonë shqyp apo shqip), por që të huajt vazhdojnë ta njohin edhe sot e kësaj dite si lingua albanese...

KU KANË GABUAR GJUHËTARËT?

Ata nuk kanë marrë parasysh, se, ashtu si gjendet te Buzuku fjala shqip, gjendet edhe fjala shqype, prej së cilës duhet kërkuar burimi i fjalëve shqiptar dhe Shqipëri, sepse ato nuk janë shfaqur me formën sotme shqiptar dhe Shqipëri apo Shqipni, por në formën shqyptar dhe Shqypni (1868), si shihet, mbi bazën e fjalës shqype (shqiponjë) e jo shqip (kuptimisht). Ndërsa togfjalëshi gjuhë shqipe apo gjuhë shqype mund të kërkonte shpjegime të tjera.

I pari ndër gjuhëtarët shqiptar që ka tentuar një shpjegim tjetër është Kolë Ashta. Ai me një "me sa duket" dhe një "mund të kenë", vuri në dyshim "se kemi të bëjmë me dy fjalë të ndryshme" dhe, për pasojë, edhe etimologjinë e fjalës

shqip prej excipere, kur shkruante: "Me sa duket emri i shpendit shqype dhe ai i gjuhës shqipe mund të kenë rrugë etimologjike të ndryshme"

Por dyshimi i Kolë Ashtës mund të mos na duket më vetëm dyshim, nëse do të ndaleshim pak më gjatë te fenomeni Y-I dhe anasjelltas në gojën e shqyp apo shqipfolësve.

Arsyetimi i parë: supozojmë se te fjala shqype (Buzuku) nuk ka ndodhur palatizimi Y-I, si mund të mendohet se ka ndodhur te fjala shqip (po te Buzuku) e më vonë te Budi (e përdorur 3 herë), Bogdani (1 herë) dhe Kuvendi i Arbërit (2 herë). Po të kishte ndodhur ai fenomen, atëherë fjala shqype do të vinte shqipe dhe prejardhja e ndajfoljes shqip nuk do

të kërkonte etimologji tjetër, veçse prej fjalës shqype-shqipe/shqiponjë, shkabë.

Arsyetimi i dytë: po e njëjta logjikë do të vlente për supozimin e kundërt, që do të thotë, të kishte ndodhur shndërrimi i Y-I te fjala shqip. Atëherë do të kishim ndajfoljen shqyp, prejardhja e së cilës do të lidhej me shqype, ashtu si e gjejmë këtë fjalë te Buzuku (e përdorur 2 herë), te Bardhi (1 herë) dhe te Bogdani (1 herë). Të mos çuditemi, sepse te Buzuku (dhe jo vetëm tek ai) shkruhet fjala krypë për kripë.

Arsyetimi i tretë: të dy supozimet e mësipërme i përmbledhim në një konkluzion gjuhëtarësh seriozë, të cilët na thonë se Y-ja (y) te Buzuku (dhe jo vetëm tek ai) shpreh u, y dhe y (Çabej II, f.49)

STUDIMI | TEZAT

Shqiptonja e Dodonës, arbëreshët e përçmuar dhe ekuacioni i Piliqës

-Rilindasit e zgjodhën shqiptonjën simbol të flamurit tonë sepse dihet shkencërisht; ndër pellazgë shqiptonja është simbol i Zeusit të Dodonës dhe i heronjve pellazgo-ilirë; është homonim i Pirros së Epirit, emblemë e Shtetit të Arbërit dhe, si vazhdimësi e tyre, në formën dykrenore del te flamuri i Skënderbeut

vijon nga faqja 17

Të huajt ende përdorin albanain dhe Albania, për shqiptar dhe Shqipëri. Edhe ky përdorim e shmang simbolin e shqipes (shqiptonjës), që shfaqet në flamurin e Skënderbeut dhe të princave të tjerë shqiptarë të mesjetës, ajo shqipe (shqiptonjë) që dëshmohej te stema e shtetit të Arbërit në shek.XIII dhe shumë më herët te epirotasit ilirë, argumente të cilët, gjithashtu, mbeten jashtë arsytimit të gjuhëtarëve që janë marrë me shpjegimin e prejardhjes së shqiptarëve të sotëm.

Duhet të shtojmë këtu se në botimin e dytë të "Kuvendit të Arbërit", ku përdoret për herë të parë fjala Shqypni prej Engjëll Radojës, ajo përdoret së bashku me Arbëni. Vetëm në parathënien prej 3 faqesh të autorit "Knuesit..." gjejmë të përdorur: 4 herë shqiptar për kundërtë 1 herë arbnor dhe 3 herë Shqypni (dhe 2 herë Dheu i Shqypnis) për kundërtë 2 herë Arbni.

3. ARBËRESHËT E PËRÇMUAR

Në këtë pikë çështja ftillohet ndryshe: ç'lidhje ka fjala arbën (Shteti i Arbërit) me ndajfoljen shqip, me shqiptonjën e shtetit të Arbërit dhe me flamurin e Skënderbeut? Të huajt e kanë njohur simbolin e shqiptonjës dykrenore në flamurin e Skënderbeut, por fqinjët tanë, jo pa keqdashje, kanë shtrembëruar, veçanërisht, fjalën arbën që ka shënjuar popullin tonë.

Kështu, si arrin në konkluzion

Çabej, nga albanët\arbanët ka dalë fjalëmërtimi arvanitët në gojën e grekëve, që nuk deshën kurrë të pranonin popullsinë autoktone çame, si populli jo greke, në trojet, sipas tyre, greke; nga arbana ka dalë edhe fjala e deformuar rabana prej serbëve, të cilët bënin përpjekje të vazhdueshme që ta sllavizonin fjalën që emërtonte shqiptarët autoktonë dhe, së bashku me të, trojet arbënore; për të mbërritur te osmanët, që,

mes të shqiptarëve dhe arbanëve është shqiptonja në flamurin e Skënderbeut, e cila, siç është thënë më lart, vjen nga stema e shtetit të Arbërit, veçse, edhe më herët, nga Pirrua i Epirit. Ata nuk kanë kërkuar argumente për të lidhur këtë shqiptonjë me fjalët shqiptar dhe Shqipëri, që u përhapën në gjysmën e dytë të shek.XIX duke zëvendësuar fjalët arbën\arbër dhe Arbëni\Arbëri.

Nisur nga arsytimi i mësipërm

hjeve të veta në të ashtuquajturën "Megallo Idea", dhe nacionalizmi ekspansiv sllav në Ballkan, serb e malazias, që arsyetohej me luftën kundër Perandorisë Osmane, duke qenë pjesë e koalicionit pansllavist me qendër Moskën e carëve rusë, lakmon Ballkanin Perëndimor pa i bërë pjesë një Shqipërie të shqiptarëve. Grekët sajuan teorinë e Vorio-Epirit helen dhe shqiptarët autoktonë të Epirit, çamët, i quajtën arvanitas, sipas tyre, të vendosur në trojet epirote, si kishte ndodhur edhe me arbëreshët e Italisë.

Një teori të tillë aplikuan edhe serbët, duke e quajtur Kosovën "Staraja Serbia" dhe shqiptarët autoktonë të Kosovës të ardhur aty prej maleve, pasi për shqiptarët kishte filluar të përdorej, veçanërisht, në Mal të Zi, edhe një fjalë tjetër përçmuese malokë, që, çuditërisht, dëgjohej duke u përsëritur edhe sot e kësaj dite prej vetë shqiptarëve për shqiptarët e Veriut.

Në këto kushte të pafavorshme po lindte edhe lëvizja kombëtare e banorëve më të vjetër të Ballkanit që u njoh si Rilindja Kombëtare Shqiptare, së cilës i duhej të përballlej, si me Perandorinë Osmane (prandaj nuk mund të quhej Rilindje Kombëtare Arnautë), ashtu edhe me synimet e hapura dhe të fshehta ekspansioniste të fqinjëve grekë, serbë e malazezë (prandaj nuk mund të pranohej të quhej as Rilindje Kombëtare Arvanitase apo Rilindje Kombëtare

Rabanske e, për të njëjtat arsye, as Rilindje Kombëtare Maloke). Prandaj, pra, u quajt Shqyptare (Pashko Vasa, 1879), Shqyptare (Sami Frashri, 1899).

5. IRONIA E KONICËS

Por, përveç arsytimit konfliktual të paraqitur më sipër, a ka ndonjë shpjegim shkencor përse arbëreshët zgjodhën të vetëquhen shqiptarë? Shpjegimet e derisotme kanë qenë të pamjaftueshëm për të kënaqur kureshtjen gjithnjë në rritje të brezave më të rinj të shqiptarëve. Shpjegimi i natyreshëm, që e justifikon të vetëquajturit shqiptar me simbolin e shqiptonjës (shqipes-shkabës), është konsideruar romantik prej gjuhëtarëve. Por edhe shpjegimi shkencor i albanologëve, shqiptarë e të huaj, që e arsyetojnë vargun e fjalëve shqiptar, gjuhë shqipe dhe Shqipëri me prejardhje prej ndajfoljes "shqip" (kuptueshëm), është ironizuar me të drejtë qysh herët prej Faik Konicës, duke shtuar, siç e kemi cekur edhe më sipër, se "Shqipëria, atëherë, do të thotë diçka si Kuptonjësia". Konica ironizon më tej duke treguar një anekdotë urbane: Një anglez, dashamir i shqiptarëve e pyet njërin prej delegatëve të Shqipërisë në Konferencën e Ambasadorëve të Londrës, se çfarë mund të eksportonte Shqipëria për të mbuluar shpenzimet e qeverisë. Delegati shqiptar, i lindur diku jashtë shtetit nga prindër shqiptarë, prandaj nuk kishte qenë asnjëherë në Shqipëri, përgjigjet jo pa humor: Shqipëria mund të eksportonte vetëm gurë.

Historianët nuk këmbëngulin në arsytimet e veta, sepse edhe atyre iu janë imponuar disa "autoritete" që historinë e kanë ngatërruar me politikën dhe politikën me nacionalizmin e tyre ekstrem. Kaq e vërtetë është kjo, sa në tekstet shkencore pranohet pa mëdyshje më të vogël shprehja se arvanitasit janë vendosur në



► Flamuri që u ngrit në Elbasan më 1912

prej shtrembërimit grek arvanitas krijuan fjalën pejorative arnaut, që, sipas orientalistëve, shënjonte popullsinë jo qytetase në trojet shqiptare të Perandorisë Osmane, pra, shqiptarin fshatar gjithmonë me qeleshe të bardhë në kokë.

4. SHQIPTARI I REFUZUAR

Por, për rilindësit shqiptarë (historianë ose jo), lidhjet e vetme në

(pika 3) mund të thuhet me siguri se një nga motivet e zëvendësimit të fjalës Arbëni në Shqypni duhet të ketë qenë edhe domosdoshmëria për t'iu shmangur, pikërisht, shtrembërimeve të fqinjëve dhe, ndoshta, edhe qëllimeve të tyre të mbrapshta në kurriz të trojeve arbërore.

Është koha kur nacionalizmi helenocentrist gjen një prej shpre-



► Flamuri i perioudhes se Skenderbeut i vizatur ne nje harte te vitin 1459



krahina të ndryshme të Greqisë "qysh nga mesjeta", duke injoruar kështu autoktoninë e popullsisë çame-epirote.

Për më tej kësaj, kanë mbetur formulime të tilla se shqiptarët në Greqi kanë qenë një minoritet i vendosur aty në shek XVI, që rezultoi plotësisht i asimiluar, ndërsa minoriteti shqiptar i vendosur në Kosovë e Metohi, Jugosllavi, ka realizuar një farë autonomie; sikundër emigrantë të tjerë shqiptarë në Turqi, Itali dhe SHBA.

PJESA III 1. EKVACIONI I PILIKËS

Faik Konica, shpjegimit (ironik) lingistik (Shqipëria-Kuptonjësia) të dheut të shqiponjave, i ka shtuar edhe shpjegimin anekdotik të gurëve si pasuri kombëtare, sa që të duket se edhe titullin e veprës së vet ("Shqipëria - kopshti shkëmbor i Evropës Juglindore"), e ka lidhur me relievin shkëmbor të dheut të të parëve. Por ai shton edhe "se Shqipëria do të thotë Vendi i Shqiponjave është kaq i rrenjosur, saqë ka përfutur një bestytini të çuditshme kundër vrasjes së shqiponjave, të cilat në sytë e popullit tonë janë po aq të shenjta sa edhe ulkonja për romakët e lashtë.

Një studiues tjetër, At Marin Sirdani ka gjurmuar në folklor. Ai ka hetuar se në një valle të kënduar të Zadrimës (shumë të hershme) dalin fjalët: shqyptar ("jam shqyptarë") dhe shqyptarisht ("këcen-o shqyptarisht"). Po ashtu, na kumton studiuesi Sirdani edhe te kënga "Zani i kasnecave", që përshkruan luftën e vitit 1571, përmendet fjala "shqyptar" Madje, te kjo këngë emri shqiptar përmendet disa herë:

"Peja, Pazvan bre, e xen si asht shqyptari!-
Diftoja mbretit t'onë se ke mbarue,-

Si dijn Shqyptarët me deke, si

me luftue...

Gzonju e këndon, o shqyptarët e mi,-

Se me ne ka kenë Zoti, ai na ka pri."

Por mund të kërkohen edhe argumentime të tjera. Dhimitër Pilika në veprën e tij, botim postum, "Pellazgët, origjina jonë e mohuar" sugjeron një ekuacion që nuk mund të lihet jashtë konsideratës kur duam të shpjegojmë përse shqiptarët u vetëquajtën shqiptarë në një çast kyç të historisë së tyre moderne. Ekuacioni i tij është:

"Pellazgë-ilirë-albanë-arbëreshë-shqiptarë, është baras me shqiptar plus simbolin e shqipes/shqiponjës."

Pas këtij arsytimi nuk mund t'ia ndajë mendja kujt se shqiptarët janë të mbërthyer pas simbolit të shqiponjës së tyre, të ndikuar prej malazezve, të cilët besojnë se janë bijtë e skiferit, siç arrin në përfundim Robert Elsie. Ai vazhdon më tej, duke thënë se ky simbol kaq popullor te shqiptarët nuk ka gjasa të lidhet me fjalët "shqiptar" e "Shqipëri", sepse fjala shqip te Buzuku vjen prej latinishtes "accipiter" që do të thotë skifter, soko-sokol në serbokroatisht.

2. SHQIPONJA E SHENJTË

Epiri, shpjegon Pilika (dhe jo vetëm ai) nuk ka qenë historikisht tokë greke, ashtu si pellazgët nuk kanë qenë helenë.

Siç është pranuar, fjala Epir në gjuhën greke do të thotë kontinent, por ka edhe një shpjegim popullor, në të cilin ruhen lidhje edhe më të forta të fjalës Epir me fjalën shqiponjë, sepse në të folmen çame shqiponjës i thonë

Epiri (mendoni se edhe Vorio Epiri) si mund të pranohej atëherë dhe sot prej grekëve të megallo idesë? Por studiuesi Dhimitri Pilika këtë e mbështet me citime dhe fakte të shumta e serioze. Shqiponja ka qenë simbol i Zeusit të Dodonës Pellazge (të atij Zeusi që helenët e përvetësuan prej pellazgëve). Shqiponja ka qenë emblema e Pirros së Epirit (edhe ky jo helen) që u trashëguua edhe nga Skënderbeu e princa të tjerë shqiptarë të shekullit të XV, dhe më herët. Deri atëherë nuk kishte as arbëreshë as shqiptarë, por epirotas dhe toka e shqiptarëve të atëherëshme quhej Epir, që, sipas shpjegimit nga e folmja çame, do të thotë Dheu i Shqiponjave apo, si e pamë më lart, Dheu i Shypniis, i shqypeve. Shqiponja edhe sot e kësaj dite konsiderohet e shenjtë prej shqiptarëve, kudo që të jetojnë ata.

3. BRAKTISJA SHTETËRORE

Tani le të mbërrijmë në një përfundim.

Gjeografikisht fiset ilire të epirotasve, dardanëve dhe albanëve janë paraardhësit e shqiptarëve të sotëm dhe trualli i tyre është kudo ku flitet gjuha shqipe (Fishta), pavarësisht se në kufijtë shtetërorë të cilit shtet modern përfshihen. Skënderbeu emërtohet princi i Arbënisë dhe i Epirit.

Historikisht emblema e epirotasve me shqiponjë (shqype) është trashëguar te Pirrua nga shqiponja e Zeusit të Dodonës pellazge te Shteti i Arbërit, te Skënderbeu e deri në ditët e sotme, pavarësisht se atë simbol e kanë përdorur perandori të dikurshme dhe e përdorin edhe shtete të sotme.

Politikisht fqinjët tanë grekë dhe sllavë kanë tentuar të mos i njohin shqiptarët në trojet e tyre dhe në shekullin XIX, kur formo-

Metohi dhe treva nga Malësitë e Mbishkodrës. Pikërisht në këtë kohë kishin filluar të zgjohen edhe shqiptarët dhe, duke u vetëquajtur shqiptarë, si iliro-shqiptarët e hershëm, bij të Pirros (krahët e shqiponjës), të Skënderbeut dhe të princërve të tjerë shqiptarë: kërkuan identitetin e tyre të nëpërkëmbur kombëtar. Si kundërpërgjigje, fqinjët punuan që çamët të veçoheshin si arvanitas, shqiptarët në trojet e tyre jashtë kufijve shtetërorë të quheshin kosovarë ose malokë.

Vetëm gjuha shqipe mbeti shqipe, që për efekte të ndarjes së rreptë administrative në Ballkan, nuk u zhvillua paralel në të gjitha njësitë vendore, prandaj u sajua gegërishtja kosovarçe dhe arvanishtja e çamëve, që nuk u asimiluan dot as në kushtet e braktisjes më të madh shtetërore nga shteti amë (Shqipëria), që u shpall i pavarur më 1912.

4. HISTORIA SI IDENTITET

Shqiptarët e sotëm asnjëherë nuk e kanë ditur me saktësi përse quhen shqiptarë as pse vendi i tyre quhet Shqipëri. Kështu mendova ndërkohë që po shfletoja për një arsye krejt tjetër librin "Kuvendi i Arbërit", botuar në Prishtinë më 2003.

Aty janë përmbledhur katër tekste. I pari, latinisht, ku shqiptarët janë albanens dhe Shqipëria Albania; i dyti, një përkthim i tekstit latinisht, i bërë nga një anonim më 1703 (botuar së bashku me tekstin latinisht më 1706) ku për fjalën albanens na del arbenesh dhe për fjalën Albania del Arbenia; i treti, është përkthimi i Engjëll Radojës, realizuar më 1867, por botuar më 1872, ku, krahas fjalëve Arbnia dhe arbnesh na dalin për herë të parë fjalët shqyptar dhe Shqypni. Teksti i katërt është përshtatja e këtij të fundit në gjuhën e sotme letrare nga Anton N. Berisha, i cili sqaron në pasthënie se ka lënë në tekst edhe Arbëria edhe Shqipëria, ashtu si ka bërë Engjëll Radoja.

Nga kjo del se deri në vitin 1706 në gjuhën shqipe të shkruar, shqiptarët thirren arbenesh dhe Shqipëria Arbëni. Duke nisur nga viti 1867/1872 shqiptarët janë edhe shqyptarë edhe arbenesh dhe Shqipëria është edhe Shqypëri edhe Arbëni.

Nuk ka asnjë shpjegim prej përkthyesit Engjëll Radoja, as prej ripërkthyesit Anton N. Berisha. Prandaj u përpoqa në këtë trajtesë të argumentoj se shqiptarët janë shqiptarë, sepse flasin shqip dhe sepse janë të lidhur pazgjydhshëmrisht veçse me simbolin e shqypes/shqiponjës, si asnjë popull tjetër që e ka përdorur ose e përdor atë simbol edhe sot e kësaj dite.

Ndër pellazgë shqiponja është simbol i Zeusit të Dodonës dhe i heronjve pellazgo-ilirë; homonim i Pirros së Epirit, emblema e Shtetit të Arbrit dhe, si vazhdimësi e tyre, në formën dykrenore del te flamuri i Skënderbeut. Rilindësit, shpjegojnë historianët, e zgjodhën pikërisht për këto vlera historike, si "flamur shkabë... për Vegjëlinë".



► Vula me shqiponjën dykrenore e Gjergj Kastriot Skënderbeut

edhe sot e kësaj dite ipe (që duket të ketë dhënë epi, me ndërrim vendi), prandaj Epiri, sipas kësaj logjike, është vend i shqiponjave. Natyrisht, vendi i shqiponjave,

heshin shtetet e tyre (Greqi, Serbi, Mali i Zi), mënjantuan simbolet e shqiptarëve, shtrembëruan emërtimet e tyre dhe përvetësuan troje arbërore: Çamëri, Kosovë-

PROFIL | PËRKTHYESI

Dedë Gajtani

Mjeshtri shpirtpoet i përkthimit...

Shënime për librin "Përkthime, poezi dhe poema" të autorit Dedë Gajtani (Kola)... Historia e rrallë e dorëshkrimeve dhe jetës së një poeti e përkthyesi të vyer, që komunizmi ia ktheu jetën në ferr...

NGA XHAHID BUSHATI

1. E kam takuar shpesh rrugëve të qytetit tim. Vonë ia mësova emrin. Shumë vonë! Për këtë arsye shumë kohë mbeti "I panjohur". "I panjohur" mbeti, sepse nuk e përshëndeta dhe nuk e takova asnjëherë. E kam peng. Po kështu ndodhi, për të mos e njohur, edhe pse "jetuam në një qytet".

Pothuajse shëtiste vetëm. Me një vështrim paksa të çuditshëm. Ai vështrim, në at'fytirë paksa të brengosur, i ngjante një hënë që nuk donte të perëndonte në qiellin e qytetit të tij, ku banonte. Sikur donte ta jetonte vetëm at' shkëlqim vetmitar. Sikur e kërkonte dhe e donte vetminë, perandorinë e saj. Nuk e di se çfarë kërkonte nga ajo? Mbase gjurmën e tij të vlefshme në at' vetmi? Ai diç i kërkonte viteve me pasurinë e tij diturore si përkthyes.

Po e përsëris: Pothuajse shëtiste vetëm. Shpesh i përhumbur. Ishte një përhumbe larg zhurmave, kotësive, proviancialitetit, zhargoneve, thirrjeve me zë të lartë e thirrjeve hysterike, fjalëve bajate e të qeshurave pa shkak. Të gjitha ata nuk i pranonte vetmia dhe kultura prej intelektualit të ditur e Dedë Gajtani.

"Ç'ishte kjo vetmi e këtij njeriu, bashkëqytetari tim "të panjohur"? Ishte një pyetje që ia bëja vetes, po në heshtje, sa herë e "takoja", dhe përsëri ishim dhe mbetëm "të panjohur". Si ndodhi, kështu kjo panjohësi?! Nuk di ta shpjegoj... Ama ndodhi...

Shumë vite kaluan dhe ai njeri mbeti enigmë për mua.


Shumë vite kaluan dhe një ditë ndodhi e papritura. Po hyja në librarinë "Ora e Shkodrës". Më pëlqen, krahas librave që blej, të shkëmbej dhe biseda me librarian (tashmë të njohur), për të marrë informacion të ri për librat që dalin dhe presin të dalin në qarkullim. Teksa po bisedoja... sytë e mi kurreshtarë shëtisnin rafteve ku qëndronin librat radhë-radhë. Papritur, u befasona nga ajo që pashë. Një libër qëndronte disi mënjane. U afrova. "Edhe këtu... kërkon heshtjen?!" – thashë përsëri me vete. E mora në duar me nxitim, sikur do ta humbja... E vështroja kopertinën, shfletova faqet... Sikur nuk



i zija besë librit që kisha në duar. Ai qëndronte para meje si thesar, tashmë i njohur. U gëzoja, sa nuk gëzohet njeri në botë. Autori i këtij libri të çmuar ishte ai, "I panjohuri", ai që e takoja shumë herë dhe nuk arrita ta përshëndesja e ta takoja, së paku një herë. Libri titullohej "Përkthime, poezi dhe poema". Autori: Dedë Gajtani (Kola). Brenda faqeve ishte dhe ky përkushtim: "... Ne, fëmijët e tu patëm fatin e madh që ishe babai ynë." – Gjoni, Kristina, Rozina, Antonieta, Zefi, Davida-

Për ta shlyer sadopak pengun, e mbështeta librin pranë zemrës dhe e përqafova. Kështu erdhi rasti, o Dedë Gajtani (Kola) përkthyes e poet, të të përqafoj përmes librit tënd. Nuk e lëshoja at' përqaftim të më ikte aq lehtë! Më duket se e gjeta çelësin e

asaj enigma që më mundonte, pse Dedë Gajtani (Kola) shëtiste i heshtur dhe vetmitar. Ai shëtiste dhe komunikonte vetëm në një realitet gjeografik përkthimor. Në librin e tij mund të numëroje më shumë 65 autorë të huaj, ku Deda si poliglot gjuhësh, me kulturën e tij admiruese e gegënishten e tij të dashtun i kishte përkthyer kujdesshëm, me kompetencë. Deda, me mjeshtërinë e përkthimit të tij na bëri të njohur autorë pak të njohur e shumë të njohur botërorë, duke rritur lavdinë e gjuhës shqipe. Ai, teksa ecte rrugëve të qytetit tim, "bisedonte" me këta autorë. Mbase kjo ishte arsyeja që e kishte humbur bisedën me realitetin e tij të përditshëm... Ngjante sikur ishte I huaj, kur në fakt ishte I nderuar. Për punën dhe vlerat e tij, më




mirë se helenisti Gjon Shllaku nuk mund të fliste kush tjetër. Edhe ky bashkëqytetar i Dedës. Përkthyesi kësaj radhe flet për Përkthyesin... Profesor Shllaku, Profetori i "Iliadës" plot 22 vjet më parë do të shkruante kështu: "... , mësova në mënyrë të posaçme se Dedë Gajtani ishte shumë i avancuar në gjuhën latine dhe ishte në gjendje të zotëronte krejt fjalorin latinisht-shqip të Padër Aldigerit, që kishte një fond prej 180000 fjalësh. Me kohë u informova se Deda, nga që kishte një pregatitje të jashtëzakonshme të gjuhës italiane, gjithashtu kuptohet edhe për gjuhën shqipe,

kishte bërë përkthime të shumta nga letërsia latine: si nga Tibuli, disa prej elegjive të këndshme e të dhimbshme; nga Properci, lirika të shquara për pasuri, stil dhe ide të larmishme; ndonjë nga poemat elegante të Katulit dhe të tjera nga latinishtja. Nga letërsia italiane kishte përkthyer lirika të Aleksandër Manzoni, si: "Pesë maji" etj. Kishte përkthyer "Kisha e Polentos" dhe "Valët e Klitumnit" të Karduçit, etj., etj.

... Pas disa vitesh që kishte dalë në pension, më erdhi në shtëpinë time në Qafë-Hardhi. U gëzoja pa masë që më erdhi në shtëpi, ai personalitet i ëmbël, modest, i

(KOLA)



he Poema

thjeshtë, pensionist, por energjik. Kishte sjellë me vete një paketë të madhe me dorëshkrimet e veta. Mbaj mend që lexuem me kënaqësi të madhe përrallat e Fedrit me një gegnishte të pastër, të rrjedhshme, me fjalë të zgjedhuna e shprehje të larmishme origjinale shqipe, thuajse pol exon Fedrin në origjinal (shqip), por me të ardhë gjynah që ai përkthim, dhe shumë lirika, balada, poema të huaja: gjermane, italiane, latine; të përkthyer me aq elegancë dhe harmoni në gjuhën shqipe nga mendja e dora e mjeshtri poet Dedë Gajtani, nuk kishin parë dritën e botimit."

2.

Dedë Gajtani lindi në Gajtan, Shkodër, më 07.06.1915. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Kolegjin Saverian (Jezuitëve) në Shkodër. Ndërsa studimet e larta i vazhdoi në Kolegjin "Propoganda Fide", në Romë, Itali, të cilat i mbaroi në vitin 1941. Që në shkollë të mesme e më vonë kur ishte student filloi të shkruante poezi. Ishte i apasionuar pas letërsisë botërore dhe gjuhëve të huaja. Nga viti 1941-1945 punoi në Institutin e Studimeve (Bibliotekën "Dante Alighieri") në Tiranë. Në vitin 1945 emërohet arsimtar në Fier. Këtu fillon edhe kalvari i vuajtjeve të tij. Në një ditë të vitit 1946, kur ishte duke shëtitur në Manastirin e Ardenicës, kur e arrestojnë. E mbajnë disa muaj në hetuesi, në burgun e Beratit, ku e akuzojnë si agjent të Vatikanit, të Amerikës, etj. ... Pasi del nga burgu në vitin 1947, atë dhe familjen e tij e dëbojnë nga Tirana për motive politike. E emërojnë arsimtar në Maqellarë të Peshkopisë. Më pas në Krujë. Pas një viti e pushojnë nga puna. Në vitin 1954-1958 emërohet përsëri mësues fillore në fshatin Orosh të Mirditës, më pas në malësitë e Dukagjinit, e më pas në fshatrat e Malësisë së Madhe. Në vitin 1965 e pushojnë përsëri nga puna. Punoi punëtor ndërtim për 5 vjet, deri sa doli në pension. Ishte i apasionuar pas natyrës, pikturës, notit dhe shahut. Ndërroi jetë, më 07.12.1993, në moshën 78-vjeçare në Shkodër. Po të shikohen "udhëtimet" e jetës së Dedës e po të shënohen në kalendar, ai kalendar është gjithë vuajtje. Është ferr, është dhimbje!

3.

Libri "Përkthime, poezi dhe poema" më shumë se gjithçka, nga koncepti dhe struktura, i ngjan një antologjie të pasur poetike. Ndërsa vetë autori i ngjan një "Lundërtari" që shtegtoi qytet më qytet, shtet më shtet, kontinent më kontinent, duke kapërcyer dete dhe oqeanë; vetëm me një qëllim të vetëm e fisnik: të sjellë në gjuhën shqipe sa më shumë emra poetësh të huaj, sa më shumë botë përkthimore. Nuk u lodh së punuari! Ndaj kjo gjeografi poetike "e vizatuar" në këtë libër, ka vetëm dimensionet kulturore. Të bie menjëherë në sy edhe kultura shumëgjuhësore e autorit. Me emrin e Dedë Gajtanit lidhen poezitë e përkthyer nga: A. Rossini, A. Manzoni, A. Aleardi, G. D'Annunzio, H. Heine, V. Hygo, L. Ariosto, G. Barsottini, Brunamonti, Carrer, G. Capparozzo, D. Guerrazzi, G. Chiarini, A. G. Cesareo, T. Colonna, Chateaubriand, L. Pignoti, G. Mazzoni, G. Carducci, Delille, V. Da Filicaja, G. Deabato, Paul Deroulede, U. Foscolo, A. Fusinato, Longfellow, A. Fogazzara, T. Grossi, J. V. Goethe, A. Graf, G. Giusti, I. Kasandrie, Ada Negri, G. Prati, G. Leopardi, R. Fucini, V. Maro, G. Marradi, A. De Musset, B. Menzini, Mayo, A. Novaro, E. Nencioni, G. Pascoli, P. Parzanese, B. Prina, E. Praga, E. Panzacchi, G. Pastocchi, A. Poliziano, Ruskin, Rinaldi, G. Catullus, F. Schiller, Shelli, B. Sestini, T. Tasso, J. Da Todi, E. Von Bauerfeld, N. Tommaseo, Felic Uda, G. Zanella, A. Zardo, Hebel, C. Bertola; si dhe përshtatje poezish sipas L. Orsinit, A. Manzoni, G. Berchetit.

Çdo autor i përkthyer mbart shkollën dhe filozofinë e tij, konceptin estetik të poezisë, strukturën, figuracionin dhe shprehësitë poetike, etj. Me të gjitha këto "u përball" suksesshëm përk-

thyesi Dedë Gajtani. Vetë përkthyesi kishte parapëlqimet e veta në përkthime, parapëlqime që lidhen me natyrën e tij delikate, drithëruese e poetike. Përkthimet e tij "ndalojnë" në disa tematika si: motive të festave fetare, motive biblike, pastaj vazhdojnë: dashuria për dritën, zemrën, shpresën... etj.; pastaj vazhdojnë: balada, lirika dashurie, fabula e poezi kujtimore... etj.; pastaj vazhdojnë: stinët e pranverës dhe të vjeshtës... etj.; pastaj vazhdojnë konceptet filozofike e sublime, si: qiellorja, hyjnorja, përmallimi, bekimi... etj. E gjitha kjo rrokje e gjerë motiveve, flet edhe për një veçori tjetër të përkthyesit, Deda ishte njohës shumë i mirë i prodzisë dhe i ndërtimeve të larmishme të vargjeve, të theksave e të rrokjeve, etj., të cilat i dashunoi me gegënishten e tij të zemrës dhe rrezatuan si përkthime mrekullisht.

4.

Dedë Gajtani shumë nga përkthimet e poezive të autorëve që përmendëm më sipër, si dhe të poezive autoriale, i botoi edhe në këto revista: "Kumbona e së Dieles", "Rrezja jonë", "Shkëndija" (Tiranë), "Mbas Teje", "Jehona e së Dieles"; në gazetën: "Balli i Rinisë", "Zani i Shna Ndout", "Bashkim i Kombit" (Tiranë), "Cirka", "Familja e Krishterë". Nga gjumimet tona, na rezulton se plot përkthime e krijime janë botuar para vitin 1944. Ndërsa të tjera shkujnë edhe pas vitit 1992.

Në pjesën e dytë të librit, Deda kësaj here na shfaqet si krijues, ka përfshirë një cikël poezish, që në formimin e tij kulturor ndjek me besnikëri shumë shkolla poetike të autorëve të përkthyer e pse jo ata kanë dhe ndikimin e tyre, kuptohet, në sensin pozitiv. Gjithashtu në këto poezi reflektojnë dhe gjurmët e jetës së tij plot trazime, vuajtje e pabuzëqeshje. Kështu tek poezia "Malli" që i kushtohet Shkodrës, do të gjesht fladë malli, brengash, kujtimesh, dashurie për qytetin e lindjes. Ndërsa tek poezitë "Kalasë së Rozafatit", "Andërrime - Vegime", "Kujtime" etj., në mes andërrimeve vërejmë edhe nota pesimizmi, të kuptueshme këto të një shpirti të lodhur e të raskapitur siç ishte ai i Dedës. Edhe pse në këtë gjendje nuk harron t'u kushtojë poezi Poetit t'ambël Shantojës me titull "Zogu pa çerdhe" e Mësuesit të tij Ndre Mjedës, për të cilin thotë: "Atje në Mjedë vajtojnë bilbilat, / Përmbi gamba të njomë të fojletës. / E e përsërisin lehtë curillat / Si tue kja andërr e jetës."

Në vazhdim të ciklit, po përmend një poezi e cila është shkruar italisht dhe ia kushton të shoqes Marijes, të cilën e quan Ave Maria. (Deda është në Romë. Është viti 1938.) Kurse tek poezia në formë ninulle që ia kushton "Vajzës sime", spektri i gjerë i dashurisë atnore zë vend hijshëm në çdo fjalë e rrezaton në çdo figurë që përzgjedh me kujdes prindi. (Peshkopi, viti 1949). Në fund po lë ca rreshta për poezinë "Nanë, lamtumirë!" Meditimi përmes vargut refren: "Nanë, lamtumirë!" sikur shkrin përmallimet dhe dramën e poetit. Çdo fjalë është dhimbje. Vetë dhimbja është komunikim mes poetit dhe nënës së tij të shtrenjtë. Poezinë e mbyll kështu: "Më shterngo për zemër, të mbramen herë më puth në ballë, / Pse ndoshta bashkë nuk shifna ma për të gjallë, / Por gjithmonë në zemër ka me të pasë yt bir, / Nanë, lamtumirë!"

Shkodër, gusht 2019



Së shpejti një shtatore për ikonën e muzikës shqiptare në Lushnje

Një shtatore e artistes së madhe Vaçe Zela, e punuar nga skulptori i njohur Muntaz Dhrami do të vendoset së shpejti në Lushnje. Memoriali i ikonës së muzikës shqiptare do të vendoset në "Sheshin e Qytetarëve" në qytetin e Lushnjës, bën të ditur Bashkia e këtij qyteti, duke theksuar se "në këtë memorial që është një vlerë e shtuar për qytetin e Lushnjës, Vaçe Zela është menduar bashkë me kitarën që të duket se do të këndoje këngët që nuk harrohen kurrë". Projekti është miratuar nga Këshilli Bashkiak një vit më parë me kërkesë të Kryetarit të Bashkisë, Fatos Tushe.

Vaçe Zela lindi në vitin 1939 në buzë të kënetës së Tërbufit në Lushnjë. Që e vogël u dallua për karakterin e saj artistik. Fillimisht u vu re dëshira e saj e madhe për të kënduar dhe për të kërcyer. Prandaj, më vonë vijoi mësimet në Liceun Artistik "Jordan Misja", për të qenë në grupin e artistëve të rinj që do të përfaqësonin Shqipërinë në Festivalin Ndërkombëtar të Rinisë në Moskë, në vitin 1956, kur ishte vetëm 17 vjeçe. Ky ishte ballafaqimi i saj i parë me skenën ndërkombëtare. Kështu, dalëngadalë, që nga ajo ditë filloi të bëhej e njohur edhe brenda vendit. Pjesëmarrja e saj në estradën e qytetit dhe në shfaqjet nëpër mbarë Shqipërinë ishin një ogur i mirë për rrugën që kishte nisur. Në vitin 1961 filloi të ishte pjesë e Estradës së Ushtarit.

Vaçe Zela që në vitin 1962 ishte e para që fitoi Festivalin e Këngës. Me këngën "Fëmija i parë" ajo dëshmoi se një idhull i muzikës po lindte atë mbrëmje të 26 dhjetorit të vitit 1962. Repertori i saj është shumë i pasur numërohen me dhjetëra këngë popullore, të lehta, kantata, balada, etj. Zëri dhe repertori i pasur që la trashëgimi vijnë në mbeten gurë shndritës në gjerdanin e traditës shqiptare të këngës. Nga këtu nisi edhe karrierën artistike në kryeqytet. Mori pjesë në festivalin e parë të

këngës së lehtë në radio në vitin 1962, për të interpretuar deri në vitin 1981 në Radio-Televizion, ku u shpall dhe fituese e çmimit të parë. Studioi për art dramatik, por iu kushtua këngës së lehtë dhe këngës së përpunuar popullore. Ka marrë pjesë në 26 festivale kombëtare ku ka fituar 10 herë Çmimin e Parë.

Vaçe Zela ka dhënë një kontribut të rëndësishëm edhe në muzikën e filmit. Zërin e saj e dëgjojmë tek filmi "Në shtëpinë tonë". Në vitin 2008, me rastin e 69-vjetorit të lindjes, Presidenti i Republikës, Bamir Topi, i akordoi titullin "Nderi i Kombit" me motivacionin: "Për vlerat e rralla si artiste e shquar, me popullaritet të jashtëzakonshëm, për interpretimin mjeshëtor të këngës së muzikës së lehtë dhe asaj popullore, për pasurinë e vyer që krijoi në shkollën shqiptare të interpretimit muzikor". Gjithashtu ajo mbante edhe titullin "Artiste e Popullit".

Numërohen rreth 55 këngë që prej fillimit të karrierës në vitet '60 e deri në festivalin e fundit në RTSH. Disa nga këngët që do të mbeten në kujtesën e publikut janë: "Fëmija i parë", kompozim i Agim Krajks, të cilën Vaçja e ka kënduar në vitin 1962 në Festivalin e Parë të Këngës, "E dua vendin tim", "Djaloshi dhe shiu", "Dritaren kërkoi", "Lumi Ebro", "Për ty o këngë", "Manushaqja", "Esperanca" këngë kubane kënduar po në vitin 1962 në shogërinë e kompleksit ritmik, këngë nga filmi "Karmen", "Një zambak i bardhë në gur" etj. Vaçe Zela ka bashkëpunuar me kompozitorët më në zë të muzikës së lehtë shqiptare, si: Tish Daija, Agim Krajka, Kujtim Laro, Shpëtim Kushta, Avni Mula, Limoz Dizdari, Pjetër Gaci, Aleksandër Peçi, Agim Prodani etj. Përfundimisht u largua nga skena në vitin 1990. Vaçe Zela u lind në Lushnje më 7 prill 1939 dhe vdiq në Bazël, Zvicër, më 6 shkurt 2014. Vaçe Zela ishte një nga këngëtarët ikonë të skenës shqiptare.

DHU. HA.

"E ruaj një fjalë në shpirt..."

E RUAJ NJË FJALË NË SHPIRT...

Pas këtij mali, shtëpizën ka hëna,
e ruaj një fjalë në shpirt...
Pas shtëpizës së hënës, pylli ka detin e gjelbrimit,
e ruaj një fjalë në shpirt...
Pas detit të gjelbrimit, deti më fal kaltërsinë,
e ruaj një fjalë në shpirt...
Pas detit të kaltërsisë, jeton lëndina e fëmijërisë,
e ruaj një fjalë në shpirt...

E ruaj një fjalë në shpirt... me shpirt!

KUR PËRMEND EMRIN TËND...

-Nënës-

1.
Kur përmend emrin tënd, apri apron,
tkurret, hesht, kthehet në fjalë malli,
diqjet dhe pret
se kur do të kthehesh Ti...
2.
Kur përmend emrin tënd, dielli diellon,
muqet, zverdhjet, kthehet në giri
diqjet dhe pret
se kur do të kthehesh Ti...
3.
Kur përmend emrin tënd, gjumi është i paqjumë,
Sytë nuk mbyllen, kthehen në ninullë,
Rrudha shtohet edhe një,
një tjetër udhë...
Mua më pret një mëngjes përqaqimi deri në paudekësi,
Po kur do të kthehesh ti?..
4.
Kur përmend emrin tënd,
dëborë mbi qiun, ujeshita me shi
më sjellin kujtime pafund...
Pranvera më ruan lulet,
Vera më ruan perëndimin e diellit...
Stinët, kujtimet nuk m'i zoqëlojnë,
i rritin e i rriten derisa qjallojnë emrin tënd,
e afrojnë e diellojnë
dhe unë nuk pyes: - Kur do të kthehesh Ti?..

MUZG

Muzgu mori ngjyrën e saj kur putha një lule.
Kugëllimi i turpit la ëndërr fisnikërie.
Nuk e di pse u ktheva përsëri tek ajo lule...
Homerike
-O zoqj, o ju të mirët zoqj, -
Mos u nisni për shteqtim pa ju puthur!

DERË E VJETËR...

1.
Derë e vjetër e shtëpisë sime -
Drithërimë shpirti!
2.
Derë e uj...
Të puthin: malli, buzët, shpirti,
ëndrra, loti, qezimi, thirrjet,
urtitë, gërat, lindjet, vdekjet,
dielli i vonshëm, hëna e lodhjes,
fjalët lshëhurake, grindjet mes shokëve,
barsoletat, filmat e vetëm shqiptarë,
përgeshjet, vonesat, mallkimet.
Të puthin...
3.
Derë e vjetër, e ciflosur
si re e ngjyrë hëna,
Derë e vjetër, ëndërrfjetur,
Aromë Nënë!

SONTE...

Në shteqtimin e zemëruar të reve
hëna humbi...
Trishtimin e gjellit
zbehshëm e dritësuan ca yje të largët.
Sonte - Shikimi më i pakët...

NË LUTJEN TIME...

Hënë e trishtuar, mos ma bjer pikëllimin...
Pikëllimi nuk ka rrugë e largësi,
ka shpirt e zemër,
kur syri puth një ëndërr...
ka puthje lotësh
pa vetëtima motësh...

Në lutjen time
dua ngjyrat të mos udesin...

Lirikë shiu
Erdhi me shiun e ujeshitës
fytyra jote e qullur...
U trishtova...

Si një dëshirë...
Por, ah! Retë ishin larg, shumë larg
të të thurja një peshqir...
Po të fal ngrohtësinë e zemrës
si një kohë e mirë...

LIRIKË

Mu duk se u mbyta
në kaltërsinë e syve të tu
dhe s'dal dot...
Me mirësjellje
më solle si uarkë shpëtimi
një lot...

Ti je kag e bukur...
Ti je kag e bukur, sa sytë m'u bënë ujë.
Kjo fjalëz shpirti, i ngjan së vërtetës...
Të prekë ngadalë siç prek një statujë
për t'i ngritur madhësi vetvetes.

TË PRITA...

Kushtuar Ptitit
Të prita në mëngjes, sikur... po vonoje...
Ti ecje apo fluturoje?

Të prita në muq, sikur... po vonoje...
Ishë shelq apo flokët valëzoje?

Të prita në shteq-ylli, zemër a erdhe?..
Uije si gjelbrim qjethesh e fëshfërimë ere...

Ndjëva hapin tënd që kapërcente dete,
e pafjalë, e dritshme si hënë
mbi supin tim kokën mbështete

IKE...

Ike...
Mbrëmja drithëruese
pushon mbi stolin e drunjte
e heshtur, pa një përqaqim...

Mbrëmja ujen dhe ikën
si flokët e tu të butë...
Një pikëz loti
u bë stol i drunjte.

nga Xhabid Bushati



Paradë

FJALËKRYQESH



NGA
KADRI VOKOPOLA

FJALËKRYQI PA SKEMË

DUHET TË NXINI **36** KUTI

	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17
1																	
2																	
3																	
4																	
5																	
6																	
7																	
8																	
9																	
10																	
11																	
12																	

HORIZONTAL

- Ermal Kantautor.
- Vihet për të dëgjuar.
- Lidhin brigje.
- Është si e gjitha.
- Gjysma e luanit.
- Ndërmarrje Autonome Vlorë.
- Tase e volejbollit.
- Nxirren nga nëntoka.
- Hapur në Londër.
- Inicialet e Kant
- Rita këngëtare
- Janë skaje.
- Është solemn ai ushtarak.
- Është zanat
- Ajo e dimrit është e ftohtë.
- Janë provat e fundit.
- Gjysmë antike.
- Është gojë vullkani.
- Robert Redford.
- Kanë të gjithë një turi
- Fillojnë tani
- Një protagonist në skenë
- Film i Denis Villeneuve.
- Oqytet në Itali
- Gjysma e normës.
- Një struc australian.
- Një arab në Riad
- Lumë në Siberi
- Ferrara regjisor.
- Është djaloshi

- Në krye të detyrës
- Është tokë buke.
- Pausim në këngëtare.
- Janë armë si kallashnikov.

VERTIKAL

- Një pjesë e memorialit
- Kufijtë e botës.
- Një televiziv është pa ujë
- Tregon çmimin me... edukatë.
- Organizma Botuese Autonome
- Dhjetë angleze.
- Qe babai i Dioskurëve.
- Gjysma e arenës.
- Ndërmjet latinëve.
- Ekstremitet në litar
- Është erë kafeje.
- Gjysmë rrethi.
- Është Au në tabelë.
- Mund të jetë monstruoze
- Fitzgerald që qe këngëtare.
- I takon artist figurativ.
- Shkroi Misteret e Parisit.
- E thellë është supe.
- Fundi i një fatzui.
- Janë qeje që... mbeten.
- Kufijtë e lëvizjes
- Janë qenushë.
- Një përgjigje në celular.
- Vampiri i Kluas Kinski-t.

PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT PA SKEMË

A	D	A	P	T	E	P	U	M	D	E	M	O	N		
K	O	R	R	E	N	T	E	K	A	B	D	L	A	L	O
S	A	D	E	P	E	R	M	A	S	E	I	G	T		
E	A	K	A	P	A	P	A	P	I	L	L	O	N	S	
T	A	N	A	C	H	A	R	A	N	G	O	E	V	A	
S	T	T	E	O	R	I	C	I	E	N	E	T	N		
F	A	B	E	R	N	I	N	I	D	R	I	T	A		
I	K	A	R	R	E	M	A	T	C	I	R	K	U		
N	G	A	R	I	T	T	E	T	N	O	E	P			
I	T	R	E	K	A	T	U	N	E	L	R	A			
S	T	E	R	N	O	R	B	I	T	Z	M	A	G		
H	I	R	I	R	E	E	D	A	N	E	T	A	R	E	

- Është nënoficer.
- Lumë në Itali
- Është moshë.
- Këndohen në opera.
- Armstrong, që shkeli i parë në Hënë.
- Një i fundit mbi të gjithë.
- Fillojnë reformën.
- Maore pa çifte.
- Kufizojnë testin.
- Fillojnë aksionin
- Film i Ridley Scott.
- Rrotullohen në elektromotor të tillë
- I mungon harbutit.
- Janë veshje.

SUDOKU

PLOTËSONI VENDET BOSH NË MËNYRË QË ÇDO RRESHT E KOLONË TË KETË NUMRAT NGË 19

	5	4	1	3	2				
1		3	2		8	4		6	
	8							1	
5	1			6				4	7
3		9		5				1	
6	7			3				5	9
	2							6	
8		1	5		9	7			4
3		6	8	7				9	

PËRGJIGJE

1	9	4	2	8	7	3	5	6
7	3	5	6	1	4	8	2	9
8	2	6	3	9	5	1	7	4
6	8	2	7	5	9	4	1	3
4	1	7	8	3	6	2	9	5
3	5	9	4	2	1	6	8	7
5	6	8	9	4	2	7	3	1
9	7	3	1	6	8	5	4	2
2	4	1	5	7	3	9	6	8

FJALËKRYQI SPORTIV

	1	2		3	4	5	6	7	8
				9	10				
				13	14	15			
	17								
19		20	21					22	
24	25			26		27			28
29				30		31		32	
33		34			35	36			37
		38		39	40	41			
42									

HORIZONTAL

- Është njëvendëshe në Formula 1.
- Leo "Pleshti" i futbollit.
- Watts aktore
- Gjysmë titull
- Plotësohen me 1, X, 2.
- Final pa ekstreme
- Janë gabimet e gjuajtjeve të lira.
- Lëvizje Autonomiste Lokale
- Matteo te Manchester

VERTIKAL

- United
- Kufizojnë takimet
- Rinia pa kufij
- Është mbrëmja më e mirë
- Të parat në stafetë
- Inicialet e Asimov
- Blacks, përfaqesuesja e Zelendës së Re në rugby
- Dy asa
- Një pjesë e zoologjisë
- Fund janari
- Qendër kurimi

VERTIKAL

- Është shahu i fundit
- Trebeshina që qe shkrimtar.
- Kona i paharruar i volejbollit
- Është edhe ajo e rreptësisë
- Janë legjenda
- Robero Mancini
- Sulmuesi në foto
- Bomberi në foto

PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT SPORTIV

K	S	U	S	T	A	R	T	N	G
O	D	N	V	I	O	L	A	M	O
I	E	O	N	A	R	D	O	D	I
V	E	N	D	A	S	I	T	D	I
M	A	R	C	H	A	N	I	A	I
R	E	A	T	A	T	A	M	I	I
S	I	C	A	R	V	I	A	L	I
O	L	S	T	J	M	M	I	E	R
M	O	N	A	S	A	N	O		
A	L	B	A	N	H	O	N	A	
I	T	O	N	L	E	K	A		

- Është edhe ai Fosbury
- Vioresin ish-bomber
- Skuadra azzurra
- Alien pa çifte
- Ishulli i kalorësve
- Paralajmëron thyerje
- Teliti regjisor
- Gjysmë pritje
- Hidi portier
- Diane Lane
- Është zonjë shtëpie
- Përfundojnë pingul
- Lorenzo në MotoGP
- Janë toka buke
- Llajit te Torino
- Sivori ish-as argjentinas
- Një fazë gjumi
- Gjysmë milion
- Luarasi aktore
- Një mohim i prerë
- Steven Spielberg
- Kështu fillon lundrimi
- Ndal në kufij

FJALËKRYQI I KRIPTOGRAFUAR

15	6	19	1			A	12	K	7	S	2	I		7	5	2
3	4	3	8			18	1	8		8				1	9	
9	3	18				15	3	9	2	18	3	8	9	2		
3	1		5	3	9	6		1	4	6						
4		12	1	15	2	8	1	11	2	7	8	3				
10	3	9			7	12	1			10	7			9	15	
2	9	1			2	1				15	2	8		1	2	
1		5	1							15	1	4		3	12	8
	18	2	10	1						8	9	2	12		8	3
5	1	4	2			9	9	1						4	6	8
1	18	1	11	2	1					10	3	8	1	9		
8	1	8			9	1	12	3	8	1				2	8	

PËRGJIGJE

A	R	M	S	T	M	E	R	R	E
T	U	I	T	E	A	R	I	O	
M	O	N	O	T	O	N	I	A	N
P	O	L	I	G	A	M	I	A	O
M	E	R	I	N	O	S	R	M	N
L	I	R	I	A	N	T	I	M	E
R	I	T	I	I	L	I	N	O	
K	A	S	E	M	A	R	I	A	N
T	I								
A	R	I	E	L					
P	A	K	E	T	M	I	N	A	T
S	T	E	F	I	S	E	T	A	M

SHKRONJA E NJËTË PËR NUMËR TË NJËTË



BUNK'ART

Ish bunkereri antibërthamor i Ushtrisë Shqiptare

Bunk'Art prezanton instalacionin më të fundit artistik të realizuar në mjediset e Bunk'Art 1

TANGO DOWN 2

Nga **HELIDON GJERGJI**

*Instalacion me vendodhje specifike i përhershëm
Pasqyra, shkronja ngjitëse plastike*

**Inagurimi do të bëhet në praninë e artistit
në 13 gusht 2019 ora 19:00**

Tango Down 2 është një instalacion artistik i palëvizshëm dhe është projekti binjak i *Tango Down* i cili u realizua në vitin 2015 në D-O Ark Underground, kjo e fundit një strehë anti-atomike në Konjic, Bosnje dhe Hercegovinë. Ajo vepër u krijua si një instalacion i përhershëm me rastin e Project Biennial 3, por në Tiranë është hera e parë që pasqyrat mbulojnë të 4 anët e dhomës, duke shpërbërë si me magji bunkerin pa përdorur asnjë lloj arme dhe pa thyer asnjë copë betoni.

Thuhet se *Tango Down* e ka origjinën nga zhargonit ushtarak. Në alfabetin fonetik të NATO-s, të krijuar rreth viteve 1930, shkronja "T" përkon me fjalën tango dhe nënkupton fjalët objektiv (target), ose "armik". Të rrëzosh një objektiv nënkupton "ta qëllosh" atë, "ta neutralizosh" ose "vrasësh" atë. *Tango Down* është versioni i sublimuar i synimit të rrëzimit të objektivit - ajo përcjell një shprehje gëzimi dhe ekstaze për misionin e

përmbushur. Ajo është tokja e duarve (toke) midis ushtarëve për të festuar një vrasje nën bekimin e ligjit - ajo është mishërimi i vetë luftës.

Që të paktën nga 2008, *Tango Down*, është adoptuar nga lojërat elektronike, me tematikë lufte, të cilat luhen nga shumë lojtarë njëkohësisht. Gjatë komunikimit me shokët e skuadrës, lojtarët mund të përdorin *Tango Down* për të treguar se ata kanë eliminuar një objektiv. Titujt e lojërave elektronike të përdorura për këtë instalacion nuk janë thjesht emrat e çfarëdo loje të dhunshme, por hiç më pak se emrat e lojërave me tematikë luftën atomike.

Bunk'art 1, bunkerit anti-atomik i ndërtuar në Tiranë në vitet e Luftës së Ftohtë është një mjedis i përsosur për të reflektuar mbi të kaluarën dhe kërcënimin nga konflikti bërthamor në të ardhmen.

Bunk'Art 1 - Rruga "Fadil Deliu" (pranë teleferikut) Tiranë
Linja e autobusit për BUNK'ART 1: "Qender-Porcellani"
Nisja: pranë Kullës së Sahatit - Tiranë
Tel: +355 (0) 672072905